

HEJZA

Majlinda Rama, shkrimtare dhe studiuese

***POEZIA, NJË PROCES QË ZBULON DHE
ÇLIRON***

Nën thjerrë

FRIKË NGA KRITIKA

Kultura nuk mbrohet duke heshtur, por duke e kthyer zërin në instrument presioni. E derisa zëri të mos kthehet në mjet politik, në mjet ndërgjegjësimi, në mjet reagimi, çdo buxhet do të jetë copë buke për të mbajtur të heshtur ata që duhej të bërtisnin

Nga Avni HALIMI

Heshtja që kultura shqiptare ushqen përballë vlerës së vërtetë nuk është vetëm mungesë njohje, as vetëm paaftësi estetike, por, në thelb, është një mekanizëm psikologjik i vetëmbrojtjes kolektive. Ajo buron nga një frikë primitive: nëse thua të parin diçka që nuk është pranuar ende nga turma, do të izoloheesh, do të sulmohesh, do të digjesh. Natyrisht, do të anatemoheesh simbolikisht. Do të përjashtohesh nga rrjeti i ngrohtë i mediokritetit të organizuar. Dhe ky përjashtim, për mendjet e frikësuara që mbizotërojnë kulturën tonë, është më i rëndë se çdo dënim tjetër.

Psikologjia e heshtjes kolektive ndaj vlerës

Frika nga izolimi është më e fortë se dëshira për të thënë të vërtetën. Ndaj edhe nëse një kritik e di se një vepër është e jashtëzakonshme, ai do të presë. Do të presë që të flasë dikush tjetër i pari. Një zë nga jashtë, një zë nga më lart, një çmim ndërkombëtar. Dhe vetëm kur vlera është bërë e padiskutueshme nëpërmjet një aprovimi të jashtëm, atëherë do të guxojë të flasë. Jo nga bindja, por nga siguria. Kjo është natyra e mendjeve që nuk kanë integritet: nuk janë të afta të rrezikojnë. Dhe çdo pohim i madh për një vlerë të vërtetë është gjithmonë një rrezik. Prandaj askush nuk e merr përsipër. Në rrënjët e kësaj sjelljeje është mungesa e autonomisë mendore. Shoqëria shqiptare, e lodhur nga konformizmi i dekadave dhe nga frika historike e diferencimit, e ka të rrënjosur thellë nevojën për të mos u veçuar nga turmat. Nuk duan të duken “të ndryshëm”. Nuk duan të japin përshtypjen se dinë më shumë. Nuk duan të duken si ata që “nxitojnë”, që “janë të mahnitur”. Kjo sjellje e frenon gjykimin dhe deformaton ndjeshmërinë. Kështu, ata që do të duhej të ishin zërat e parë të një epoke, bëhen zërat e fundit. Ose më keq: heshtin përjetësisht.

Frika nga kritika është krah tjetër i së njëjtës monedhë. Nëse thua i pari se dikush është i madh, e rrezikon të jesh objekt i përçmimit, zilisë, talljes. Sepse kultura jonë e ka ndërtuar kolektivitetin e saj mbi bazën e një barazie të rreme. Më i mençuri i fisit është gjyshi! Duhet të respektohet gjyshi nëse duam të jemi po aq të mençur! Askush nuk duhet të jetë më i mirë. Askush nuk duhet të jetë më lart. Lavdërimi i dikujt tjetër interpretohet si sulm ndaj egos së tjetrit. Në këtë atmosferë të mbarsur me nervozizëm të pashprehur, çdo artikulum vlerash bëhet i rrezikshëm. Çdo fjalë që ngre dikë lart, shihet si tentativë për të shembur gjithë të tjerët. Kjo është arsyeja pse edhe nderimi i singertë është kriminalizuar. Kemi frikë të nderojmë. Kemi frikë të admirojmë. Madje, kemi frikë të kemi pëlqime të forta. Pse? Sepse një pëlqim i singertë, një artikulum i fortë për një vepër të madhe, kërkon një akt vetëzbulesë: tregon se kush je ti si lexues, sa thellë sheh, sa je i lirë nga ndikimi i turmës. Dhe shumica nuk janë të gatshëm të tregojnë veten, sepse në të vërtetë, nuk kanë identitet të formuar. Ata janë thjesht reflektim i asaj që turma mendon. Nga kjo psikologji lind një tjetër shëmti: dekurajimi i guximtarëve. Ai që flet i pari, shpesh dënohet jo për gabim, por për guxim. Shoqëria shqiptare nuk i fal guximtarët që dalin nga rreshti. As nuk i ndjek. I përbuz. I përgojon. I përjashton. Dhe kur të tjerët më në fund e kuptojnë se ai kishte të drejtë, është tepër vonë. Dëmi është bërë. Vlera është shpërfillur në momentin e saj jetik. Ndikimi ka dështuar



të ndodhë në kohë. Dhe vlera që vjen me vonesë, ka gjithmonë më pak peshë. Në këtë mjedis, gjithçka shtyhet. Vlerësimi, diskutimi, pranimet. Gjithçka lëviz ngadalë, sepse frika e artikulimit e ka shndërruar kulturën në një hapësirë ku gjithçka ngec. Kjo nuk është më vetëm mungesë kritike. Është paralizë kolektive. Është një refuzim për të jetuar në kohën reale të vlerave. Një zgjedhje për të ndenjur në pritje të garancive, të certifikatave të jashtme, të heshtjeve që zgjasin derisa të bëhen zakon. Ky mentalitet është vrasës për çdo lëvizje të gjallë kulturore. Sepse vlera nuk është vetëm një rezultat. Është edhe një proces. Dhe nëse procesi pengohet nga heshtja, edhe rezultati nuk ka më energji për të ndikuar. Në këtë mënyrë, madhështia zhduket pa e përjetuar asnjëherë lavdinë e saj. Dhe faji nuk bie mbi ndonjë censurë zyrtare. Faji është më thellë: në psikikën e frikësuar të shoqërisë sonë. Për të thyer këtë rreth vicioz, duhen individë që nuk kanë frikë të digjen. Individë që kanë më shumë dëshirë për të thënë të vërtetën sesa për të ruajtur reputacionin. Duhet një brez që nuk ka frikë nga artikulimi i vlerës, edhe nëse është i vetëm që e thotë. Vetëm atëherë mund të ndërtohet një kulturë që njeh madhështinë në kohën kur ndodh, e jo kur është vonë. Dhe vetëm atëherë vlera do të ndriçojë, jo si zhurmë pas vdekjes, por si dritë që ndikon jetën. Sot të gjithë shqiptarët në botë vlerësojnë njësoj: Arbën Xhaferi ishte gjeniu i kombit! Por, si dhe sa e vlerësuan derisa ishte gjallë? Apo, sot të gjithë insistojnë të qëndrojnë në filozofinë politike e kombëtare të Arbër Xhaferit, ndërkohë që, asnjëri prej tyre as që ka në sirtarin e vet qoftë një faqe nga kjo filozofi apo platformë kombëtare të këtij gjeniu të kombit! E kanë me të dëgjuar, jo me të lexuar!

Mungesa e të parit për ta thënë të vërtetën kulturore

Në çdo kulturë, përparimi fillon me një

zë. Një zë që flet përpara të tjerëve. Që nuk pret të bëhet shumicë, as të marrë duartrokitje. Një zë që thotë atë që nuk thuhet, por që ndihet nga të gjithë. Ai zë nuk është thjesht zëri i guximit, por është zëri i lindjes së ndërgjegjes kolektive. Në shoqërinë shqiptare, ky zë mungon. Jo sepse nuk ka njerëz që mund ta kenë, por sepse është ngritur një kulturë e tërë për ta shtypur, për ta heshtur, për ta turpëruar. Askush nuk do të jetë i pari që thotë të vërtetën. Dhe kjo, më shumë sesa një problem i vlerësimit estetik apo moral, është një plagë e thellë psikologjike dhe kulturore. Sepse nuk është fjala për të mos ditur, por për të mos guxuar. Dhe më tragjike akoma: për të mos dashur ta thuash. Në një shoqëri të mbushur me llogari të vogla, me strategji për të mos prishur punë, me frikë nga prishja e komoditetit partiak, të thuash i pari një të vërtetë bëhet një akt i rëndë - gati kriminal. Nuk është se nuk e njohim vlerën. Nuk është se nuk e kuptojmë kush është i madh dhe kush është i vogël, kush ka prodhuar thellësi dhe kush ka ngjitur lustrim sipërfaqësor. E dimë fare mirë. E përjetojmë çdo ditë, në mënyrë të nënkuptuar, në mënyrë të heshtur, në mënyrë të turpshme. Por askush nuk flet. Askush nuk thotë: ky është mjeshtër. Askush nuk thotë: kjo është një vepër e epokës sonë. Askush nuk del dhe ta marrë përsipër peshën e një fjale që ndan vlerën nga antivlera. Dhe kjo mungesë nuk është neutrale. Ajo është vetë krimi që po konsumon themelet e kulturës sonë. Askush nuk del të pranojë se poezitë e Teki Dërvishit e të Beqir Musliut janë të paarritshme, poezia e Ramadan Musliut është e një gjeniu, poezia e Xhevdet Bajrajt është e një mjeshtri të papërsëritshëm! Në vend të zërit të parë, kemi korin e të pasigurtëve, të të ndrojturve, të atyre që pyesin veten: “Po sikur të mos kem të drejtë?”, “Po sikur të duken si lavdërime të tepruara?”, “Po sikur ta marrin për interes?”. Dhe kështu heshtja bëhet më e sigurt se e vërteta. Aty ku duhej të

lindte guximi, ngrihet një mur ngurrimi. E vërteta pritet të vijë nga jashtë, e certifikuar nga ndonjë institucion i huaj, nga ndonjë çmim ndërkombëtar, nga ndonjë intervistë në një media të madhe. Sepse vetëm kur e thonë të huajt, mund ta përsërisim pa rrezik. Dhe kështu, vlera jonë vendase bëhet e vërtetë vetëm pas një përkthimi. Kjo është vetëkolonizimi estetik në formën e tij më të shëmtuar. Për më keq, në botën akademike shqiptare sot ke akademikë që nuk e pranojnë gjenialitetin e figurave kombëtare, ke kritikë që do të ndjeheshin shumë të lumtur sikur bashkëkohanikë të tij të mos ishte as Teki Dërvishi e as Beqir Musliu! Mungesa e zërit të parë është mungesa e përgjegjësisë morale për të artikuluar vlerën aty ku është. Kemi rritur breza që nuk guxojnë të shprehen, jo sepse nuk kanë mendim, por sepse janë mësuar të mos kenë peshë. Kemi ndërtuar një sistem ku më mirë është të thuash “nuk jam i sigurt” sesa të thuash “jam i bindur”. Dhe kështu, bindja për vlera të mëdha zhduket nga hapësira publike dhe mbetet vetëm në qarkullim privat, në biseda të mbyllura, në shenja të pashkruara. Në vend të zërit të parë, kemi pritur gjithmonë një vdekje. Një përvjetor. Një rast për të folur pas të gjithëve. Sepse vetëm atëherë mund të ndihesh i sigurt. Vetëm kur të tjerët kanë folur, kur rreziku ka kaluar, kur vlera është pranuar nga turma, vetëm atëherë lind kuraja për ta përsëritur atë që duhej thënë shumë më herët. Ky është riti i përhershëm i vonesës shqiptare: të njohim, por gjithmonë pas kohe. Të nderojmë, por gjithmonë në mungesë. Të flasim, por vetëm kur të mos jetë më nevoja. Por kultura nuk ndërtohet me vonesa. Ajo ndërtohet me zëra që nuk presin. Me njerëz që nuk frikësohen nga fakti se do të mbesin vetëm për një kohë. Zëri i parë nuk është popullor. Nuk është i lehtë. Nuk jep përfitime të menjëhershme. Por është zëri që thyen heshtjen, që çan mllëfin e akumuluar, që ngre gurët e pashpallur të një kulture të vërtetë. Pa këtë zë, gjithçka është fasadë. Dhe për aq kohë sa do të mungojë ky zë i parë i cili nuk do të ketë frikë të tregojë madhështinë aty ku është, që nuk do të ketë frikë të thotë: “Ky është autor i jashtëzakonshëm, kjo është vepër që duhet lexuar, kjo është fjalë që ndryshon”, ne do të mbetemi në një rreth të sëmurë, ku e vërteta vjen gjithmonë pas, ku vlerat humbasin fuqinë për të ndikuar, dhe kultura zhvishet nga energjia që lind nga guximi. Sepse në fund, ajo që i mungon kulturës shqiptare nuk është mendimi i thellë. Është ai që e thotë i pari.

Buxheti i heshtjes intelektuale

Në Maqedoninë e Veriut ka universitete shqiptare. Ka fakultete pedagogjike, albanologjike, institute shkencore, qendra kulturore, shoqata, organizata joqeveritare, dhe një grusht të mirë politikanësh shqiptarë që ndajnë pushtetin me shtetin që realisht dhe natë e ditë i nënvlerëson. Në letër, duket sikur shqiptarët kanë gjithçka. E në realitet, nuk kanë më të rëndësishmen: zërin. Sepse, përkundër gjithë kësaj infrastrukture akademike, institucionale dhe politike, kultura shqiptare në këtë shtet trajtohet si margjinë e margjinës. Dhe askush nuk flet. Askush nuk e bën problem kombëtar. Askush nuk e bën çështje të drejtësisë publike. E dini pse heshtin? Sepse pothuajse të gjithë janë të kapur. Jo nga ideologjitë, jo nga shantazhi klasik, por nga diçka më tinëzare: nga projekti kulturor që presin ta marrin vitin tjetër. Ata heshtin sepse kanë aplikuar. Sepse

kanë dërguar një kërkesë për botim, një ide për festival, një buxhet për ndonjë event letrar. Heshtin sepse kanë nevojë për firmën e ministrit, për “miratimin” e zëvendësministrit, për premtimin e sekretarit shtetëror. Dhe për këtë arsye, nuk duan ta “prishin punën”. Nuk duan të jenë “konfliktualë”. Sepse nëse flet kundër padrejtësisë, nuk do të marrësh asgjë. Prandaj, zgjedhin të heshtin. Të pëshpërisin në korridore, por të mos thonë kurrë asgjë në publik. Të duket sikur janë aktivë, kur në fakt janë thjesht kulturë në arrati. Kjo nuk është heshtje nga mosdija. Është heshtje nga interesi. Është heshtje e blerë, me çmimin më të ulët të mundshëm: një fond për një broshurë. Një ndihmë për një konferencë. Një poster për një simpozium. Kështu institucionalizohet nënshtrimi. Kështu ngrihet një regjim i heshtjes kulturore që

është më efikas se çdo censurë shtetërore. Sepse, këtu nuk ka urdhër që të mos flasësh - ka llogari që, nëse flet, nuk të japin gjë. Në këtë mënyrë, vetë shqiptarët bëhen pjesë e mekanizmit që e gropos kulturën e tyre. Akademikët shqiptarë nuk ngrihen kundër diskriminimit buxhetor sepse janë të lidhur me grantin që kanë aplikuar. Profesorët nuk bëjnë deklarata publike sepse janë në pritje të emërimeve. Institucionet shqiptare që duhet të ishin pararojë, e shesin zërin për një mbështetje minimale. Dhe kultura shqiptare, në vend që të trajtohet si e drejtë e garantuar në shtet, reduktohet në një lëmoshë që duhet kërkuar me lutje. Këtu e ka zanafillën ajo padrejtësi e thellë që pastaj shfaqet si mungesë librash, mungesë eventesh, mungesë përfaqësimi, mungesë përkthimesh, mungesë kujtese. Nuk është vetëm se

nuk ka buxhet. Është se nuk ka kush ta kërkojë me zë të lartë, sepse të gjithë janë të përkulur para një nënshkrimi. Asnjë nuk e merr mundimin ta kthejë këtë në debat publik. Sepse asnjë nuk do të quhet “ai që flet shumë”. Dhe kështu, heshtja bëhet normë. Pajtimi bëhet moral. Të qenit i pranueshëm për autoritetet shtetërorer maqedonase bëhet virtyt. Të mos jesh i bezdisshëm bëhet strategji për të mbijetuar.

Por, a është kjo mbijetesë? A është ky zhvillim kulturor? Apo, është një regjim i butë i vetëzbutjes, që në thelb nënkupton vdekje me ngadalë? Një shtet nuk mund të respektojë kulturën e një populli që nuk e mbron vetë kulturën e vet. Nëse shqiptarët në Maqedoninë e Veriut presin që shteti të kujtohet për ta pa i kujtuar ata vetë çdo ditë, atëherë janë të humbur. E nëse ata që e kanë

zërin - profesorët, studiuesit, shoqatat, partitë, institutet, nuk flasin sepse janë të ngujuar në pritjen e projekteve, atëherë ata nuk janë përfaqësues të kulturës, por kolaboracionistë të heshtur të diskriminimit. Kultura nuk ndërtohet me llogari të vogla, por me qëndrim të madh. Kultura nuk mbrohet duke heshtur, por duke e kthyer zërin në instrument presioni. E derisa zëri të mos kthehet në mjet politik, në mjet ndërgjegjësimi, në mjet reagimi, çdo buxhet do të jetë copë buke për të mbajtur të heshtur ata që duhej të bërtisnin. Sepse kultura nuk ka nevojë për mëshirë. Ajo ka nevojë për dinjitet dhe zë. Dhe në Maqedoninë e Veriut, sot për sot, zëri i kulturës shqiptare nuk mungon nga mungesa e njerëzve, por nga prania e frikës, servilizmit dhe llogarive të vogla. Dhe ky është faji ynë më i madh.

Letër nga diaspora

NJË DITË PËR ATA QË NA NDEROJNË

Ata janë artistët tanë – krijuesit e fjalës, ngjyrës, tingullit dhe lëvizjes – që me veprat e tyre e bëjnë emrin shqiptar të kumbojë përtej kufijve të atdheut

Neviana SHEHI

Të shumtë janë ata që na nderojnë, që na bëjnë krenar, që na lumturojnë. Është një plejadë e artistëve tanë që kohën më të madhe e kalojnë jashtë atdheut. I kemi gjithandej nëpër skenat e metropoleve botërore. Për ta flitet, për ta shkruhet, për ta jepen vlerësime pozitive, për ta publiku ngrihet në këmbë, sepse tashmë janë emra të respektuar. Pavarësisht se origjina e tyre është nga një shtet i vogël i Ballkanit, vlerat e tyre artistike kanë prekur majat më të larta në panteonin e artit botëror. Saimir Pirgu, Inva Mula, Adrian Paci, Klaudia Pepa, Ilir Shaqiri, Kledi Kadiu, Tedi Papavrami, Fadil Berisha, Eda Zari, Ermonela Jaho, Olen Çezari, Gent Tukiqi, Josif Gjipali, Elina Duni, janë vetëm disa nga emrat e shumtë që sot jetojnë e veprojnë larg atdheut të tyre, por që i japin ngjyrë më te plotë dhe më të ngrohtë imazhit të Shqipërisë. Ata janë artistët tanë – krijuesit e tingullit, lëvizjes, fotografisë – që me veprat e tyre e bëjnë emrin shqiptar të kumbojë përtej kufijve të atdheut.

Prandaj, pse të mos kemi një ditë në vit vetëm për ta?

Janë ata që me mjeshtëri dhe përkushtim, bëhen ura lidhëse mes kulturave, ambasadorë të shpirtit shqiptar në një botë gjithnjë e më të ndërlikuar. Një ditë për ta nuk është vetëm një simbolikë. Është një shenjë mirënjohjeje ndaj atyre që, pavarësisht largësisë, kurrë nuk e harrojnë vendlindjen. Është një motivim për të rinjtë që rriten jashtë kufijve, t’u kujtojë se origjina nuk është pengesë, por një pasuri që duhet kultivuar me krenari. Le ta kemi këtë ditë – jo vetëm për të festuar, por për të reflektuar, për të ruajtur lidhjen me artistët që na nderojnë në botën e jashtme dhe për të ndërtuar ura bashkëpunimi që e pasurojnë të tashmen tonë kolektive. Sepse kur një artist shqiptar ngjitet në skenën e Romës, Vjenës, Berlinit, nuk është thjesht një sukses individual – është një dritë që ndriçon të gjithë kombin. Dhe për këtë ata meritojnë ditën e tyre, të cilën duhet ta caktojnë, por edhe ta koordinojnë institucionet më të larta shtetërore. Është obligim i shtetit që këta artisti, një herë në vit, t’i tubojë në një vend dhe në emër të popullit shqiptarë t’u shprehë mirënjohjen më të lartë për imazhin më pozitiv jo vetëm të Shqipërisë, por të të gjitha hapësirave shqiptare. Arti nuk ka pasaportë. Nuk njeh kufij krijimi. Por ka zemër, ka shpirt dhe ka



rrënjë. Dhe këto rrënjë janë edhe shqiptare. Ata nuk përballen vetëm me betejat e zakonshme të një artisti, por kanë edhe barrën e përfaqësimit. Ndonjëherë ata shikohen me kuriozitet, ndonjëherë edhe me paragjykim. Por pikërisht për këtë, fitorja e tyre është dyfish më e madhe – sepse e arrijnë në një botë që shpesh nuk i njeh.

Këta artistë nuk janë larg. I kemi afër. Janë frymëzim për brezat e rinj, shembull i suksesit që vjen me punë, përkushtim dhe dashuri për artin. Janë dritaret tona që hapen drejt botës, për të treguar se trevat shqiptare kanë më shumë për të thënë sesa çpasqyrojnë lajmet.

Prandaj, le t’i njohim më shumë, sepse çdo vepër e tyre është një çmim për ne si

komb. Ata janë pasuria jonë shpirtërore në botën e jashtme, e cila flet me një gjuhë që nuk ka nevojë për përkthim: me gjuhën e artit. Sepse ata jani të pranishëm në zemrat shqiptare. Prandaj, një ditë për ta është më e pakta që duhet ta bëjnë institucionet tona shtetërore...

Ese

KRIZA E LEXIMIT

Në sistemet normale arsimore, ta zëmë angleze apo amerikane, nuk ka shanse që një nxënës të kapërcejë të gjitha nivelet, të regjistrohet në universitet dhe të mos e dijë kush është Shekspiri



Gëzim ALIU

1.
Sintagma “krizë e leximit” është përdorur dhe përdoret shpesh. Sigurisht edhe vetë e kam përdorur. Por, duhet thënë qysh në fillim se në Kosovë nuk ka “krizë të leximit”. Pse?
Këtu nuk ka krizë të leximit, ngaqë, për ta pasur një të tillë, do të duhej të kishim dukuri të leximit. Dukuria e leximit, ose, për ta zbritur nivelin, normaliteti i leximit, nuk ka ekzistuar kurrë në ambientet tona. Po përmend vetëm disa faktorë.
Populli shqiptar është futur në shekullin e njëzetë pa qenë në gjendje të shkruajë e të lexojë. Mbi nëntëdhjetë për qind e njerëzve nuk kanë ditur shkrim e lexim dhe kjo mjeshtëri e panjohur zotërohej në nivel të lartë vetëm nga pak personalitete, të shkolluar e të formuar gjithandej Evropës e botës. Me pak përjashtime, gjyshërit e stërgjyshërit tanë të gjithë kanë qenë analfabetë. Vetëm paramendojeni këtë! Shumica nga ne i mbajmë mend gjyshërit tanë, edhe nga ana e babës, edhe nga ana e nënës. Besa, nderi, mikpritja etj., kanë qenë virtytet e gjyshërve tanë. Po ashtu, edhe gjakmarria, “virtyt” kanunor edhe ky. Dhe, deri diku, këto virtyte na shquajnë edhe sot e kësaj dite. Vetëm se ne, nipërit e mbesat, tashmë nuk jemi më analfabetë kanunorë origjinalë, ngase nëdërkohë, përgjatë zhvillimeve të afërta historike, ka ndodhur diçka shumë e rëndësishme për shqiptarët:
Ne jemi populli i vetëm në Ballkan që kemi themeluar dy universitete kombëtare në shekullin e njëzetë dhe atë në gjysmën e dytë të këtij shekulli; të gjithë të tjerët, pra, i kanë themeluar më herët. Ndërkaq, sot, diplomat e këtyre universiteteve tona, po nuk qëllove për nga shpirti kureshtar e punëtor, nuk të duhen shumë. Dija që merr në këto universitete është e pafreskuar me arritjet e reja, literatura mungon ose është ideologjike dhe me mungesa, punë kërkimore-shkencore bëhet pak dhe, më e keqja, nuk ka kurrfarë plani afatshkurtër apo afatmesëm për ta nxjerrë sistemin universitar nga kolapsi. Sidomos në Kosovë.
Këtu në Kosovë, universiteti publik dhe klonet e stërkequr të tij, prodhojnë mësues, të cilët pastaj, duke zëvendësuar kuadrot e vjetra, qarkullojnë nëpër shkolla dhe ngadalë e sigurt përgatisin studentë të ardhshëm që me besnikëri e vazhdojnë mirëmbajtjen e kolapsit arsimor, edukativ e shkencor. Shkurt e trup, ose, shkurt e shqip, sistemi arsimor këtu, njëherë për njëherë, natyrisht me disa përjashtime

jo fort ndikuese, është në vdekje klinike ose, për ta zbutur këtë qëndrim, është në dhomën e kujdesit intensiv të shoqërisë sonë me një milion telashe elementare, siç është, për shembull, mungesa e furnizimit të rregullt me rrymë elektrike dhe ujë të pijshëm.
Natyrisht që prapambetjet historike, politike, sociale, arsimore dhe sidomos kulturore, përcjellë edhe me telashtet e ekzistencës së përditshme, njeriun shqiptar e kanë mbajtur larg mjetit kryesor të shoqërive të emancipuara: nga libri. Shoqëria shqiptare për një kohë të gjatë ka qenë shoqëri e fjalës së folur. Fjala e shkruar, copa-copa edhe kjo, është bërë pjesë e shoqërisë tonë vetëm në këto shtatëdhjetë apo tetëdhjetë vjetët e fundit. Kështu, edhe leximi i fjalës së shkruar. Kur vjen puna te pëlqimi i fjalës së folur, ne nuk dallojmë shumë nga gjyshërit tanë analfabetë kanunorë. Ne e pëlqejmë shumë fjalën e folur, që tashmë është zhvendosur nga oda te kafeneja. Besa, nderi, mikpritja kanë pësuar goditje të rëndë nga kjo zhvendosje, mirëpo fjala e folur nuk ka pësuar gjë. Përrallat për të tjerët dhe thashethemet janë llojet narrative që na pëlqejnë më së shumti. Muji e Halili janë zëvendësuar nga mujsharët e politikës dhe të bëmat e tyre. Legjenda dhe e vërteta lidhen gërshetë e vazhdojnë të lidhen me ndihmën e të gjithë neve. Natyrisht që makiamo është dëshmitare e të gjithë këtij folklori autokton, si gjithherë.

2.
Edhe kur normaliteti i leximit nganjëherë interpretohet si dukuri e dikurshme, e mëhershme (në stilin e njohur njerëzor ankues se dikur ishte më mirë se tash, gjë që është rrenë e kulluar), duke vënë theksin sidomos te periudha komuniste andej e këndej kufirit, ajo, fatkeqësisht, ishte mjaft ideologjike, madje edhe shtrënguese. Andej lexohej literaturë propagandistike dhe real-socialiste, këndej leximi bëhej i nxitur nga faktorë të jashtëm, si përpjekje për gjetjen dhe ruajtjen e identitetit kombëtar shqiptar. Të dyja format e leximit, pas lirisë së fituar, ranë përtokë dhe leximi i librit, sidomos i letërsisë, mbeti me pak “lexues normalë”.
Dhe, sot, të gjithë ne pajtohemi se kultura e leximit është tejet e varfër dhe me boshllëqe. Në Kosovën nën okupimin klasik, rol të madh në krijimin e boshllëqeve të tilla, natyrisht aspak me dashjen tonë, ka luajtur koha e shkollimit paralel, kohë kur janë thyer shumë dhëmbëzorë të asaj që quhet makinë

logjike; disa gjenerata janë shkolluar dhe kanë diplomuar me minimumin e dijeve të fituara, që i bie, shumica prej tyre kanë mësuar kryesisht shkrim e lexim. Ndër pjesëtarët e dalë nga kjo makinë logjike me dhëmbë të thyer sigurisht që janë edhe qindra arsimtarë të gjuhës e të letërsisë dhe pasojat po vërehen gjithandej. Ta zëmë, ndodh shpesh që studenti i letërsisë i vitit të parë të mos i njohë shkrimtarët kryesorë shqiptarë. Ose, ndodh që nxënësi ynë i kalon të gjitha fazat e shkollimit parauniversitar, shkon në fakultet, kryen master, pastaj bëhet doktor, të themi i ekonomisë dhe gjatë kësaj kohe nuk e ka lexuar as edhe një roman. Madje as Robinson Kruzonë! Megjithatë, nëse nuk ka pasur e nuk ka dukuri të leximit, ashtu që për të pasur krizë të leximit, këtu ka pasur dhe ka lexues, pasi që, edhe ai apo ajo që po e lexon në këto çaste këtë shkrim, është lexues/e.
Lexuesit këtu ndahen në dy grupe: lexues pasivë dhe lexues aktivë.
Lexues pasivë janë ato e ata që i lexojnë titrat e telenovelave. Do të thotë, i lexojnë dialogët e personazheve sentimentalë dhe bilanci njëvjeçar i leximit mund të rezultojë me disa volume të trasha. Lexues pasivë janë edhe ato e ata që i lexojnë recetat e gatimeve. Librat e gatimit janë ndër më të shiturit. Po ashtu, lexues pasivë janë edhe ata e ato që i lexojnë titujt e gazetave apo portaleve. Shumë njerëz e fillojnë gazetën së prapthi, fillojnë të vdekja, kalojnë nëpër horoskop e dalin te kryelajmet. Bukur, apo jo? Një gjetje postmoderne.
Ndërkaq, lexuesit aktivë ndahen në tri nënkategori.
Nënkategoria e parë janë studentët. Kosova i ka diku pesëdhjetë apo gjashtëdhjetë mijë studentë të cilët, me qejf a me zor, duhet ta lexojnë literaturën bazë, ashtu që për t’i dhënë provimet. Shumë nga ta i lexojnë vetëm parathëniet, pasthëniet, apo edhe skriptet (dispensat), aq sa për ta marrë një notë kaluese. Shumica nga ta lexojnë shumë pak letërsi. Nga gjithë kjo turmë studentësh, do të duhej që së paku t’i kishim një mijë lexues të letërsisë, pra blerës potencialë librash letrarë. Por, nuk i kemi. Arsyetimi që nuk kanë para mbytet lehtë në lëngun e kafeve të shumta që i pinë për çdo ditë të lume të Zotit. As arsyetimi që nuk kanë kohë nuk qëndron. Secili student/e mund t’i lexojë njëzet, tridhjetë, madje edhe pesëdhjetë faqe në ditë. Po mendoj, student/e që dëshiron ta zgjerojë shpirtin e mendjen e vet.
Nënkategoria e dytë janë lexuesit që

kërkojnë letërsi popullore, të tipit të Coelho, Danielle Steelit, Dan Brownit, e kështu me radhë. Kjo është letërsi argëtuese, e thurur me gjuhë të thjeshtë, me vijë fabulative të qartë, shpesh me një enigmë që ta mban kureshtjen zgjuar deri në fund, me personazhe që vuajnë tërë kohën, por në fund e gjejnë qetësinë apo ndriçimin shpirtëror; autori në këto romane shpesh e luan edhe rolin e këshilluesit psikologjik, është njëfarë psikologu letrar. Literatura e tillë i shkon përshtati shoqërisë konsumuese dhe prandaj shitjet e ekzemplarëve janë të mëdha. Por, si gjithçka që ka të bëjë me trendët, librat e tillë, me pak përjashtime, shumë shpejt harrohen. Sepse, shija popullore kërkon gjithmonë produktin e radhës.
Nënkategoria e tretë e lexuesve aktivë, janë lexuesit e thellë. Lexuesit e thellë kërkojnë diçka më tepër se argëtim. Ndonëse kënaqësia që jep teksti letrar është ndër esencat e letërsisë, ky tip i lexuesve nuk kërkon vetëm kënaqësi. Ky tip lexuesi, përveç letërsisë së madhe e të bukur (beletristikë), kërkon edhe literaturë filozofike, libra të mirë historikë, shkencorë etj. Mendoj se te ne, lexues aktivë të nënkategorisë së tretë mund të jenë disa qindra. Dhe, megjithatë, sado që nuk jemi të kënaqur, mendoj se nuk janë pak. Do të mund të ishin disa dhjetëra!
Pra, pasi e shpërndamë lexuesin në dy kategori kryesore dhe në disa nënkategori, mund të arrijmë në përfundimin se në Kosovë ka lexues, por ende nuk ka normalitet të leximit. Prandaj, nuk ka as dukuri të leximit dhe natyrisht nuk ka as krizë të leximit. Do të doja të kishte krizë të leximit, ngase krizat edhe përfundojnë. Për fund, një konstatim! Pa u stabilizuar sistemi arsimor, pa e nxjerr këtë sistem nga dhoma e kujdesit intensiv, normalitet të leximit nuk do të ketë kurrë. Në sistemet normale arsimore, ta zëmë angleze apo amerikane, nuk ka shanse që një nxënës të kapërcejë të gjitha nivelet, të regjistrohet në universitet dhe të mos e dijë kush është Shekspiri.
Sistemit tonë arsimor parauniversitar i ndodh që të lëshojnë “tufa” nxënësish të papërgatitur për shkollim superior, shpesh gjysmanalfabetë e analfabetë funksionalë dhe këta, duke mos gjetur punë dhe mundësi për ta realizuar veten, në mënyrë që t’i shtyjnë edhe nja tri apo katër vjet të jetës së tyre rinore, regjistrohen fare lehtë nëpër fakultete dhe madje nganjëherë edhe arrijnë të doktorojnë!
(2015)

Nga libri në proces


HERMETIZMI NË DRAMAT E BEQIR MUSLIUT

Duke trajtuar pyetje të thella mbi ekzistencën, identitetin dhe kuptimin e jetës, dramat e tij shprehin një hapësirë më të gjerë konfliktesh në të cilën kryqëzohen dhe artikulohen një varg dëshmish letrare, kulturore, historike, biblike, kuranore që ju takojnë periudhave e hapësirave të ndryshme të jetës së shqiptarit

Dr. Luljeta ISAKU

Beqir Musliu i takon gjeneratës së parë të autorëve modernist të dramës shqipe në Kosovë. Prurjet që autori solli iu nënshtruan një ndikimi të fuqishëm në dramaturgjinë evropiane. Poetika e tyre imponoi forma të reja më të avancuara të shprehjes artistike. Tema e dramave të tij i kthehet ekzistencës kombëtare, në të cilën spikaten konotacione harresash mitike e historike. Kryesisht i referohen një qasjeje letrare dhe artistike që karakterizohet nga mbyllja dhe abstraksioni me tendencë për të shmangur drejtpërdrejtë realitetet shoqërore. Kjo lloj letërsie hermetike përdor simbole komplekse, metafora të thella dhe gjuhë enigmatike. Dramat e Beqir Musliut (“Shtrigani i Gjel Hanit”, “Faustina” , “Unë Halil Garria”dhe në seancat e parabollat e ndryshme të tyre, “Ora e Kukuvajkës, “Sahati i murit”, “Vallëzuesit me maska”, “Balloja e shtrigave”, “Kalorësit e vdekjes”, etj) flasin për gjendjen e dikurshme më të lakmueshme, për gjakimet e përjetshme dhe për pushtimin e horizonteve të lirisë. Fisnikërojnë shpirtin e njeriut dhe arsyetojnë e miratojnë me devotshmëri ngadhënjimin e së mirës mbi të keqen njerëzore, individuale dhe kombëtare. Element thelbësor që përshkon krijimtarinë e tij dramatike është hermetizmi që ndërthuret me mite dhe legjenda, duke krijuar një raport të pasur mes realitetit të përditshëm dhe botës arketipale. Nëpërmjet kësaj mbylljeje ai shpreh ide komplekse, ndjenja të thella dhe reflektime filozofike. Duke përdorur gjuhë simbolike dhe struktura narrative të ndërlikuara ai përqafon një stil enigmatik dhe abstrakt. Si të tilla, këto drama shënojnë nismën e dramës shqiptare të postmodernizmit. Ngjarjet zhvillohen përmes procesit figurativ të alkimisë si metaforë e shpërndërrimit metafizik dhe si proces i repeticionit. Duke trajtuar pyetje të thella mbi ekzistencën, identitetin dhe kuptimin e jetës, dramat e tij shprehin një hapësirë më të gjerë konfliktesh në të cilën kryqëzohen dhe artikulohen një varg dëshmish letrare, kulturore, historike, biblike, kuranore që ju takojnë periudhave e hapësirave të ndryshme të jetës së shqiptarit. Lënda, burimet dhe frymëzimet janë të marra kryesisht nga e kaluara që gërshetohet me aktualen. Në to mbindërtohen mitet dhe legjendat, që në letërsinë popullore shqiptare erdhën pikërisht përmes baladave të ndryshme. Prania e ankthit, tmerrit, delirit vijnë në forma e drejtime të ndryshme epike, lirike dramatike, groteske e satirike.

Personazhet shpesh nuk përfaqësojnë vetëm individë të veçantë, por ide universale, koncepte filozofike dhe dilema ekzistenciale. Dialogët e personazheve janë të pasura me aluzione dhe gjuhë figurative. Konflikti i brendshëm i tyre simbolizon përplasjen mes idealeve dhe realitetit. Duke u larguar nga format klasike e lineare, struktura e veprave të tij dramatike është fragmentare, çka pasqyron kaosin e botës moderne dhe kompleksitetin e jetës njerëzore. Nëpërmjet komunikimit hermetik të personazheve, Beqir Musliu paraqet natyrën kosmike të ndërlikuar të njeriut, i cili ka rolin dhe kohën në të cilën jeton. Jeta nuk është vetëm ëndërr dhe iluzion, por është edhe vështrim e realitet. Jeta është e përkohshme dhe ka fillimin e fundin e saj. Njeriu nuk arrin gjithmonë t’i realizojë të gjitha obligimet dhe detyrat



që ia përcakton vetes. Jetës i skadon koha, por jo edhe ideja për amshim. Individi nuk mund të jetojë i veçantë dhe nuk mund të jetë i huaj. Ai jeton në kolektivitet. Këtu lindin kundërtëhëniet e jetës reale ku e përgjithshmja kolektive formon edhe të përgjithshmen individuale. Konfliktet në dramat e Beqir Musliut inicohen nga forcat e bashkuara irracionale, zhvillohen në formë parabolash dhe përfshihen nga elementet mitike të ndërlidhura me fatin kombëtar. Ky është fati kolektiv dhe këto forca kërkojnë ngadhënjim konkret në simbolikën e arsyes. Hermetizmi shfaqet përmes përdorimit të simboleve, aluzioneve, strukturave të thyer dhe trajtimit të tematikave filozofike që dalin jashtë realitetit të përditshëm. hermetizmit krijon një atmosferë të pasur dhe të ndërlikuar, ku natyra e njerëzve dhe shoqërisë shqyrtohet në mënyrë të thellë dhe abstrakte. Kjo është metaforë

për krizën shoqërore dhe personale, që pasqyrojnë mënyrën se si individët dhe shoqëria e përjetojnë botën. Procesi i krijimit të vetëdijes së njeriut, paraqet luftën e pandërprerë që ai bën mes të mirës dhe të keqes gjatë jetës. Ky është proces i gjatë dhe ndodh që vetëdija të mbetet e pandryshuar, sepse njerëzit herë veprojnë me arsye e herë me instinkte. Vetëdija e njeriut ka kod etik. Ajo aktivizohet në rrethana konkrete brenda raporteve të caktuara të kohës. Nxitet nga idetë që dominojnë në hapësirën konkrete. Prandaj, e mira dhe e keqja janë relative. Figuracionet paraqiten si veçori specifike dhe origjinale, nëpërmjet të të cilave integrohen elemente shumështrësore postmoderniste. Ideja, kuptimet dhe mesazhet hapin rrugët për katarsë dhe veprim drejt përvetësimit të qëllimeve më fisnikëruese të jetës. Poetika e këtillë zë fill në jetën e përditshme.

Pakënaqësia me gjendjen konkrete, mënyra për ta ndryshuar jetën me ngritje të dinjitetit njerëzor dhe me ndërgjegje, ngacmon forcën e veprimit dhe të krijimit për t’u ngritur mbi tjetërsimin dhe fatalizmin. Të gjitha këto aspekte e përbëjnë një poetikë shumë komplekse të dramave të Beqir Musliut.

Me ndërtimin e poetikave sublime këto drama kanë sjell vlera të çrnuara, ide estetike dhe vizionare në dramaturgjinë shqiptare. Poetika e Beqir Musliut ngërthen forma më të ndryshme të ekzistimit njerëzor, individual dhe kombëtar. Me format e jetës së dukshme dhe asaj të padukshmes ajo përbën zinxhir të pakëputshëm në mes të mitikes, biblikes dhe aktuales Ngritja cilësore e dramës së Beqir Musliut paraqet kumt të ideve dhe përkapje e shqetësime historike dhe aktuale të njerëzimit.

Aktuale

MOS SHKRUAJ NËSE NUK KE MENDUAR

Të shkruarit sot është bërë shumë i lehtë: lexon disa artikuj, ndoshta edhe disa libra, i bashkon disa mendime të huaja dhe ja—u bë një artikull



Sead ZIMERI

Shpesh lexoj artikuj opinionistësh në gazetatat online dhe më vjen keq për ata që i kanë shkruar, sidomos për ata që shkruajnë me një vetëbesim apo kompleksitet të pajustificuar. Më vjen keq sepse e shoh singeritetin në ato shkrime. Por nën atë singeritet shfaqet një padituri e thellë dhe mungesë e të menduarit analitik që më bën të skuqem nga sikleti. Njerëz—merreni mundimin të dalloni mes të lexuarit të diçkaje dhe të menduarit

përmes saj. Të shkruarit sot është bërë shumë i lehtë: lexon disa artikuj, ndoshta edhe disa libra, i bashkon disa mendime të huaja dhe ja—u bë një artikull. Por aty nuk ka mendim. As përpjekje për të nxjerrë një ide që pasqyron një proces real të të menduarit. Vetëm përsëritje mekanike e mendimeve të të tjerëve—shpesh të keqkuptuara, shpesh të shtrembëruara. Mos nxito të publikosh çfarë të vjen në mendje. Ulu. Jepi vetes kohë. Kalo nëpër mend ato që dëshiron të thuash dhe pyete veten: a ka diçka timen

këtu? A e kam zbërthyer këtë mendim deri në rrënjë, apo thjesht po e përcjell? Dhe kur ta kesh shkruar, lexoje sikur të mos ishte i yti. Çfarë ke bërë realisht? A sheh ndonjë gjurmë të mendimit tënd aty, apo është thjesht zhurmë e veshur si mendim? Ky është problem edhe me shumë akademikë. Shkruajnë sepse duhet të botojnë—dhe në këtë proces, humbin kohën e tyre dhe, më me rëndësi, kohën tënde. Ti lexon, konsumon plehura, dhe nuk mëson asgjë me vlerë. Si lexues, më intereson vetëm një gjë:

çfarë ke për të thënë, dhe si e mbështet atë që thua. Dhe unë besoj se ti, si autor, ke aq përgjegjësi intelektuale sa të respektosh lexuesin tënd—të japësh diçka që ka vlerë. Diçka që do të të bënte ty krenar dhe lexuesin të ndjehet i shpërblyer. Nëse shkruan në një mënyrë që lexuesi nuk e kupton, ose më keq, nëse shkruan në një mënyrë që e mashtron lexuesin sepse nuk je kujdesur të mendosh mirë për ato që thua, atëherë po i bën dëm lexuesit tënd. Në këtë mënyrë, e zhvesh edhe veten nga dinjiteti intelektual.

Fati i artistit

MES SHKRIMIT DHE PIKTURËS

Letërsia është si ajo princesha e bukur që, nëse ti dëshiron të rrish me të, kërkon prej teje të plotësosh disa kushte. Ajo është kapriçoze, tekanjoze

Artur SPANJOLLI

Sa më shumë e dashuroj thellësisht letërsinë dhe i kushtoj asaj 80 për qind të vetes, të brendisë sime shpirtërore — me lexime, shkrime, reflektime — aq më shumë ajo, nga ana financiare, nuk më jep asgjë në kthim. Përkundrazi, kërkon gjithnjë e më shumë prej meje. Jo vetëm kohën, impenjimin dhe kujdesin, por edhe investimin financiar. Ndërkaq, me pikturën — të cilës i kushtoj vetëm 20 për qind të energjisë sime, në telajo, vizatime, akuarele, portrete etj. —, sikur ajo të donte të më shpërblente padrejtësinë me mirësi, më furnizon me 100 për qind të të ardhurave që më nevojiten për të përballuar jetën. Shkurt, ajo që e dua fort nuk ma shpërblen proporcionalisht mundin, ndërsa ajo që e bëj si me gjysmë dëshire, ose që jam i detyruar ta dua, më mban gjallë financiarisht. Ky është një paradoks që përmban edhe ironi. Jeta është plot me paradokse. Fakti është se brenda meje, mes ngjyrës dhe fjalës, ka fituar fjala që prej dekadash — jo se ngjyra është më pak e bukur, më pak “e dobishme”, më pak intrigante apo tërheqëse për artistin. Se sa e bukur dhe magjepsëse është ngjyra, këtë e ka dëshmuar plejada e artistëve gjigandë ndër shekuj. Por ja që fjala më tërheq më shumë. Mendimi, figurat letrare, mundësia për të shprehur ndjenjat nëpërmjet fjalës — janë një mrekulli më



vete.

E ndjej të sqaroj se asnjëra nga të dyja nuk është superiore ndaj tjetrës. Secila

ka funksionin e vet, rëndësinë e vet, rolin e vet në ushqimin shpirtëror të njeriut. Nuk e kultivoj pikturën sa ç'bëj me

shkrimin, për arsyen e thjeshtë se, kur merrem me pikturë, nuk bëj kërkime të mirëfillta artistike. Nuk e vë në lëvizje

trurin krijues për të sajuar gjëra të reja, të paparë për mua. (Në të vërtetë, gjithçka është bërë dhe krijuar nga njeriu. Ne nuk bëjmë tjetër veçse përpiqemi të interpretojmë kohën tonë përmes çelësit të leximit të kësaj epoke.)

Pra, duke mos kërkuar, duke mos rrezikuar për të eksploruar shtigje të reja në telajo — ashtu siç i ka hije një piktori të vërtetë —, atëherë, duke përsëritur të njëjtat tablo që e di se shiten (pakt me djallin, për hir të blerësit), e kuptoj që artisti shet talentin e tij. Bën një kompromis me publikun, me konsumatorin. Në atë rast, piktura nuk

më argëton siç duhet. Nuk ma nxit etjen krijuese, nuk më lë pa gjumë, nuk më shtyn, nuk më ysht të eksploroj në pyllin e panjohur të nëndërgjegjes artistike — aty ku gjendet ofiçina krijuese e artistit. Ndaj fle mbi dafina, bëj ato gjëra që i di përmendësh dhe kënaqem me të ardhurat ekonomike. Ndërsa me shkrimin është krejt ndryshe. Shkrimi është e dashura e vështirë — për të mos thënë e pamundur. Aty jam princ i fletës. Zot i asaj që shkruaj. Me të, nuk e mendoj kurrë se çfarë kërkon tregu prej meje. As nëse do të më shitet libri apo jo. Mendoj vetëm si të jem sa më i singërtë me fletën, si të shpreh emocionet,

mendimet, figurat letrare, reflektimet, në një formë sa më interesante dhe origjinale mbi jetën. Aty nuk bëj kompromis me askënd. Nuk e shes talentin tim. Nuk përkulem, sepse nuk shkruaj për t’u bërë i famshëm apo popullor. Shkruaj për veten time. Aty nuk shoh në sy askënd. Nuk shkoj drejt lexuesit. Nëse ai gjen gjëra interesante, le të vijë vetë drejt meje. Ky është dallimi thelbësor brenda meje, mes shkrimit dhe pikturës. Letërsia është si ajo princesha e bukur që, nëse ti dëshiron të rrish me të, kërkon prej teje të plotësosh disa kushte. Ajo është kapriçoze, tekanjoze. Ajo kërkon

prej teje kushte çmendurake. Më shumë të merr sesa të jep. Më shumë kërkon sesa fal. Të fal kënaqësi krijuese pa fund. Të jep emocione të rralla. Por, siç e thashë, është e shtrënguar, dorëshkurtër me të mirat materiale.

Megjithatë, ajo duhet dashur fort edhe në kushte të tilla. Si ajo princesha që ka rënë në dashuri me një barbon dhe që me çdo kusht do ta fusë atë në shoqërinë dhe familjen e saj — ashtu edhe shkrimtari, i dashuruar me fjalën, nuk ka as në mendje ta tradhtojë apo ta braktisë atë.

Vendi i gjurmëve

ODA, NJË ANDËRRR QË U KTHYE NË SHPI ARTI

ODA – galeria jeme e vogël. Fillimisht lindi n’kambët e dhimbjes, mandej n’krahët e dashnisë



Rozafa SHPUZA

A ke pa ndonjiherë se si digjet një shpi..., të digjet, por jo të zhbahet sikurse shkrumbohet druni apo letrat? Unë e kam pa. E kam pa teksa shkrumbohej shpija e prindve të mi – ajo ndërtesa 150-vjeçare n’zemër të Shkodrës, afër Dugajve të Reja, rranzë rrugës që t’çon te Marubi. E kam pa tue u djegë, jo veç si mure e trena, por si tanësi, si kujtim, si frymë. Bashkë me të u dogj biblioteka e vyeme e tim eti, u dogjën albume unikë brezash, u dogjën orendi që ishin aty qysh prej fëminisë për me m’rrëfye rrugëtimin tem... E s’mbeti ma kurgja, përpos tymit që naltohej tue transportue ndër re ato pak copëza të një jete tashman’arrati. Prej asaj dite, ndjeva se diçka duhej me lindë – jo n’vend të saj, por prej saj.

Kështu lindi ODA – galeria jeme e vogël. Fillimisht n’kambët e dhimbjes, mandej n’krahët e dashnisë.

Asnjëherë s’e kam ba këtë për modë, as për me ba zhurmë, as për me u dukë si

galerie apo kuratore. E kam ba për me i dhanë frymë, vedit ma parë e mandej kujtimit të prindve t’mi. E kam ba për me ia kthye asaj shpije gjallninë e dikurshme, me ia rikthye ngjyrat, zanet e gëzueshme. E kush tjetër përveç shpirtnave të lirë të artistëve mundej me e bakët akt human? Kësisoj, ditë pas dite, kam zhba blozën e kam zbardhë muret, kam vizatue murale në atë rrugicë të vjetër për me i ba kalimtarët indiferentë me kthye rrugë e me ardhë në Odë. Jua kam prezantue Odën teme dhjetra miqve artistë kudo nëpër botë. Pak nga pak, shpija e vjetër filloi me marrë frymë përsëri, plot ngazëllim. N’muret, ku ma përpara vareshin kujtime stërgjyshash në sepje, sot ekspozohen piktura, fotografi, skulptura, recitohen poezitë e këndohen kangët e artistëve të ardhun prej diku tek.

Prej vitit 2019, ODA ka mikpritë mbi 100 artistë – nga të gjitha anët e trojeve shqiptare, prej diasporës e ma larg. Artistët kanë pasë gjithmonë diçka për me thanë. Kanë ardhë ata që kanë dashtë

me e nda shpirtin e tyne me të tjerët – përmes ngjyrës, dritës, zanit apo leximit. Kanë ardhë artistë prej Kosovës, Malit të Zi, Maqedonisë së Veriut, Gjermanisë, Norvegjisë, Italisë, Zvicrës, Amerikës e vendeve të tjera... – kanë ardhë këtu jo si mysafirë, por me dëshirën me komunikue me një publik që kurrë ma parë s’i kishte njoftë punët e tyne.

Jam mikpritëse, jam ndigjuesja e rrëfimeve që sjellin artistët kur vijnë me punimet e tyne, jam guida që u rrëfen bukuritë e Shkodrës. Jam ajo që mbaj çilsat e një dere që nuk mbyllet për askënd që ka diçka për me nda me artdashësit. Këtu, arti nuk asht veç ankand shitjesh, por asht shpirt që pluskon me ritmin e një qyteti i cili ka shumëçka për me rrëfye. E kjo shpi që dikur gazmonte prajshëm prej zaneve të prindve të mi të mrekullueshëm, fisnikërisë së gjyshes, lojnave të vëllezënve – sot asht ba shpi arti, shpi ku performancat artistike nuk presin zyrtarizma. ODA nuk asht institucion i ngurtë me rregulla fikse, por

nji vend ku jehon i lirë zani i shpirtit të çdo artisti.

A mundet një shpi e vjetër me e pasë kët manjetizëm? A mundet një njeri i vetëm me organizue kaq shumë ekspozita e me sjellë artistë prej mbarë botës, disa prej të cilëve e shifnin për herë të parë Shkodrën? Shumë sfida, shumë dyzime, shumë kundërshti – por ODA e vogël ia doli, e tash ndihem mirë me çka kam arritë.

Një artiste nga Kosova, tue cakrrue gotat e venës në oborrin e ODES, m’tha njëherë: “Rozafë, ti je ba ura që na ke lidhë me Shkodrën.” M’u mushën sytë me lot prejse kuptova se ajo që kam ba me shpirt e ka pasë një vlerë.

Nuk di si ka me u shkruie historia e kësaj galerie nesër. Por sot, mundem me thanë me bindje: ODA asht një vend ku artistët ndihen si n’shpinë e tyne, ku arti s’ka korniza. E në çdo vepër arti, në çdo za – ka pak prej secilit që ka lanë një gjurmë këtu. Kjo asht ODA jeme...

E tash, mundem me thanë – asht pak edhe e jueja.

Majlinda Rama, shkrimtare dhe studiuese

POEZIA, NJË PROCES QË ZBULON DHE ÇLIRON

Gratë sot shkruajnë bukur dhe për gjithçka; për ndjenjat, dëshirën, trupin, dhunën, pushtetin, historinë, dashurinë, mëmësinë, edhe për heshtjen dhe, e bëjnë këtë me zë të fortë, të vetëdijshëm dhe shpeshherë tronditës

Shkëlzen HALIMI

Majlinda Nana Rama në vendlindje (Tepelenë) ka marrë mësimet e para e ato të mesme. Gjatë viteve 1998–2002, ka kryer studimet e larta për Letërsi dhe Gjuhë Shqipe. Në vitin 2012, ka përfunduar Fakultetin e Shkencave Politike në degën Marrëdhënie Ndërkombëtare. Në vitin 2014 merr titullin Master i Shkencave në Shkenat Politike dhe Juridike. Është themeluese dhe drejtuese e Panairit Kombëtar të Librit “Fieri”. Është pedagoge në Universitetin e Arteve, Tiranë. Si shkrimtare, Majlinda Rama u bë e njohur me romanin “Perandorët”, i cili bëri jehonë të madhe për shkak të tematikës së mprehtë, trajtimit dhe mpleksjes fabulare të shumë elementëve. Stili i veçantë i Majlindës ra menjëherë në sy të kritikëve e studiuesve më të njohur të kohës, si: Ali Aliu, Nasho Jorgaqi, Jorgo Bulo, Klara Kodra e shumë të tjerë, të cilët panë te shkrimtarja e re një talent të spikatur.. Në vitin 2019, Majlinda Rama u përfshi në kolanën studimore të akademikut Ali Aliu mbi veprën e autorëve më të mirë bashkëkohorë, në krahë të shkrimtarëve të njohur, Ismail Kadare, Dritëro Agolli, Fatos Arapi, Azem Shkreli, Zija Çela dhe Kim Mehmeti. Krijimtaria e Majlindës është pritur mirë dhe vlerësuar nga kritika letrare brenda dhe jashtë vendit. Letërsia e saj është promovuar dhe përkthyer në shumë vende, si në: Kosovë, Maqedoni, Mali i Zi, Gjermani, Francë, Zvicër, Austri, Belgjikë, Poloni, Holandë, Hungari, Spanjë etj. Është autore e shumë veprave dhe bartëse e shumë çmimeve.

HEJZA: Letërsia shqiptare ka përjetuar ndryshime të mëdha në tri dekadat e fundit, ku zëri i grave është bërë gjithnjë e më i dukshëm. Ju jeni një ndër ato zëra që kanë ndikuar fuqishëm këtë zhvillim. Si e shihni sot rolin e autores femër në letërsinë shqiptare? A është grua-shkrimtare ende një kategori që kërkon të dëshmojë dyfishin për të qenë e dëgjuar?

MAJLINDA RAMA: Së pari, ju falënderoj për këtë intervistë, që shpresoj të sjellë diçka të vlefshme për lexuesin e Hejzës. Përsa i përket konstatimit tuaj, nëse jam një nga ata ‘zëra që kanë ndikuar fuqishëm këtë zhvillim’, do të isha e lumtur, por nuk besoj se zëri im është më i rëndësishëm se ai i shumë grave të tjera, që kanë shkruar, folur apo edhe heshtur me dinjitet. ‘Roli i gruas në letërsi’, që këtu, pra te përcaktimi gjinor, mendoj se ngrihet një paragjykim ‘sulmues’ që e ngarkon me një lloj stigme këtë letërsi, sepse krijimi nuk duhet parë si i grave dhe i burrave, por si letërsi, kombëtare, lokale, apo përtej kufijve. Në Shqipëri, me të drejtë e konstaton ju, gratë, për shumë arsye, duhet të ‘bërtasin’që të dëgjohen. Kjo, jo sepse ato nuk vlejné, por sepse ‘notojnë’ në statusin e përjashtimit. Përjashtimi, kurdo dhe kudo që ndodh, të zvogëlon, të tkurr, të demotivon edhe si ndjesi, edhe si përfshirje në inferioritet, edhe si proces, pra, që këtu nis beteja e gruas, e fillon startin me më pak. Por, një gjë duhet theksuar, sado përjashtuese të jenë rrethanat dhe sado gruaja krijuese ta mbart në vetëdije idenë e margjinalizimit të saj, apo mungesën e së drejtës, për shkak të ‘gjinisë së butë’, ajo ka gjetur forma proteste dhe rrugë shpërthimi. Është pak, ndoshta. Por, në një vend si yni që, ndër shekuj është parë si ‘i egër’, ‘i izoluar’, ku burrat kanë dominuar burrat çdo fushë të jetës, gratë janë parë si qenie që duhej të



bënin jetë të heshtur, nëse s’donin të binin në grackën e kryqëzimit kolektiv. Prandaj, ajo mund të ketë mbetur gjatë e fshehur ose e përfaqësuar pak, por jo e përfaqësuar keq, përkundrazi. Historia ka treguar se shumë gra shqiptare ia kanë dalë të bëhen zë publik. A është gruaja ende e detyruar të dëshmojë dyfishin për të qenë e dëgjuar? Ndoshta po, sepse zëri i saj akoma perceptohet si i padëgjuar mjaftueshëm dhe aty ku ndërtohet një perceptim, aty ndërtohet edhe një precedent, që mbetet permanent aq sa edhe perceptimi. Ajo që unë shoh dhe besoj, është se gruaja goftë krijuese, studiuese, apo aktiviste e të drejtave të grave, po bëhet aktive dhe po e ndihmon shoqërinë për të rindërtuar një kujtesë kolektive, që ka qenë shpesh e fragmentarizuar. Mendoj se gruaja, në çdo formë komunikimi që zgjedhë t’i flasë botës, paraqet kërkimin e një imazhi të drejtë, të plotë dhe të vërtetë, jo thjesht për t’u dëgjuar me çdo kusht, por për të mos e lejuar harresën.

HEJZA: Tradicionalisht, figura e gruas në letërsinë shqipe është trajtuar shpesh në mënyrë të idealizuar, sipërfaqësore ose viktimë e përhershme. Por, autorët gra kanë nisur të rrëfejnë një realitet tjetër, më kompleks, më të vërtetë. Si ndiheni ju në raport me këtë “rilindje” të personazheve

femra në letërsi? A mendoni se autorja e sotme është më e lirë për të rrëfyer gra që nuk janë thjesht të vuajtura, por edhe të rrezikshme, ambicioze, të papërmbajtura?

MAJLINDA RAMA: Po, mund ta themi se sot po përjetojmë një lloj ‘rilindjeje’ të figurës së gruas në letërsinë shqipe, jo më si simbol i durimit, sakrificës apo thjesht idealizimit, por si një qenie njerëzore e plotë, e gjallë, ndonjëherë kontradiktore, shpesh e ndërlikuar, shumë herë e lirë. Edhe autorja grua është padyshim më e lirë, jo vetëm për të rrëfyer gra që vuajnë, por edhe gra që sfidojnë, që gabojnë, që kërkojnë pushtet, që janë të guximshme për t’u vënë përballë normave dhe kufizimeve tradicionale. Kjo është një hapësirë që është krijuar me mund, duke thyer tabu, pritshmëritë stereotipa dhe modelet e trashëguara. Por, në këtë evolucion të figurës së gruas në letërsinë shqipe, nuk janë vetëm autorët gra ato që kanë sjellë zëra dhe përfytyrime më të vërteta, shpesh më të ndërlikuara apo komplekse të femrës personazh. Shumë shkrimtarë burra kanë kontribuar në një formë emancipimi letrar dhe jo vetëm, duke i dhënë personazhit femëror më shumë liri, vetëdije dhe thellësi, ku gruaja nuk është thjesht objekt dashurie, simbol sakrifice apo figurë e heshtur në

sfondin me histori mashkullore, por një qenie me kërkesa të qarta, me dilema, pasione, me lot, me ndjenja, udhërrëfyese, vendimmarrëse. Kjo qasje, tregon jo vetëm një ndjeshmëri më të madhe për gjininë tjetër, por edhe një emancipim të vetë autorëve, që kanë dashur të sjellin, që gruan e kanë parë si subjekt të barabartë letrar, dhe jo vetëm si metaforë apo dekor, psh tek ‘Bardha e Temalit’ (1890), vetë autori i veprës, Pashko Vasa i del në krahë Bardhës; duke e çuar atë drejt fundit tragjik, i kujton shoqërisë së kalbur dhe primitive, se kodet që ajo vendos mbi gruan janë jetëmarrëse, ekzekutuese, shfarosëse. Pra, morali i një shoqërie shfrenetike konvencash bie, kur humb jeta e njeriut. Por, me kalimin e kohës, galeria e figurave femërore është pasuruar me fizionomi të tjera. Përmendim, poemën tregimtare ‘Revza’ të Muhamet Çamit, që më vonë u titullua ‘Erveheja’, apo ‘Emira’ e Santorit, Rina dhe Serafina Topia të De Radës, ‘Andrra e jetës’ e Mjedës, Tringa e Fishtës, malësorja te Migjeni, apo Ema e Kadaresë. Pra, që të mos zgjatem, këto figura, ndonëse të shpërndara në kohë dhe stil, përfaqësojnë mënyra të ndryshme të përfytyrimit të gruas shqiptare, nga simbol i virtytit dhe sakrificës, deri te shprehje e revoltës dhe individualitetit. I përmenda këta autorë për të kujtuar se,



jo vetëm autoret gra kanë ndërtuar ‘luftra të vockla’ të fituara, por edhe shkrimtarët burra, kanë ndikuar në përcaktimin e kodi etike, nëse do ta quanim kështu, mbi gruan personazh.

HEJZA: Shumë autore gra sot nuk janë më vetëm emra librash, por zëra të pranishëm në çështje që shkojnë përtej letrës, në barazi gjinore, politikë kulturore, edukim dhe debat publik. A mendoni se ka ardhur koha që shkrimtarja shqiptare të mos shihet vetëm si figurë e butë e letërsisë, por si një aktore e fuqishme në debatin publik dhe kulturor? Dhe a është letërsia e grave në gjendje të ndikojë realisht politikën e mendimit në shoqërinë shqiptare?

MAJLINDA RAMA: Padyshim që ka ardhur koha, dhe në fakt, ajo kohë ka nisur më herët, që shkrimtarja shqiptare të mos shihet më si një figurë e përkufizuar nga butësia dhe delikatesa, por si një zë i angazhuar dhe ndikues mendimin publik apo në debatin publik e kulturor. Sot, shumë autore nuk mjaftohen me krijimtarinë e tyre letrare, ato janë të pranishme në diskursin mbi barazinë gjinore, edukimin, arsimin, politikat kulturore dhe çështjet shoqërore për një komunitet më të gjerë. Kjo tregon se fjala e tyre nuk rri më vetëm në libra, por kërkon ta ndikojë realitetin, të bëhet lëvizëse dhe pse jo, dominuese e shumë praktikave shoqërore. Sa i përket pyetjes, nëse letërsia e grave mund ta ndikojë politikën e mendimit, unë gjykoj se po, mundet, sigurisht, në atë masë që çdo letërsi mund të arrijë ta trazojë vetëdijen kolektive, (sepse edhe në botë gjithnjë e më pak po e ndikon sferën publike letërsia). Ajo që unë besoj, është që, letërsia e shkruar nga gratë, sjell përvoja shpesh vetjake, që kanë qenë të fshehura, për shkaqet që i përmendëm më lart, dhe që lidhen me përjashtimin ose aneksimin nga diskursi kulturor, historik dhe letrar, jo për faj të tyre. Në këtë kontekst, kur shumica e historive janë treguar nga një këndvështrim mashkullor, ndonëse të përkrahje të gruas, siç e thamë, ato padashur janë reduktuar në stereotipa, si të dashura, besnike, nëna, të sakrifikuara, etj. E tërë kjo narrativë mund të jetë subjektive deri në çastin kur gratë nisin të flasin për veten, pra për gruan, ato arrijnë të sfidojnë narrativat dominuese dhe të krijojnë një diskurs të ri në mendimin publik, të marrin rolin e tyre në shoqëri, të bëhen ‘kryengritëse’ të sistemit patriarkal apo nënstistemeve rurale patriarkale, pra të shpalosin një formë rezistence, që do të thotë se e kanë zotëruar këtë zonë, dhe po marrin zërin e tyre në një shoqëri që, le ta pranojmë, mendon vetëm për veten.

HEJZA: Për një kohë të gjatë, letërsia e

krijuar nga gratë është konsideruar “e vogël”, “e ndjeshme”, “e brendshme”, një letërsi që rrallë i është dhënë hapësira që meriton. Sipas jush, a e ka kapërcyer autorja shqiptare këtë etiketim? Dhe çfarë e dallon zërin e një gruaje që shkruan sot nga ai i një autori mashkull, përveç gjinisë biologjike?

MAJLINDA RAMA: Mendoj se autorja shqiptare është në procesin e kapërcimit të këtij etiketimi, por nuk mund të thuhet se është zhdukur plotësisht. Ende ekziston një tendencë për të vlerësuar më shumë temat ‘e mëdha’ që trajtojnë burrat dhe ka një tendencë për ta vendosur letërsinë e grave në korniza të ngushta si letërsi emocionale, personale apo feminine. Por, ndryshimi është real dhe i pakthyeshëm, gratë sot shkruajnë bukur dhe për gjithçka; për ndjenjat, dëshirën, trupin, dhunën, pushtetin, historinë, dashurinë, mëmësinë, edhe për heshtjen dhe, e bëjnë këtë me zë të fortë, të vetëdijshëm dhe shpeshherë tronditës. Ajo që e dallon zërin e një gruaje që shkruan sot nga ai i një autori mashkull nuk është thjesht gjinia biologjike, por këndi i vështrimit, përvoja e të jetuarit, e të qenit grua, në një botë që shpesh e ka përcaktuar në mënyrë të njëanshme dhe i ka vënë ato në pozicione për të shpjeguar veten, vazhdimisht. Ky këndvështrim i grave krijuese padyshim sjell nuanca të tjera, ndjeshmëri të reja, por edhe një lloj të drejte për të folur për realitete dikur të fjetura në to. Nuk është letërsi femërore, është thjesht letërsi, që flet nga një kënd i ndryshëm, shpesh i nënvlerësuar, por thelbësor për të kuptuar më mirë veten dhe shoqërinë. Në këtë kuptim, autorja shqiptare po del nga hijet e etiketimeve gradualisht dhe po e ndërton hapësirën e vet, si zë i barabartë, i pranishëm dhe shumë i domosdoshëm në mozaikun tonë letrar dhe kulturor, në rrafshin kombëtar dhe jo vetëm.

HEJZA: Shpesh letërsia nuk është thjesht art, por edhe një mënyrë për të reflektuar apo sfiduar realitetin social, politik, moral. Mendoni se letërsia mund të jetë ende një formë e vërtetë rezistence? Dhe nëse po, për çfarë duhet të “luftojë” sot shkrimtari shqiptar?

MAJLINDA RAMA: Po, letërsia është një formë rezistence; nga çdo distancë, nga çdo perspektivë që ta shohësh, ajo është një lloj qëndrese. Historia ka treguar se shumë prej krijimeve letrare kanë luajtur një rol kyç në luftërat kundër padrejtësive, shtypjes dhe censurës. Shkrimtarët kanë pasur gjithmonë mundësinë për ta sfiduar kohën. Letërsia ka fuqinë të provokojë, të fshijë iluzionet dhe të hapë mendjet. Sot, sidomos kur realiteti shfaqet me kriza të vazhdueshme, me padrejtësi

të mëdha sociale, mungesë të vëmendjes për tema që kanë në qendër individin, shkrimtarët kanë mundësinë ta përdorin letërsinë si një armë kundër këtyre dështimeve, nëse do t’i quanim kështu, se dështime të shoqërisë janë këto, në një mënyrë. Qoftë si formë rezistence, qoftë si letërsi e angazhuar, shkrimi mund t’i sfidojë mungesat e të ndërgjegjësojë. Sot shkrimtari shqiptar mund të ‘luftojë’ për identitetin e njeriut, për thelbin e qenies humane, në një kohë kur po dominon zbjerria e vlerave dhe thatësira e madhe shpirtërore, ku s’ka më dashuri të pastër mes njerëzve, s’ka standarde të qarta apo hierarki vlerash, ku qartazi ka cenim të asaj që është e mirë, e bukur, e talentuar, e ditur, e mençur, e drejtë, pra një pabarazi që frustron posaçërisht atë që vlen, që nuk ka sesi të mos e prek syrin dhe shpirtin e krijuesit. Sfidë mbetet edhe ruajtja e historisë, gjuhës, kulturës, identitetit kombëtar, në një botë gjithnjë e më të globalizuar, ku shpesh vlerat tradicionale dhe autenticiteti janë të rrezikuara nga tendencat e homogjenizimit kulturor global. Krijuesit mund të hedhin dritë mbi një tjetër çështje që duhet eksploruar dhe kuptuar deri në fund dhe që lidhet me pasojat e periudhave të errëta të vendit, siç janë luftërat, regjimi komunist apo emigrimet masive përgjatë tranzicionit. Ky proces mund ta çlironte shoqërinë nga traumat dhe do të ndërtonte një histori të pastër, më të ndershme për kujtesën tonë të përbashkët. Në fund të fundit, të gjithë duhet të ndihmojnë në një mënyrë, për të mbajtur të gjallë atë që është më e vërtetë, më e saktë, më e drejtë dhe më e bukur, edhe në kohë të tilla të pasigurisë dhe kaosit të vazhdueshëm.

HEJZA: Jo çdo letërsi rezistuese është domosdoshmërisht protestuese në mënyrë të drejtpërdrejtë. Ndonjëherë, edhe bukuria, kujtesa, ose një fjali e vërtetë në kohë të shtrembra janë akte që sfidojnë sistemin. A është ndonjëherë vetë akti i të shkruarit një qëndresë? Dhe si mund ta ruajë shkrimtari autenticitetin dhe misionin e vet moral pa u kthyer në një “moralist”?

MAJLINDA RAMA: Siç e thashë më lart, akti i të shkruarit është edhe formë qëndrese, veçanërisht nëse fjala dhe mendimi përballen me shtypjen apo censurën, apo ‘kohë të shtrembra’ siç i quani ju. Shkrimtari, përmes bukurisë së jetës dhe singëritetit së rrëfimit, mund të ofrojë reflektime mbi realitetin, pa qenë domosdoshmërisht i drejtpërdrejtë në protestë. Për të ruajtur originalitetin, atë që është autentike, ai mund të mbajë një qëndrim të hapur ndaj natyrës njerëzore, duke shmangur moralizimin. Ndonjëherë, fuqia e letërsisë qëndron në thjeshtësinë e

fjalëve, mendimit, pa imponuar ndjenja apo rrugë konkrete. Mendoj se vetë misioni i letërsisë është që ta pasurojë shpirtin e njeriut, të ngacmojë mendimin kritik të nxisë pyetje mbi natyrën e jetës, ndarjet, bashkimet, përplasjet e ideve, qëndrimeve midis individëve, shoqërisë dhe pushtetit. Në këtë mënyrë arti i shkrimit siguron ura që të përçojë mesazhe për jetën dhe ekzistencën. Duhet ta pranojmë se ne shqiptarët nuk kemi ndërtuar raport të qenësishëm me të vërtetën, dhe për aq kjo sa kjo do të vijojë të mbetet e tillë, ne mbetemni në konfuzion si shoqëri. Prandaj, letërsia dhe jo vetëm ajo, mund të krijojnë lidhje mes njerëzve dhe kohëve të ndryshme, në këtë mënyrë ajo bën atë që quhet kujtesë e përbashkët, pa qenë nevoja ta dëshmojë me fjalë apo ta deklamojë.

HEJZA: Poezia shpesh konsiderohet si forma më e zhveshur dhe intime e të shkruarit! Në poezi autori nuk ka se ku të fshihet. A është për ju poezia një mënyrë për të rrëfyer veten, apo për të shpëtuar prej saj? Sa autobiografi ka në vargjet tua?

MAJLINDA RAMA: Poezia për mua është një mënyrë për ta rrëfyer veten deri në fund, pa barriera, pa droje, pa kufij, pa kode apo konvenca morale, pra për të shprehur ato ndjenja dhe mendime që shpesh janë të vështira për t’u shpjeguar me fjalë të zakonshme. Poezia në këto raste bëhet ‘shpëtim’, sepse bëhet mjet për të thënë ato që jeta i kufizon. Poezia është e paanë, s’pranon korniza apo norma, porse vlera artistike. Është një gjendje që shpesh edhe nuk e shpjegon dot, për të mos thënë që asnjëherë nuk e shpjegon dot. Ajo vjen edhe si formë vetë-reflektimi, edhe si pasqyrë e brendshme e shpirtit, edhe si emocion, edhe si botëkuptim, edhe si përvojë personale. Në çdo poezi sigurisht që gjendet një pjesë e vetes, por ato i tejkalojnë kufijtë e jetës personale. Ajo që kërkoj unë është që lexuesi ta shijojë estetikisht, por edhe të gjejë një pjesë të vetes së tij në ato vargje, pavarësisht nëse janë ato me nuanca personale apo universale.

HEJZA: Në shumë raste, poezia është një formë e veçantë kujtese dhe, përmes saj kujton fëmijërinë, njerëzit e dashur, kohët që nuk kthehen më. Por, ajo është edhe një mënyrë për të ruajtur gjurmët e një epoke, përtej vetes. Sa rol luan kujtesa në poezinë tuaj? A është ajo thjesht kujtim personal, apo ndonjëherë bëhet kujtesë kolektive për atë që një brez i tërë ka ndjerë, por nuk ka ditur si ta thotë?

MAJLINDA RAMA: Vetë kujtesa si proces është ruajtje dhe përcjellje dhe pa këtë

HEJZA



proces asnjëri nga ne nuk ka as të tashme, as të shkuar dhe as të ardhme. Letërsia me çdo formë komunikimi që vjen (poezia s’bën dallim) e nxit këtë qasje, për të dokumentuar grimca të secilit prej nesh, çaste, fragmente, histori të vockla, dëshira të arrira apo të pambërritura, shtypje, thyerje, ngritje, rënie, dashuri, urrejtje, viktimizim, lavdi, sjellje shoqërore, pra shumë gjëra që e përbëjnë jetën e gjallë. Pa këtë, nuk ka akt kujtese personale dhe nëse s’ka të tillë, nuk mund të ketë kujtesë kolektive të plotë, porse të pjesshme. Prandaj, gjykoj se secili ka një peshë të vetën në ndërtimin e drejtë, të qartë dhe të plotësuar të asaj që përbën kujtesën e të tërëve. Unë dhe asnjë tjetër besoj, nuk e ka si qëllim këtë, sepse arti dhe krijimi është proces individual, që rezonon më pas përtej nesh, por duke sjellë secili gjurmë të kohës së vetë, marrëdhënie, emocione, qasje me njerëz apo sisteme, detaje sociale, dëshmi ekonomike, dëshmi censure, të dhëna diskriminimi apo dashuri njerëzore që transformohen nga njëra epokë në tjetrën, ne kemi ndërtuar një panoramë të kohës sonë, pra krijimi, poezia, merr përmasat e komunikimit në një kontekst më të gjerë, bëhet një formë kujtese kolektive.

HEJZA: Thuhet që poezia nuk na lejon të gënjejmë, të paktën jo për gjatë. Është një gjuhë që e njeh vërtetësinë nga brenda. A është procesi i të shkruarit për ju një zbulesë e vetes, apo më shumë një mënyrë për t’u liruar nga pesha e saj? A ndiheni ndonjëherë “e shfletuar” nga vargu që vetë e keni shkruar?

MAJLINDA RAMA: Poezia është një proces që zbulon dhe çliron, shpesh papritur, ndonjëherë dhimbshëm, ndonjëherë me eufori, por gjithmonë me vërtetësi. Ajo nuk lejon të fshihesh pas fjalëve, është tamam si një pasqyrë, që nuk të lejon ta shmangësh shikimin. Kur shkruajmë, nuk e dimë se çfarë na vjen përballë, në fund e kuptojmë se kemi zbardhur një pjesë të unit tonë. Poezia, për mua, nuk është një strehë për t’u fshehur, por një hapësirë për të qenë në komunikim, sigurisht me brishtësinë që ajo kërkon, por edhe me singritet krijues. Është formë çlirimi, sepse ajo të detyron të thuash atë që s’mund ta thuash ndryshe, madje as me veten, por ky çlirim nuk është gjithmonë i lehtë apo vjen plotësisht i butë. Ka vargje që kur i lexon pas shkrimit duket sikur të bëjnë të ndiejesh më i zbuluar, më ti, më transparent, dhe në këtë kuptim, rizbulon veten. Ama, një gjë dihet, poezia është një proces që vjen e të rrëmben, njësoj si dashuria që përfshihesh e s’ke kohë të mendosh gjatë se si erdhi. Në fund të fundit, ndoshta është e vetmja gjuhë që nuk u bindet rregullave, tek unë ajo ndonjëherë madje edhe i shpërfill, sepse kërkon të arrijë të vërtetën gjithmonë përmes emocioneve.

HEJZA: Poezia bashkëkohore shqiptare duket si një fushë e fragmentuar, ku bashkëjetojnë zëra të shpërndarë, ndjeshmëri të kundërta dhe stile që rrallë komunikojnë mes tyre. Në mungesë të një lëvizjeje të përbashkët, çdo poet duket se ndërton vetë universin e vet estetik. A është kjo shpërbërje një shenjë lirie krijuese, apo një simptomë e mungesës së një horizonti poetik të përbashkët? A besoni se ekziston ende një poezi “shqiptare”, apo vetëm poetë shqiptarë që flasin në mënyra krejt të veçuara?

MAJLINDA RAMA: Çdo krijues, pra që do të thotë edhe poeti, është univers më vete; ai bredh këtyre universeve, ka të preferuarit e vet, modelet, sigurisht edhe të admiruarit e vet, por ai është vetvetja, nuk është as uniformitet, as shpërbërje. Krijimi, siç e thashë më lart, është akt individual, nuk mund të pranojë shabllone apo stereotipa të standardizuara. Nuk është e nevojshme të ketë lëvizje të përbashkëta. Poezia shëtit, mendimi nuk mund t’u nënshtrohet rregullave të ngurta apo të synohet t’u bashkëngjitet ideologjive, krijimi njeh vetëm lirinë dhe liria i mundëson të ndërtojë universe estetike të përveçme dhe origjinale. Secili poet e përdor poezinë si një medium të brendshëm, ku ai mund



të zhvillojë dhe të shprehë idetë e tij, apo ndjenjat, apo përvojat, që sigurisht janë të ndryshme nga ato të një poeti tjetër, apo poetëve të tjerë. Madje, edhe një ngjarje apo temë, asnjëri nuk e sheh njësoj me tjetrin. Kjo, sipas meje është një pasqyrë e lirisë krijuese individuale dhe paraqet më shumë ngjyra, tinguj, nuanca, tema, refleksë. E kuptoj qëllimin e pyetjes suaj, por nuk mund të ketë një platformë e përbashkët shprehjeje, porse larmi formash, zërash, tematikash, të cilave, një narrativë e përbashkët poetike do t’u rrinte ngushtë. Askund nuk mund të hidhet ideja e një poezie homogjene; shumëllojshmëria, hapjet, stilet, format janë ato që duhet të zënë vend prioritar, sepse edhe pa e pasur qëllim në vetvete, ato mund të ndërtojnë përmbajtje që lidhen me kontekstin shqiptar, pra elemente diskrete ose të dukshme, që e ndërtojnë një kod e që mund të etiketohet si i përbashkët i një kohe apo brezi.

HEJZA: Në një kohë ku poezia shpesh përzihet me rrëfimin, ndjeshmërinë personale apo statusin emocional të momentit, sfumohet dallimi mes një poezie të ndërtuar estetikisht dhe një ndjenje të thjeshtë të shprehur në vargje. Shumë lexues nuk e dallojnë më një poezi nga një tekst poetik. Çfarë e bën një poezi “vërtet poezi”? A është forma, tingulli, thellësia, ose diçka që nuk matet dot, një dridhje që vetëm poezia e vërtetë di ta prodhojë?

MAJLINDA RAMA: Pyetjes së çfarë është poezia, shumë mendimtarë, në kohë të ndryshme, nuk kanë mundur ta definojnë, por kanë sjellë definicione të përkohshëm, prandaj do të thosha që çështja mbetet e hapur, do të ketë gjithnjë sprova për të kuptuar se ç’është kjo dridhje shpirti që na mban zgjuar, na josh, na motivon, na bën të dashurohemi, na jep jetë, emocion, dritë të brendshme, na përsos shpirtin, mendjen, qasjen ndaj vetes dhe tjetrit, a është formë, a është përmbajtje, a është ide, a është mesazh, a tingull, a rrëfim. Unë mendoj se poezia i ka të gjitha ato që përmenda më sipër, por ka edhe harmoni të brendshme, ndërthurje të formës, ritmit, kuptimit, ka eufoni, është emfatike, ka lirizëm, ka dramë, është shprehja më lartë dhe më e thellë emocionale. Poezia është melodi e shpirtit të krijuesit që ndërton fije të padukshme me shpirtin e

lexuesit, sepse botët e brendshme tonat komunikojnë më mirë se fjalët që ne themi me njëri tjetrin. Sikurse thotë Ezra Pound, ‘nëse muzika nis të atrofizohet kur largohet nga vallet, poezia atrofizohet kur largohet nga muzika’, por poezia është dhe dehje, nëse nuk na deh mbetemi ‘skllëvër martirë të kohës’, sipas Bodler-it.

HEJZA: Ka poetë që e shohin poezinë si një art të pastër, që nuk duhet të ngatërrohet me misione shoqërore apo angazhime të jashtme; të tjerë e përfetojnë atë si një akt etik, madje si detyrim moral ndaj kohës. Ku e vendosni ju poezinë në këtë spektrin mes bukurisë estetike dhe përgjegjësisë ndaj së vërtetës? A mund të jetë një poezi formalisht e bukur, por moralisht e zbrazët? Dhe a është e ndershme një poezi që ka qëllim vetëm bukurinë?

MAJLINDA RAMA: Nuk ka poezi të ndershme, as të kundërt me këtë; ajo mund të frymëzohet nga bukuria, si estetikë dhe si etikë dhe, në bërthamën e vet të jetë nxitur nga bukuria shpirtërore, të themi edhe nga dashuria, që është kuptimi i ekzistencës njerëzore. Poezia është udhëtim që mund të na çojë në hapësira të pazbuluara, por shpesh edhe në lartësitë e epërme të bukurisë, pa e humbur pasionin që vetë poezia ka si art krijimi. Madje, mbase mund të jetë një fushë, ku bukuria dhe përgjegjësia ndaj së vërtetës mund të përplasen, si dy forca që tërhiqen dhe shtyhen me njëra tjetrën, por sidoqoftë ky tension nuk e dëmton, përkundrazi mund ta bëjë që ajo të gjallojë, por nga ana tjetër të jesh i vërtetë, nuk ka lidhje me përgjegjësinë, por me shprehjen më të lartë të vetes (se kjo që përmendni ju ‘përgjegjësia ndaj së vërtetës’ është koncept që s’ka lidhje me poezinë). Ndërsa për përcaktimin tuaj ‘poezi e zbrazët’ sërish do thosha, nuk mund të ketë të tillë, sepse ajo (poezia), ose është, ose nuk është poezi. Poetët e mirë, nuk lënë vend për ekuivok në poezi. Ata mund të eksplorojnë vetveten me forma dhe stile të ndryshme, herë njërën, herë tjetrën, por gjithmonë, me një poezi që është në kërkim ose shpalosje të së bukurës, si akt shpërthimi i pastër, pa u përbaltur me elemente përreth dhe anash që mund ta bëjnë të zbrazët... Edhe një mesazh, apo qoftë edhe një varg i bukur, duhet mbajtur në konsideratë.

HEJZA: Gjithnjë e më shumë, poezia bashkëkohore përballet me një paradoks: për t’u dëgjuar, shpesh duhet të thjeshtohet deri në sipërfaqësi; por për të qenë e vërtetë, duhet të kërkojë thellësi që pak lexues janë gati t’i ndjekin. Si e shihni këtë tension mes qasjes elitare dhe asaj popullore në poezinë e sotme? A duhet poeti të shkruajë për të gjithë, apo për ata pak që janë të gatshëm ta ndjekin në labirintet e ndjeshmërisë dhe ideve?

MAJLINDA RAMA: Ngasjet e frymëzimit poetik nuk nisen nga paragjykimet, nga përzgjedhja eventuale e lexuesit, as nga niveli i tij për ta kuptuar dhe dekoduar poezinë; udhët e komunikimit vijnë vetvetiu, natyrshëm ose nuk vijnë fare. Pra nuk krijohet duke pasur parasysh lexuesin. Pas kësaj faze, kur ka dalë krijimi në publik, pastaj mund ta diskutojmë nëse poezia për lexuesin elitar është ajo formë arti që kërkon angazhim intelektual apo emocional, apo le të themi e vë lexuesin përballë sfidash të përballimit të ideve komplekse, diskrete, apo simbolikave që jo gjithmonë janë të lehta për një pjesë. Kjo edhe mund ta vështirësojë komunikimin me masën dhe të rrezikojë të ndërtojë poezi për një grup shumë të vogël lexuesish, por ky nuk është problem i krijuesit. Secili lexues gjen dhe lexon aq sa mund të përballojë. Ka lexues që mund ta duan poezinë e koduar, ka të tjerë që duan poezinë e hapur, deklamative. Kjo lidhet me lexuesin, jo krijuesin.

HEJZA: Thuhet shpesh se “çdo përkthim është një tradhti”, por është edhe një mundësi për rilindje. Një vepër e përkthyer nuk është më krejt ajo që ishte, por as nuk është më thjesht tekst; ajo bëhet udhëtim ndërkulturor. Si e përjetoni ju aktin e përkthimit? E ndjeni si një humbje të thellësisë origjinale të veprës suaj, apo si një rilindje që i jep tekstit jetë të dytë në një botë tjetër? A është përkthimi një dorë e zgjatur apo një pasqyrë që shtrembëron?

MAJLINDA RAMA: Përkthimi është kompleks, lëviz mes ekstremeve, mund të jetë një humbje/zbehje e origjinalit, por gjithashtu mund të jetë rilindje e veprës në një kontekst të ri. Si një lloj udhëtimi ndërkulturor, përkthimi nënkupton që tërësia e fjalëve dhe ndjesive, të shkojnë në një gjuhë të re pa cenuar burimin, nuancën, thelbin e veprës, se, nëse ndodh kjo vepra është rrëzuar. Ka pasur raste që përkthyesi e ka bërë veprën më të madhe se origjinali, i ka dhënë ajër, hapësirë, ide, e ka ngritur në një stad të ri. Rreziku të bëhet edhe dorë e zgjatur, që i ofron veprës një lidhje mes identiteteve kulturore dhe ‘pasqyrë që shtrembëron’ është pranë e pranë... Përkthimi kërkon njohje të mira në disa rrafshe, sidomos të gjuhës së origjinës; duke përkthyer jo thjesht fjalët, por edhe ndjeshmërinë, stilin dhe shpirtin e tekstit...

HEJZA: Shpesh ndodhë që autorët nga vendet e vogla, posa të përkthehen vlerësohen si përfaqësues të një “zëri të pazakontë”, të një “realitet të largët”, të një “ekzotike kulturore”. Kjo i vë autorët e përkthyer, pra edhe atë shqiptar, përballë një tensioni: të jetë vetvetja apo ajo që pritet prej tij? Në përballjen tuaj me lexuesin e huaj, a e ndjeni ndonjëherë presionin për të përfaqësuar më shumë kombin sesa veten? A ju kërkohet të jeni “shqiptare” para se të jeni thjesht “shkrimtare”?

MAJLINDA RAMA: Krijimtaria është procesuniversal dheçdoautor, pavarësisht prejardhjes, sjell elemente të përvojës dhe botëkuptimit të vet personal, sigurisht në kontekstin e vendit të origjinës. Vetë krijimi është edhe botëkuptim, dhe elementi kombëtar vjen në qindra mijëra grimca, pa u papërcaktuar si synim i ndërgjegjshëm, se duhet të bëhet medoemos për një lexues tjetër. Krijuesi i lindur dhe edukuar në Shqipëri, ndërton receptorë, që lidhen posaçërisht me vendin ku është formuar, se, vendi, kombi bëhet vetëdije. Kryeveprat botërore, jo domosodoshmërisht e kanë pasur plan të parë dëshminë e identitetit kombëtar, por ai del nëpërmjet përshkrimit të vendit, njeriut, traditës, filozofisë dhe lexuesit e

HEJZA

lindur nga dhimbja personale ose kolektive. Por, kur dhimbja kthehet në art, ajo nuk është më thjesht plagë, por një mjet për të kuptuar dhe ndriçuar. Për ju, a është krijimtaria një formë e përpunimit të brendshëm emocional? Dhe kur lexoni një vepër të fuqishme, a kërkonì të ndiheni më mirë, apo të preknì fundet e oqeaneve të shpirtit?

MAJLINDA RAMA: Për mua, krijimtaria është një mundësi për t’i dhënë kuptim dhimbjes, por jo vetëm. Ka plot raste kur dhimbjet e mëdha janë shndërruar në art, madje edhe në humor, ironi apo vetëironi. Kjo është një mënyrë tepër njerëzore për të tentuar apo për të përballuar atë që mund të duket e papërballueshme. Si ndihem kur lexoj një vepër? Kur lexoj një vepër dua që ajo të më ndjekë edhe pasi ta kem mbyllur, dua që kur ta mbaroj librin të mos më zërë gjumi, të rikthej skenat, ngjarjet, dialogët, të përfshihem në aksion. P.sh. kur lexon Shtëpi kukulle të Ibsen apo Xha Gorion e Balzakut, ti nuk mund të flesh, por nuk mund të të zërë gjumi as kur lexon Metamorfozën e Kafkës, apo Thërrmijat elementare të Houellebecq, apo Vagjet satanike të Ruzhdisë, pra vepra letrare i ka të gjitha gjasat të të ndriçojë, të të shkundë, të të jap tjetër prani, prani që as e kishe menduar kurrë se mund të të ndodhte. Kjo është magjia e letërsisë, ndryshe nuk do kishte art të shkruar. Epi i Gilgameshit p.sh. le të ketë mijëra vjet krijim, ai lexohet me të njëjtën drithërimë në çdo kohë, apo ec e gjej një personazh si Amaranta Buendia e Markezit që ta mban zemrën peshë.

HEJZA: Le të supozojmë se ekziston një letërsi që qetëson, dhe një tjetër që shqetëson. Njëra e mban lexuesin brenda kufijve të njohur; tjetra e shtyn përtej tyre. Të dyja kanë vlerën e tyre, por janë qëllime krejt të ndryshme estetike. Në vetëdijen tuaj si shkrimtare, me cilën prej këtyre prirjeve identifikoheni më shumë: me letërsinë që qetëson, apo me atë që rrezikon? A mendoni se arti ka sot më shumë nevojë të jetë i bukur, apo i vërtetë, edhe kur dhemb?

MAJLINDA RAMA: Sikurse e thashë më sipër, unë i përkas letërsisë që rrezikon, sepse besoj se arti i vërtetë është ai që sfidon dhe zgjon ndërgjegjen. Qetësia në letërsi është e nevojshme, por shpesh ajo na mbulon me iluzione, të cilat si në jetë, na pengojnë të shohim përtej. Më shumë se bukuria sipërfaqësore, kërkoj të tregoj të vërtetat, edhe kur ato dhembin. Arti ka nevojë për guxim dhe të tregojë realitetin pa filtra, pa stisje, pa variant alternativ komoditeti, i cili mund të mos ekzistojë. Mendoj se ky është një dialog më i hapur dhe më i singurtë.

HEJZA: Në fund të çdo libri, mbetet një heshtje. Ndoshta më e ngarkuar se fjalët vetë. Ju, personalisht, çfarë doni të mbetet te lexuesi pas leximit të veprës suaj? Një ide, një ndjesi, një dridhje e papërcaktuar? Dhe nëse letërsia është një mënyrë për të komunikuar me heshtjen që vjen pas saj, çfarë shprese ose çështje do të dëshironit të linte ajo në atë heshtje?

MAJLINDA RAMA: Pas leximit të veprës sime, dua që lexuesi të mbajë me vete atë dridhjen e hollë që përmendëm më parë, një ndjesi që ta trazojë, pa e qetësuar menjëherë. Unë nuk synoj t’i jap përgjigje, por të hap dyer për pyetje të tjera, për mbyllje alternative, për mbyllje ndonjëherë edhe si proces katarsisi, siç thoshte Aristoteli. Shpresa ime është që kjo fazë heshtjeje të kthehet, po ashtu në një hapësirë, ku lexuesi të ndiejë guximin që të përballet me vetveten dhe botën. Pra, si një heshtje që sjellë një fillim të ri, jo një mbyllje...

për të dëgjuar më qartë veten? Qendrat vendimmarrëse sikur nuk i përfillin fort “provincialistët”!

Shiko, duhet kuptuar që letërsia nuk është hierarki e përcaktuar nga vendndodhja, nuk ka qenë asnjëherë. Siç e preka më lart, qendrat e mëdha kulturore janë shpesh thjesht produkte të krijuara nga interesa të caktuara. Qytetet e vogla me gjithë kufizimet e veta, kanë fuqinë të lindin zëra të pastër, origjinalë dhe thellësisht të vërtetë, ndryshe nga zhurma e sipërfaqes që shpesh dominon në qendra. E vërteta e letërsisë është procesi krijues, që nuk varet nga sa shumë ‘njerëz të duan’ ose sa shpesh të përmendin, por nga sa e singertë dhe e thellë është lënda. Qendra Letrare shpesh krijon iluzione rreth asaj që konsiderohet ‘letërsi e vërtetë’, dhe ne e dimë se këtu jetojmë, nxiten imazhe të sajuaara si të ‘modës’, ndërsa ‘provinca’ ka mundësinë të na tregojë më shumë se çfarë ka vërtet vlerë, se nuk vrapon, s’e nxiton gjë. Letërsia është fuqi e shprehjes dhe ka lidhje me shpirtin, jo me fishekëzjarret festive.

HEJZA: Njerëzit kërkojnë në letërsi ose ngushëllim, ose ndriçim. Shpesh të dyja në të njëjtën kohë. Për ju personalisht, është arti një strehë shpirtërore, apo një mënyrë për të “shkundur” botën? Dhe çfarë kërkonì nga një vepër kur jeni duke e lexuar?

MAJLINDA RAMA: Dikur mendoja se arti duhej të ‘shkundte’ botën, sot mendoj se arti mund të jetë një mënyrë për të ‘shkundur’ genien, pra që ta bëjë të vihet në lëvizje, si mikrokozmos që të pranojë të shohë realitete alternative, këndvështrime dhe perceptime të ndryshme të një makrokozmosi. Sigurisht, ai mund të bëhet edhe strehë shpirtërore, por kjo më shumë mund të jetë një perceptim, ose ndjesi që lidhet me euforinë, çlirimin dhe fuqinë e shpalosjes së brendshme, të asaj që na bën të ndiejmë se nuk jemi vetëm, pra na lidh me hapësira të tjera, dhe njerëz të tjerë, qofshin të ngjashmit tanë, ose jo. Kur lexoj, kërkoj një vepër që të më sfidojë, të më bëjë të mendoj ndryshe, të japë impulse, hapësira të reja dhe të më ndihmojë të kuptoj gjëra të tjera që vijnë nga një perspektivë tjetër. Ndonjëherë letërsia që lexojmë nuk na vjen thjesht lexim si shije artistike dhe estetike, por edhe si një përvojë që shtron pyetje para nesh, që na detyron të ballafaqohemi me tërë kompleksitetin dhe divergjencat e jetës.

HEJZA: Një pjesë e lexuesve i afrohen letërsisë për t’u arratisur nga realiteti. Por, ka edhe autorë që shkruajnë pikërisht për t’i përballur me të, pa filtra, pa iluzione. Si e ndjeni marrëdhënien tuaj me lexuesin? A përpiqeni t’i ofroni prehje, apo më shumë një pasqyrë të pakëndshme, por të nevojshme? Dhe çfarë përgjegjësie ndjeni kur e dini se një lexues mund të hyjë në botën tuaj për t’u qetësuar, por del i tronditur?

MAJLINDA RAMA: Unë nuk shkruaj për të ofruar arratisje, apo për të krijuar iluzione, por për t’u dhënë zë ndjenjave, vuajtjeve dhe realiteteve që unë njoh, jam si në jetë, ballafaqohem me të vërtetën, kjo më ka bërë të jem unë. Mendoj se, kur je i vërtet në shkrim, kjo ndodh sepse edhe botën ashtu e sheh, siç është, pa zbukurime, kjo më jep të drejtën të mos improvizoj, pra thjesht vetja dhe gjërat lehtësohen. P.sh. në dy romanet e mi ‘Perandorët’ dhe ‘Zonja me të kuqe’, disa lexues më kanë thënë se kanë mbetur të lënduar nga fundi i tyre, prisnin një fund të lumtur, ndërkohë nuk ndodhi, por ky nuk ishte qëllim, për t’i lënduar, por për t’i zgjuar, për të parë më hapur dhe pa lajle lule realitetin që unë njihja. Unë besoj se ndonjëherë edhe pasqyrimet e tilla janë të nevojshme për të parë veten se ku jemi. Do thoni ju, po a ia ke arritur... kjo është relative. E vërteta e krijimit mbetet gjithmonë, ndërsa stili, forma e të tjera si këto, sigurisht mund të rishihen herë pas here, sepse unë vetë jam kritike shumë e rreptë e vetes.

HEJZA: Shumë vepra të mëdha kanë

dhe mund të prekë universalen. Në këtë formë i jep rëndësi edhe vendit të tij, duke e tejkaluar atë në nivelin e përjetimit dhe shprehjes artistike dhe duke e mbajtur gjithmonë në zemër e në mendje, sepse, siç e thotë Kavafi, vendlindja nuk harrohet, ti e lë pas, ajo përherë të del përpara, se është pjesë jotja, siç është gjaku.

HEJZA: Qendrat kulturore shpesh prodhojnë modele, stile, diskurse të përsëritura. Ndërsa periferia, me mospërputhjet dhe thyerjet e saj, mund të sjellë zëra më të pastër, më të lirë nga presioni i përkatësisë. Ju një kohë të gjatë keni jetuar dhe vepruar në “periferi” (në Fier). A mund të themi se periferia ka potencialin për të qenë më autentike, më e çiltër në shkrim? A jeni ndjerë më e lirë pikërisht se keni shkruar jashtë “skenës së zhurmshme” letrare të qendrës?

MAJLINDA RAMA: Po, ka diçka të përveçme në shkrimin që vjen nga ‘periferia’, meqë ju e quani të tillë, por qytetet si Fieri, Shkodra, Korça, Gjirokastra e shumë të tjera, nuk hyjnë te periferitë, ato janë qytete gjeografikisht më të vogla, por jo në cilësinë dhe kapacitetet krijuese e intelektuale. Sidoqoftë, mendoj se kur je larg qendrës së madhe kulturore dhe letrare, je më larg zullumit, je më i lirë të shprehësh mendimet dhe ndjeshmëritë pa u shqetësuar për pritshmëritë dhe normat e krijuara nga modelet që imponojnë këto qendra, që në fakt është një qendër dhe është Tirana me emër tirani, siç thoshte Kadareja. Unë kam mirënjohje për Fierin, se aty takova njerëz të ditur, të fisëm, të dashur, të talentuar, si Kristaq Shtëmbarin, Mësuesin e Popullit, shkrimtarin dhe mikun tim të dashur Maku Ponen, Tashko Lakon, Leonidha Priftin, Fred Jorgaqin, vëllain e mikut tim të çmuar, studiuesit Nasho Jorgaqi, të rinj të brezit tim që shkëlqejnë në talent etj, por ajo që duhet theksuar është se Fieri dhe qytetet e tjera si Fieri, ndërtojnë profesionistë, në të gjitha fushat, ama në thelb ruajnë njeriun, Tirana, në shumë raste e ka humbur njeriun (jo të gjithë). Në këtë kuptim, Fieri më ndihmoi të zbuloja shumë gjëra: e para nuk e kishte hipokrizinë e Qendrës së Madhe, se hipokrizia i fundosë njerëzit dhe i bënë me maska, i kthen në intrigantë, kudo që shfaqet kjo veçse dëmton dhe deformon; së dyti, Fieri më ndihmoi të krijoja duke e parë nga jashtë dhe me sy të ftohtë këtë kasaphanën e madhe të Qendrës së Madhe, që sajon çdo ditë elita, (se elitat e vërteta janë tërhequr brenda zguarit të tyre), sjellë letërsi mediatike, bujë të mëdha, sensacione pa fund, larje e lyerje, furça, ditirambe të panevojshme, himne dhe kore kolektive të dyshimta; të tëra këto nuk janë në qytetet më të vogla. Qytetet e vogla janë më të singerta, më të dashura, kanë në to njerëz, jo qenie robotike të shfrenuara për lavdi, pushtete të dhunshme të imponimit të vetes. Kjo, nuk ka lidhje me qytetet më të vogla. Njerëzit atje, nëpër qytete, punojnë me seriozitet të madh, kanë talent, por nuk bërtasin, kanë vepra të mira, por nuk u zënë dyert gazetarëve të kulturës për t’ua mbushur mendjen se sa vlejnë... Qendra e Madhe ka një qasje joproporcionale mes asaj që vjen nga provinca siç e quani ju, qytetet më të vogla siç e quaj unë, dhe asaj që synohet të arrihet në ‘majat e majave’ të Qendrës së Madhe. Në Fier, apo qytet tjetër, nuk detyrohesh të vësh maskë, të humbësh çdo ditë nga pak veten, t’i bësh ballë luftës së frustrimit, klanit, qokës, tarafit të zhurmës. Prandaj krijuesi, që të mos e personalizojë, është më i lirë kur nuk është në zemër të kraterit që zien dhe ha të vetët, si koha e Azem Shkrelit. Kur je në liri të tillë, shkruan për qejfin tënd, për llogarinë tënde dhe për lexuesin që të do dhe të gjen kudo që të futesh.

HEJZA: Fundja, letërsia e vërtetë kërkon përqendrim të brendshëm, jo domosdoshmërisht akses në rrjete të mëdha. Nga qetësia e provincës mund të lindin zëra me jehonë më të gjatë se zhurmat e kryeqytetit. A mendoni se provinca, me gjithë kufizimet e saj, ofron një lloj izolimi krijues që ndihmon në thellim? Dhe a është vetmia e saj një mallkim për autorin apo një mundësi

lexojnë njëjtë si ndjesi kudo ku ata janë, në çdo cep të globit; fjala vjen, tek Ana Karenina, apo Procesi, apo Gjenerali..., apo Pallati..., apo Krim dhe ndëshkim, ne zbulojmë praktikisht, përveç fabulës, edhe detaje, ide, fizionomi të vendeve prej nga vijnë veprat. Mendoj se, në këtë kontekst, pa e kthyer artin e krijimit në presion për të mbajtur një identitet kolektiv, krijuesit japin nga shpirti i atdheut në disa forma, që nuk ka gjasa t’i ngatërrosh, sepse kultura dhe historia që e mban secili autor me vete, ndikojnë në mënyrën si shkruan, si e shpreh botën që e rrethon, dhe si lidhet me emocionet dhe idetë që kalojnë përmes shkrimit. Fuqia e artit kjo është, përmes individit mbërrihet në perceptimin e vendeve dhe lidhjen mes kulturave të ndryshme.

HEJZA: Ka ndjenja, ritme, ngjyra të gjuhës që ndoshta nuk përkthehen kurrë me të njëjtën dridhje. E megjithatë, përkthimi synon të bëjë pikërisht këtë: të përkthejë edhe heshtjet, edhe nënkuptimet, edhe frymëmarrjen e fjalës. Sipas jush, çfarë është ajo që gjithmonë humbet në përkthim? Dhe çfarë është ajo që, çuditërisht, fitohet vetëm përmes tij? A mundet një përkthim i mirë të të bëjë ta kuptosh më thellë edhe vetë tekstin tënd?

MAJLINDA RAMA: Përkthimi, siç e thashë më lart, është proces kompleks, që edhe mund të humbasë ‘dridhjen’ e gjuhës së origjinës, ndjeshmëritë e vogla të ritmit dhe tingujve apo heshtjet që mbartin kuptime të thella, megjithatë, përkthimi aq sa mund të të humbë, aq edhe ofron mundësinë për të zbuluar dimensione të reja të veprës dhe për t’i dhënë asaj mundësinë të arrijë një audiencë tjetër. Kur kalon nga një gjuhë në tjetrën, vepra mund edhe të pasurohet përmes shprehjeve të reja. Një përkthim i mirë mund të na ndihmojë të kuptojmë ndonjëherë edhe më mirë veprën tonë, duke na e nxjerrë atë në një dritë të re. Kjo ndodh vetëm kur përkthyesi profesionist, i besueshëm dhe i përkushtuar, siç bëri Jusuf Vrioni me Gjeneralin e Kadaresë, apo Aleksandër Zotoja me poezinë shqipe që i dha horizonte të reja, apo dhe shumë përkthyes të tjerë të përkushtuar. Meqë jemi te përkthimi dua të përmend një vepër të Umberto Ecos, ‘Rrëfimet e një romancieri’, sjellë në shqip nga Zija Vukaj, të cilën po e lexoj me nge’ dhe po më lë një shije shumë të mirë, një përkthyes me kulturë të gjerë, që e zgjedhë fjalën, ka aftësinë ta kuptojë dhe ta ndiejë thelbin e tekstit, ta paraqesë atë edhe me disiplinë pedante, por edhe me qasje kreative, pa ia humbur autenticitetin. Por, ka edhe një gjë tjetër që dua ta përmend; jo të gjitha veprat janë gjithmonë të lehta për t’u vënë në ‘gojën’ e një gjuhe tjetër, psh. Lasgushi është vështirë të përkthehet në gjuhë të tjera, apo proza bie fjala, që është e mrekullueshme e Mitrush Kutelit, ajo po të përkthehet, do të humbte shumë, se është thjeshtë e pamundur të përcillet emocioni, ironia, nënteksti. Dendësia emocionale dhe refleksive është e vështirë të përkapet në këto nivele.


HEJZA: Në histori të letërsisë, disa nga zërat më të thellë kanë ardhur nga periferi të panjohura, larg qendrave të mëdha. Ndoshta sepse krijimtaria lidhet më shumë me ndjeshmërinë se me vendndodhjen. Sipas jush, është vendi që formëson shkrimtarin, apo është shkrimtari që e tejkalon vendin ku ndodhet?

MAJLINDA RAMA: Në një farë mënyre, edhe vendi ndikon tek shkrimtari si formim i parë, sepse përvojat dhe perceptimet e tij kur rritet në periferi, janë më të larmishme, më të prekshme, ato janë tamam jeta e gjallë, por, mendoj se nuk është vendi që e përcakton plotësisht krijimtarinë. Sepse, sikurse nga provincat, kanë dalë gjeni të mëdhenj, ashtu kanë mbetur edhe shumë të tjerë lokalë, kur kreativiteti i tyre nuk i kalon kufijtë e lokalitetit të tyre. Kur kjo gjendje e ‘izolimit’ fizik për shkak të periferisë kombinohet me një ajër që lidhet me dijen, shijet, hapësirat e mendimit, kërkimit të perspektivave të mëdha, të pasura, të thella, atëherë krijuesi balancon vetveten

Qasje

FIGURA-PERSONAZH MIDIS ILUZIONIT DHE REALES NË VEPRAT E PETRO MARKOS

Të gjitha figurat-personazhe të krijuara nga Petro Marko janë individuale për secilin prej nesh, sepse janë rezultat i aktit iluzor individual; ne e veshim secilën figurë me dimensionin e jetës sonë shpirtërore



Dr. Antela VOULIS

Si lexues të Petro Markos, na duhet të pranojmë se trillimi artistik i personazheve të tij është një kombinim i së vërtetës dhe imagjinatës të saj. Madje, në brendësi të figurës që krijon ky shkrimtar projektohet menjëherë edhe trillimi. Ne ndjekim lëvizjet e sistemit të personazheve, duke hyrë në iluzionin e një bote reale. Sipas teorisë së Platonit, është reale çdo gjë që ofron rezistencë dhe kontakt, pra ajo që u ofron rezistencë dhe mbështetje përpjekjeve tona, ajo që mund ta kapim me organet e shqisave. Si lexues, edhe ne biem pre të iluzionit që na imponon autori. Kështu, sipas cilit kriter do të mund të përcaktonim se katër Gjикët (“Një emër në katër rrugë”), Sonja (“Një natë dhe dy agime”), Ana-Maria Monti (“Qyteti i fundit”), Anita (“Hasta la vista”) etj. janë figura reale? A vepron ky ligj në prozën e Markos? Në procesin e ndërtimit të figurës nga Petro Marko vepron imazhi poetik, i cili realizon jo vetëm plotësimin, ndërtimin e figurës, por imponon edhe një impresion të fuqishëm tek ne, lexuesi. Ç’pikturë do mund ta kënaqte përfytyrimin tonë për figurën e Ana-Maria Montit, e bukur dhe e largët në dhimbjen e saj? A mund të kënaqte imazhi përfytyrimin tonë për Lekën, të portretizuar nga Ana-Maria, që ne e përjetojmë në përmasa të veçanta vetëm në faqet e romanit?

“~ Nuk do ka për të ardhur, jo. Nuk vjen. Ç’më do ai mua? Ai e dëgjoji historinë e jetës sime. Ca më shumë shtoi edhe ai katil që deshi të më merrte shpirtin. Pse të vijë? Të flejë me mua? Ai s’është nga ata! Të më premtojë? Ai nuk premton! Të më pushtojë, se është nata e fundit? Të më mbajë? Jam a s’jam në vete? Ai është oficer... Ai ka rrugën e tij. Ç’më do ai mua? Të tallen shokët e tij me të? Pse t’i bëhem ferrë! Ai është kaq i mirë! Më dha dritë jete... Më bëri të kuptoj se në këtë botë paska edhe njerëz të vërtetë! Po ku janë

këta njerëz të vërtetë? Vetëm një, vetëm Leka... Leka. Sa ia di për nder! Ndaj nuk vjen... Nuk do që unë të vuaj më... Nuk vjen, se ai s’di të tallet... Nuk vjen... Nuk vjen...” (“Qyteti i fundit”, f. 339)

Po t’i referohemi teorisë së përfytyrimit do të kuptojmë se të gjitha këto figura përfaqësojnë tërësi, që është diçka më tepër nga shumata e çdo tipari që do përpiqeshim të gjenim në to. Në të vërtetë, ne rindërtojmë personazhin, që do të thotë se brenda një sistemi mjeteshe e detajesh, që i japin atij jetë, ne bëhemi të ndjeshëm ndaj disa ngacmimeve të veçanta dhe shpërfillim të tjera. Në këtë proces, imazhi fizik i personazhit përfytyrohet ndryshe tek lexues të ndryshëm. Në sistemin e figurave-personazhe, të krijuara nga Petro Marko, e bukura qëndron në faktin se ato na bëjnë të ndiejmë diçka brenda vetes, të shohim atë që nuk ekziston realisht. Ato bëhen krejtësisht të besueshme edhe atëherë kur, pas leximit, ne kujtohemi se ato nuk i përkasin realitetit. Në mjeshtërinë metaforike, këto personazhe realizojnë realitetin brenda kufijve të veprës. Sikurse në të gjithë letërsinë, edhe në veprën e Petro Markos realizohet njëkohësisht rrëfimi i së vërtetës dhe ai i mashtrimi logjik, që paraprijnë formësimin e figurës. Kjo është arsyeja që, ndonëse kuptojmë dallimin midis këtyre dy aspekteve, ne jetojmë me iluzionin e së vërtetës, ndjekim me emocion personazhe të tilla si, Bedrija apo Ipaemri (“Qyteti i fundit”), doktori (“Një natë dhe dy agime”), profesori (“Hasta la vista”) etj., si figura shumë më të sofistikuara se një trillim i thjeshtë dhe, nëse përjetojmë efektin emocional të tyre, kjo ndodh sepse ne reagojmë ndaj tyre si iluzione të reales.

Figura si vizion

Nëse figurat vijnë në vizionin e lexuesit, kjo ndodh sepse në radhë të parë është vështrimi i autorit që i bën ato të

formësohen në sytë e imagjinatës sonë. Vizualiteti që fitojnë figurat nuk ka të bëjë me bollëkun e detajeve të përshkrimit të jashtëm e të brendshëm të tyre, por me peshën që merr fjala në realizimin e abstragimit, në gjallërimin e fantazisë, në gjetjen e formës konkrete emocionale të figurës. Kalimi nga hapësira e trillimit të shkrimtarit tek ajo e receptimit nga ana jonë bëhet përmes pranisë së iluzionit. Në imazhet artistike të Petro Markos, në vend të reales shfaqet imagjinaria, si realizim i dëshirës sonë për t’i konfiguruar qeniet. Nëse arrijmë t’i shohim këto personazhe, kjo është e mundur vetëm në sajë të artit rrëfimtar të shkrimtarit.

Në vizionin tonë nuk kemi thjesht regjistrimin dhe bashkimin e tipareve, detajeve që përshkruan autori, por ne zgjedhim tipare, momente dhe detaje, të cilat edhe pse mund të duken të vogla apo të rastësishme, ato janë të ndërlikuara dhe janë mjete të fuqishme të ndërtimit të vizionit tonë. E tillë është, për shembull, pamja e Ana-Marias, e cila, e krahasuar me bukurinë e nuseve të detit, shfaqet para syve tanë si një femër me bukuri të rrallë, sa personazhi që e përshkruan, Leka, i mahnitur, nuk arrin ta besojë nëse ka parë apo jo një krijesë aq të bukur. Të gjitha figurat-personazhe të krijuara nga Petro Marko janë individuale për secilin prej nesh, sepse janë rezultat i aktit iluzor individual; ne e veshim secilën figurë me dimensionin e jetës sonë shpirtërore. Kështu, secili personazh mbart një liri dhe vetëzhvillim të pandërprerë, të lidhur gjithmonë me aktin tonë iluzor.

Figura përmes imagjinatës sonë

Laboratori krijues i Petro Markos është i tillë që, sado të pangjashme dhe të çuditshme të jenë veprimet e personazheve, sado fantastik të jetë rrëfimi, ata janë paraqitur me elementë të tillë që na ndihmojnë për të gdhendur imazhin e tyre, madje edhe kur, në

thellësi, nuk i besojmë atij realiteti. Por imagjinata artistike që ngacmon vepra e këtij autori, u jep formë dhe madhësi edhe personazheve që nuk kanë qenë kurrë realë. Ajo pushton gjykimin tonë edhe atëherë kur rrëqethemi nga një situatë e personazhit, vuajmë së brendshmi kur ata vuajnë (vuajmë kur vuan Ana-Maria), ose frikësohemi nga ndonjëri prej tyre (frikësohemi nga dinaku Karlo, “Qyteti i fundit”). Kjo ndodh sepse figurat e Petro Markos, përmes procesit të imagjinimit të tyre, lidhin mendimet tona me një realitet të caktuar edhe atëherë kur duket se ky realitet mungon. Në këtë mënyrë, Petro Marko na krijon mundësinë që brenda nesh të ndërtohet imagjinaria, pra që ne të përfytyrojmë një skenë surreale, ndonëse nuk e shmangim qartësinë që ofron vepra lidhur me realitetin shqiptar (dialogu i Ana-Maria Montit me gaforren apo me detin).

Ngacmimi që na vjen nga personazhet në momente të caktuara, na bën që të parapëlqejmë që të jetojmë një botë joreale. Në momente të tilla është imazhi i figurës që na lehtëson vështrimin e asaj që realisht nuk ekziston. Kështu, mund të themi se procesi i përjetimit të figurave të Petro Markos i nënshtrohet një trillimi të dyfishtë: trillimit të autorit dhe trillimit të lexuesit. Edhe kur, në disa raste, autori ynë krijon edhe figura të paemërtuara, të paidentifikuara, edhe si të tilla, këto figura arrijnë të përfytyrohen në imagjinatën e lexuesit.

Gjatë procesit të ndërtimit të figurës, Petro Marko synon të krijojë një identitet personazhi, por, ndërkaq, edhe imagjinata jonë bëhet krijuese dhe vendos një marrëdhënie me imagjinatën e vetë autorit. Loja midis imagjinatës sonë dhe intuitës e vetëdijes krijuese të autorit është thelbi i dashurisë apo urrejtjes që ne provojmë për personazhet e korpusit të tij letrar. Nëse një krijim jeton kryesisht në ndjeshmërinë emocionale të lexuesit, romani “Qyteti

i fundit” jeton me vizione të qarta, me figura-personazhe që shihen, që kanë një fizionomi gati të dukshme, mënyrë të menduari e të vepruari të perceptueshme. Për këtë arsye, ndikimi i një romani në vetëdijen dhe subkoshiençën e lexuesit është i një karakteri krejt të veçantë, më i drejtpërdrejtë dhe më i thellë. Ngaqë është një krijim origjinal, i trilluar nga autori, figura ajo realizon dukshëm kalimin nga realiteti në trillim, nga objektivitet në subjektivitet, sepse figura në vetvete është shumëplanëshe, prandaj edhe ka disa mundësi ndikuese.

Romani përmban vetëm fjalë, por pikërisht në raportet që krijohen midis tyre, ne arrijmë që t’i shohim figurat. Në procesin krijues, shkrimtarin ndihmojnë disa mjete artistike, për t’i dhënë pamje figurës-personazh. Në këtë proces ndërthurjesh episodesh, skenash e personazhesh, autori ndërton një strukturë të plotë artistike, ku formësohen qindra personazhe, sa të ngjashëm me personazhet realë aq edhe të veçantë e të ndryshëm prej tyre. Nëse arrijmë t’i shohim figurat e krijuara nga Petro Marko në këtë roman, kjo ndodh sepse ai ka përdorur kodin e autorit, si tërësi kombinimesh midis materialit gjuhësor dhe aftësisë imagjinare. Gjithashtu, kjo lidhet ngushtë edhe me kodin e lexuesit, me aftësitë e tij për të përfytyruar personazhin gjatë leximit të veprës. Ndërtimi i figurës, në këtë roman ka qenë një proces i vështirë, duke iu referuar parimeve dhe teknikave që mundësuan lindjen e saj. Këto parime janë tejet të larmishme, që e dallojnë këtë roman nga veprat e tjera të shkrimtarit. Sistemi i tij i detajeve, teknikat e ndërtimit të figurës kanë nxjerrë në pah veçantitë e stilit të shkrimtarit.

Në strukturën artistike të romanit, me qëllim krijimin e personazheve të papërsëritshëm, pleksen elementë të

poetikës realiste dhe simboliste. Çdo veprim e çdo mendim luan rolin e vet në mekanizmin e formësimit të figurës-personazh, duke u shfaqur si një sistem mjeteslh ligjërimore, të cilat hyjnë në raporte të veçanta midis tyre. Ky është në të vërtetë sistemi i të menduarit artistik të Petro Markos. Ashtu si në veprat e tjera, edhe në këtë roman, shkrimtari ynë krijon një sistem mjaft të pasur të mekanizmit të ndërtimit të figurës.

Mënyrat e krijimit të figurës

Petro Marko i krijon figurat në mënyrë të larmishme. Shpesh ato vizatohen nga pozicioni i një vëzhguesi që sheh gjithçka, i cili ka mundësi të depërtojë në gjendjen e brendshme të personazhit, në ndjenjat, mendimet dhe përjetimet. Pra, pikëvështrimi i figurës është i brendshëm. Këtë rol e luan rrëfimtari-autor, i cili njeh thelbin e personazhit edhe në rastin kur kjo është e fshehtë dhe nuk kuptohet lehtë nga vëzhgues të tjerë. Në bazë të këtij parimi është ndërtuar edhe figura e Lekës tek romani “Qyteti i fundit”. Në skalitjen e kësaj figure, autori duket sikur niset nga detaje të jashtme të personazhit, e më pas, dalëngadalë, futet në thellësitë e botës së tij të brendshme, duke krijuar kështu një figurë të krejt të veçantë. Figura e Lekës është ndërtuar me cilësinë narrative të orikulizmit, pra përcakton moshën e personazhit nga zëri i tij, ndryshe nga përfytyrimi i portretit të Ana-Marias, që bëhet me cilësinë narrative të okulizmit, pra të rrëfimit në shikim. Në vijim, figura e Lekës plotësohet nga përshkrimet e Ana-Maria Montit dhe nga personazhet e tjerë të romanit, shoqet e shokët e tij, madje edhe nga personazhe të palës italiane. Në saje të këtyre përshkrimeve, dalëngadalë, figura afrohet tek ne dhe shfaqet e plotë. Pas gjendjes së paqëndrueshme të personazhit dhe, herë-herë, kontradiktore

(kur bëhet fjalë për ndjenjën e tij për Ana-Marian), vizatohet një figurë e fuqishme, e cila është origjinale dhe me ngarkesë të veçantë emocionale.

Është karakteristikë e Petro Markos që, pothuajse në të gjitha romanet e tij, si mënyrë të portretizimit të personazheve, të përdorë dialogun imagjinar. Ky dialog imagjinar, në formën e një monologu të brendshëm, në dukje naiv dhe fëmijëror, është një mënyrë shumë interesante e ndërtimit të figurës së Ana-Maria Montit në rastin konkret dhe të figurës së personazheve në përgjithësi. Duke imagjinuar një bisedë me një gaforre të vogël, ajo në fakt krijon, imagjinson një bisedë me vetveten. E frikësuar, e terrorizuar, e lodhur në kulm nga e kaluara e saj e hidhur, nëpërmjet gaforres ajo shprehet ndjenjat e saj. Mosbesimi i gaforres, është mosbesimi i Ana-Marias. Ashtu si gaforrja ka frikë nga njerëzit, edhe Ana-Maria ka frikë prej tyre. Madje, ajo nuk ka besim as tek deti. Fakti që edhe deti, më lëvizjet e dallgëve, ia shtrembëron pamjen, e bën atë që të ndjehet e dhunuar dhe e frikësuar edhe prej tij. Më tej, kur Ana-Maria kujton Lekën duke e cilësuar të bukur emrin e tij. Me këtë cilësim të emrit, duke u bazuar nga konceptet estetike mbi të bukurën, do të kuptojmë se këtu nuk bëhet fjalë thjesht për emrin e Lekës, por për bukurinë shpirtërore të tij, për mirësinë që e karakterizon, humanizmin dhe moralin e lartë. Në procesin krijues për konkretizimin e figurës-personazh, shkrimtari përdor disa procedura. Gjatë ndërthurjes së episodeve dinamike apo statike, skenave realiste apo imagjinare, përshkrimit të dëshirave dhe të impulseve të brendshme të personazheve, autori ndërton një strukturë të plotë artistike, brenda së cilës formohet një galeri personazhesh e papërsëritshme në llojin e vet. Fakti që figurat e krijuara nga Petro Marko janë si të gjalla përpara syve

tanë, flet për kodin krijues të autorit, si tërësi kombinimesh midis lëndës gjuhësore dhe aftësive imagjinare. Kjo lidhet edhe me kodin personal, përjetues-imagjinativ, të lexuesit apo me situatën emocionale në momentin e leximit. Ndikimi i romaneve të Petro Markos në vetëdijen dhe në subkoshiençën e lexuesit është krejt i veçantë, i thellë, i drejtpërdrejtë dhe i prekshëm. Çdo lexues, gjatë leximit të veprës së tij, arrin që t’i shikojë personazhet: të shohë bukurinë apo shëmtinë e tyre, të përjetojë së bashku me ta situata të ndryshme, të dashurojë ndonjë prej tyre apo të urrejë ndonjë tjetër. Pra, funksioni artistik i gjuhës krijon një raport të dukshëm midis lexuesit dhe personazhit dhe i dhuron lexuesit pamjen e figurës, duke i krijuar atij emocione të drejtpërdrejta.

Individualizimi i personazheve në prozën e Petro Markos bëhet me psikorrëfimin dhe e transmeton ligjërimin e brendshëm të tyre duke e ndërthurur atë edhe me ndërhyrjen autoriale. Vlerësimi eksPLICIT dhe rrëfimi komentues në tekst, artikuloohen kryesisht nëpër dialogë apo në ligjëratën e drejtë të riprodhuar gjatë ligjërimit të brendshëm të personazheve. Ndërkaq, në psikorrëfim vërehet denduria e kohëve rrëfimore, që e shënojnë këndvështrimin e rrëfimit të personazhit dhe distancimin e zërit rrëfyes, që më tepër pretendon ta shfaqë figurshëm vetëdijen e brendshme të personazhit sesa të informojë për të. Përshtypja për vetëdije figurative arrihet sidomos tek monologët e rrëfyer, që rëndom shënojnë gjendje të emocionimit të skajshëm të personazheve. Në gjuhën e këtij lloji rrëfimi, denduria e ndërhyrjeve autoriale me përforcues gjuhësorë del si përpjekje për t’u njehsuar me gjendjen emocionale të personazheve, kryesisht përmes gjuhës së figurshme.

Vështrim

PSALMODI E NDJESHMËRISË FEMËRORE

(Rreth librit poetik "Burri i netëve të mia" të poetes Neviana Shehi, botoi Armagedoni, Prishtinë)

Nga Mexhid MEHMETI

Në poezinë bashkëkohore shqipe, zëri femëror gjithnjë e më shumë po artikulohet si një vetëdije poetike e lartë, si një rrëfim që përçon intimitetin dhe universin emocional me nuanca filozofike dhe mitike. Përmbledhja poetike “Burri i netëve të mia” e Neviana Shehit, është një dëshmi ndër të rrallat e këtij artikulimi të sofistikuar: mozaik poetik ku femërorja ngjitet në panteonin e përvojave sublime – si dashuri, mungesë, shpirt, trup, por edhe liri e protestë ndaj kornizave të ngurta të konvencionalitetit.

Titulli i librit, “Burri i netëve të mia”, nuk është një metaforë e rastësishme. Ai vendos menjëherë një koordinatë intime, një akt përqafues dhe ndriçues të brendësisë së autores, që krijon me të drejtën e së shenjtës një subjekt poetik të guximshëm dhe provokues. Poezitë nuk janë thjesht rrëfime dashurie, por akte rituale të një gruaje që nuk frikësohet të shpërfaqet “e pambrojtur” në një botë të zhurmshme. Intimiteti këtu është një akt rezistence poetike.

Në cikle si “Një rënkim i zgjatur gruaje”, “Kujtim deri në amshim”, apo “Ngjyrat e heshajes”, përshkohet një ndjeshmëri e thellë, ku trupi femëror nuk është objekt i vështrimit mashkullor, por vetë një mitologji personale që sfidon kodet e zakonshme të përshkrimit poetik. Autoria jo vetëm e erotizon fjalën, por e ngarkon me dimensione lirike, që shpesh flirtojnë me sacrumin e tokësores.

Gjuha – ndërmjet muzës, metaforës dhe



geishës së fjalës së bukur

Neviana Shehi zotëron një gjuhë të pasur me metafora, ku sensualiteti shndërrohet në një formë meditative të ekzistencës. Vargu është i lirë, i frymëmarrë, por njëherazi i organizuar me kujdes të veçantë në ritëm, tingull dhe atmosferë. Në poezinë “Geisha e fjalës së bukur”, autorja e vetëvendos veten si një geiko moderne, jo skllave e pasionit mashkullor, por e fjalës dhe krijimit:

“Nata për mua është një mbretëreshë / kurse lexuesit balerinë të së bukurës...” – është një vetëdefinim estetik dhe ekzistencial që nderon fuqinë e femrës

krijuese.

Stili i saj ndërthur me mjeshtëri elemente të mitologjisë lindore dhe perëndimore, përshkon hapësira urbane dhe pyje legjendare, zhytet në ngjarje të kujtesës personale dhe kolektive, gjithmonë duke e mbajtur lart emocionin, si një shtyllë vertebrale të gjithë ndërtimit poetik.

Dashuria, mungesa, koha, kujtesa

Motivi i dashurisë si mungesë dhe prani njëkohësisht është kryesor. E dashura e përjetshme jeton mes realitetit dhe ëndrrës, herë si kujtim që shpërthen në imazhe, herë si trup i përvëluar nga

dëshira, herë si fjalë që rrëqeth:

“Në shumicën e herëve

trupi im digjet

mes katërmbëdhjetë zjarresh

të ndezura nga ëndërrimet...”

Mungesa e dashurisë nuk është mërgim emocional, por një tokë poetike ku autorja rikrijon mitin personal të të dashurit – që shpesh është ëndërr, imazh, zë, hije apo fragment libri. Koha dhe hapësira shpesh deformohen, i lëshojnë vend imagjinatës dhe mitologjizimit të përvojës, si në poezinë “Stacioni i fundit i verës së vonë” apo “Mbas nëntë kodrinave të kuqe”.

Në këtë libër, femra është subjekt absolut i përjetimeve. Poetësha artikulon një botë të tërën në vetën e parë, ku ajo është edhe geisha edhe shenjtorja, edhe fëmija edhe perëndesha, edhe e brishta edhe e fuqishmja, duke krijuar kësisoj një topografi të ndjeshmërisë femërore që ndërton ura të reja midis intimes dhe universale.

Ky diskurs femëror është një akt emancipues poetik, sepse nuk përpigjet të imitojë zërat maskilistë të traditës, por të krijojë një hapësirë autentike për të rrëfyer botën nga brenda, përmes syve të saj, ndjesive të saj, dhe dashurive të saj. “Burri i netëve të mia” është një univers poetik intim dhe thellësisht njerëzor, ku ndjeshmëria femërore ngjitet në lartësinë e artit të vërtetë. Neviana Shehi dëshmon me këtë vepër originalitet poetik dhe vizion të emancipuar të gruas si krijuese, duke e pasuruar letërsinë shqipe me një zë të pjekur, modern dhe të paharrueshëm.

Profile

JAKOV XOXA

Qetë dhe pandërprerë shkroi mijëra faqe në prozë, të cilat sot i kemi të botuara në dy vëllime me novela dhe tre romane, që janë ndër krijimet si rrallë më të bukura në sfondin e përgjithshëm të letërsisë sonë kombëtare



Nehas SOPAJ

U lind në Fier në vitin 1923. Jetoi i izoluar nga zhurma e qyteteve dhe pjesën dërmuese të jetës e kaloi në një fshat në afërsi të Fierit. Pas shkollimit fillor në vendlindje dhe atij të mesëm në Korçë, gjatë LDB-së - si shumica e intelektualëve shqiptarë - u inkadrua në Lëvizjen Nacional-Çlirimtare, ndërsa studimet i bëri pas lufte. Një kohë punoi në universitetin e Tiranës, ku mbajti leksionet për teori të letërsisë. Teksti i tij, me titull Bazat e teorisë së letërsisë, kishte mbetur në dispensë. Si edhe shumë shkrimtarë të tjerë që në epokën komuniste ishin marginalizuar, injoruar dhe ndjekur, edhe ai krijoi jashtë qarqeve të zhurmshme, në vetmi, por veprën e tij letrare e bëri unike në mbarë letërsinë tonë. Qetë dhe pandërprerë shkroi mijëra faqe në prozë, të cilat sot i kemi të botuara në dy vëllime me novela dhe tre romane, që janë ndër krijimet si rrallë më të bukura në sfondin e përgjithshëm të letërsisë sonë kombëtare. Krahës dy vëllimeve me tituj Novela I dhe Novela II, J. Xoxa la pas vetes tre romane shumë të njohura me titujt Lumi i vdekur, Juga e bardhë dhe Lulja e kripës. Autori, në fillim, kishte paramenduar të bënte një pentalogji, diçka si një sagë shqiptare prej pesë romanësh, në mënyrë që hollësisht ta shkruante historinë e romanëzuar të shqiptarëve (diçka si romanet e H. De Balzaku në letërsinë frënge), por paramendimi i tij u realizua pjesërisht. Sipas konceptit të përgjithshëm të realizmit klasik botëror, frëng e rus, që të pasqyrohet jeta e realitetit në totalitet, në atë rrugë kish shkruar edhe J. Xoxa. Synimi i tij për ta pasqyruar fshatarësinë dhe, në përgjithësi, jetën shqiptare, shihet në shkrime të ndryshme, në intervista e deklarata të lëna prej tij, por kjo nuk kishte ndodhur, sepse vdekja e hershme ia kishte pamundësuar këtë gjë. Prandaj, pesë romanët, dy prej të cilëve do ta përshkruanin periudhën para LDB-së (Lumi i vdekur dhe Lulja e kripës), periudhën e LDB-së (Dielli lind në male) dhe periudhën fill pas LDB-së (Juga e bardhë dhe Ari i zij), ishte realizuar kaq sa kish mundur, ngase tre romanet e tij – Lumi i vdekur 1964, Juga e bardhë, 1971 dhe Lulja e Kripës, 1978 u botuan dhe ribotuan, kurse dy të tjerët mbetën projekte që lexuesit vetëm mund t’i përfytyrojnë, por jo edhe t’i ketë në dorë. Tre romanet që lexuesit shqiptarë i kanë në duar, janë një pasqyrë e detajuar e realitetit shqiptar, më saktë ato pasqyrojnë jetën e fshatarësisë

shqiptare, të përshkruar imtësisht deri në detajizime dhe thellësi çfarë edhe realisht i kishte paramenduar autori. Marrë në përgjithësi, fillimet e para letrare të J. Xoxës kanë qenë me poezi, por meqë autori s’ka lënë ndonjë vepër letrare me peshë në poezi, për krijime të para merren tregimet dhe novelat e tij të botuara në dy librat e tij Novela I (1949) dhe Novela II (1958). Duke u çmuar si një ndër shkrimtarët më të rëndësishëm, me vlera të larta artistike në mbarë letërsinë e sotme, tregimet dhe novelat e autorit janë me tema dhe motive të të ndryshme, të fshatarësisë, të thellësive historike, të luftës që sapo kishte përfunduar etj. Tregimet dhe novelat Frika e xha Llukanit, Arka e thyer, Tre pleqtë dhe Mihajli, Gjeti Ustai Ustanë, Kurorat e Masar beut, Njeriu që s’kishte parë diell me sy etj. janë sprovat që dëshmojnë për talentin e rrallë të shkrimtarit që në të ardhmen do të shndërrohet në një mjeshtër të hollë të pendës, mjeshtër i detajit dhe i peizazhit dhe, në përgjithësi, rrëfimtari i spikatur, mjeshtër, përzgjedhës dhe skalitës i fjalës së bukur shqipe. Duke qëndruar mes prozës sociale të Migjenit dhe tregimtarisë së M. Kutelit, tregimet dhe novelat e J. Xoxës dëshmojnë për një regjistruar të hollë dhe objektiv të realitetit shqiptar në përgjithësi. Gjithçka që shihet dhe preket (bota objektive) dhe çdo gjë që përfytyrohet (bota subjektive), janë platforma letrare e detajuar dhe e shpërndarë pastaj në harmoni nga mjeshtri ynë dhe këto janë totaliteti i realitetit objektiv që nxjerr në dritë pena e autorit. Krahës regjistruarit të realitetit, të pikasur herët, që në tregimet e para, lexuesi do të vërejë një ngjyrë ironie, që nganjëherë shkon në humor dhe tragjikë njëkohësisht, që në fakt është jeta e vërtetë dhe reale shqiptare. Tregimet dhe novelat ua hapin rrugën romaneve të autorit. Në këto tregime dhe novela shihet sensi i rrëfimtari si mjeshtër, që në mënyrë të gjithanshme pasqyron temën që merr ta trajtojë. Koz Vërtopi, në novelën Gjeti ustai ustanë, i pasqyruar në tre tablo, Beu te novela Kurorat e Masar Beut ose ndonjë personazh tjetër, flasin për autorin si mjeshtër të rrëfimit që atë që e merr ta rrëfejë, e rrëfen deri në fund dhe në mënyrë të gjithanshme, ashtu që lexuesi mbetet i kënaqur nga lënda që ka lexuar. Tiparet karakteristike të tregimeve dhe novelave janë shenjat që paralajmërojnë romanin e parë të J. Xoxës, Lumi i vdekur, që - sipas mendimit të përgjithshëm të

kritikës – është vepra letrare më e realizuar e autorit. Për ta bërë këtë vepër një roman epope dhe të gjerë të realitetit të hidhur shqiptar në prag të LDB-së, autorit i ishte dashur një parapërgatitje e madhe, rrëfimet me elementet e domosdoshme, kohën dhe hapësirën dhe personazhet që do t’i trajtojë. Për ta hedhur në dritë lëndën e vet, ashtu siç edhe realiteti e ka hedhur në letër, pra në tërësinë e anëve të mira e të këqija të tij, atij i është dashur ta njohë mirë Myzeqenë, truallin në të cilin do ta plasojë “dramën” e ngjarjeve që do ta trajtojë për të cilin do të flasë në vepër, t’i njohë rrethanat politike, sociale e kulturore në kontekstin kohor socio-politik dhe, në përgjithësi, i është dashur t’i studiojë mirë e hollë personazhet e tij dhe, në fund, t’i skalisë kaq gjithanshëm dhe në mënyrë reale, duke u hyrë në thelbin e tyre deri në imtësi, madje edhe në gjuhën tipike dialektore. Titulli i romanit Lumi i vdekur është një titull karakteristik, që ngërthen në vete një simbolikë dhe një metaforë të zgjeruar. Ky është lumi Seman, të cilin e shpjegon një ndër personazhet kryesore të romanit, Koz Dynjaja, në një dialog të tij me personazhin tjetër, duke ia rrëfyer legjendën e lumit të vdekur, që në fakt është një lloj uverture e botës së brendshme me të cilën do të ndeshë lexuesi në rrëfimet e gjera të shkrimtarit. Në fjalën e tij, ky personazh tregon prej nga kishte mbetur ky emërtim në gojë të popullit. Në fjalën e zgjatur të personazhit, si edhe në përgjithësi në gjuhën e folur të këtij romani, ky personazh e tregon historinë e lumit, si një lumë me shumë ngjarje, “një parajsë për mushkonjat”, siç thotë ai, prej nga shpërndahen sëmundje të ndryshme siç është malaria, me çka sikur do të paralajmërojë se në këtë vend është djepi i së kaluarës që duhet ndryshuar, diçka që virgjërinë e natyrës e pret ndryshimi i rendit të ri shoqëror. Ai, pastaj, bën një krahasim të Lumit të Vdekur me Pilo Shpiragun, njërin nga personazhet kryesore të romanit, të cilin e vë në shënjestër të ironizimit, duke ia bërë portretin atij si një njeri që skamja e kish bërë lakmtar, një njeri pa sedër, një njeri që koha e egër e robërisë e kish shndërruar në qenie që s’sheh perspektivë për të ardhmen dhe pajtohet me robërinë shoqërore dhe familjare. Kështu semantika e lumit të vdekur shndërrohet në metaforë të qëlluar që paralajmëron idenë qendrore të romanit – përmbysjen e rendit shoqëror të skllavërimit të fshatarësisë nga bejlerët e agallarët. Ky titull simbolik i përshkruan vitet 1938-1939 në prag të LDB-së, që,

sikur paralajmëron fillimin e luftës së Dytë Botërore, e këtë e arsyeton vetë përfundimi i romanit, kur dy personazhet kryesorë, Adili dhe Vita, vendosin ta braktisin pronën e Beut, që është ngjarja e fundit e romanit pas ngjarjeve të shumta që ndodhin në “dramën” e fshatit shqiptar. Romani i ka dy linja të mëdha të rrëfimit. Linja e parë përbën fatin e dy të rinjve, që është e mpleksur me ngjarje, tablo dhe përshkrime intime deri në natyralizëm. Përshkrimi i bukurisë femërore që shkrimtari i bën Vitës, është ndër më të mirët dhe më pikantët në tërë romanin shqiptar. Gjuha e zgjedhur lakonike e personazheve, metaforat dhe metonimitë në dialogët e gjatë e të shumtë, në këtë linjë intimiste të romanit e mbajnë zgjuar kureshtjen e lexuesit. Linja e dytë është ajo me të cilën janë sintetizuar aspektet shoqërore të romanit, të cilat janë të shumta, me personazhe episodikë nga më të ndryshmit. Këto janë ato që kanë të bëjnë me dramën shoqërore, me aspektet konfliktuozë të personazheve të shumtë, drama dhe skena dramash që konfliktuohen dhe që janë të karakterit shoqëror e klasor, por edhe në atë brendafamiljar, myzeqar dhe kosovar, që zënë një hapësirë më të madhe se e para. Një galeri personazhesh pozitive dhe negative parakalojnë nëpër mendjen e lexuesit dhe asnjëri prej tyre nuk është i tepërt në roman, sepse - duke i portretizuar të gjithë ata me botët e tyre individuale, shkrimtari i pasqyron me gjuhën e të folurit dialektor, shumë tipike për gjuhën e romanit tonë realist klasik. Tema kryesore, fshati shqiptar në kohë të periudhës së sundimit zogolliot, pozita e mjerueshme e fshatarëve të viseve të ndryshme të Shqipërisë, të cilët halli i rëndë ekonomik i gjen në mjerimin e tyre të thellë, nga njëra anë, dhe Suat Bej Verdhomës, si përfaqësues i shtresës eksploatuese, nga ana tjetër, janë dy polet e kundërta të cilat shkrimtari i vë në epiqendër të rrëfimeve të tij, duke e nxjerrë në dritë botën konfliktuozë klasore dhe të polarizuar të fshatarësisë shqiptare, si edhe pikëpamjet e autorit rreth luftës së klasave. Kjo është një fushë e gjerë e trajtimit letrar, të cilën autori merr ta materializojë deri në imtësi, merr të regjistrojë, vlerësojë dhe, me anë të rrëfimtari të tij, të çmojë se si dhe kah do të lëvizin veprimet e personazheve të tij në kontekstin kohor/ hapësinor. Vetë ky lumë i egër dhe i virgjër për nga lashtësia sikur ngjjet me kohën të cilën e përshkruan shkrimtari në romanin e tij, një kohë e egër që mund të

HEJZA



si amoralitet, por edhe e ndëshkon, duke e fshikulluar nga kryepar i familjes në genie pa vlerë. Gjunjëzimit përbuzjeve të Pilo Shpiragut autori i kushton një kaptinë më vete, duke e zhveshur shpirtërisht, kur ai kthehet i përlulur dhe pa dinjitet.

Krejt të tjerë janë Koz Dynjaja dhe Sulejman Tafili. Edhe pse edhe Koz Dynjaja është myzeqar, si edhe Pilo Shpiragu, ky i fundit e ka frymën e një njeriu krenar që nuk u nënshtrohet përbuzjeve të Beut dhe zullumit të tij. I kalitur në kohë të rezistencës së vitit 1924, Kozi është njeri që ka shpresë se gjendja e vështirë e fshatarësisë do të ndryshojë një ditë dhe gjithandej është përpLOT sarkazëm ndaj Beut dhe njerëzve të pushtetit të tij, të cilët janë parazitë dhe s’ngopen nga shfrytëzimi që ua bëjnë të tjerëve. Në anën tjetër, Sulejman Tafili, kryepari i familjes së kosovarëve, në profilin e tij është simpatia e shkrimtarit për shumë arsye, mbase edhe për shkak të fatit tragjik të shqiptarëve të Kosovës, të cilët asobote hiqnin të zitë e ullirit nga zullumi i pushtetit serb. Autori arrin simpatinë e lexuesit në gdhendjen e personazheve, duke i pasqyruar mu siç janë në jetën e përditshme, sidomos në rrafshin e barazimit moral. Ato ndërtohen mu ashtu siç njihen,në përgjithësi,në botë si norma dhe kode shoqërore, të cilat janë universale dhe të cilat të gjithë shkrimtarët janë të detyruar t’i njohin dhe trajtojnë si të tilla. Duke qenë një vepër me një angazhim shoqëror, ajo e ka substratin e një materiali që synon të futet në artin e angazhuar.

Në roman ka dhjetëra personazhe të dorës së dytë dhe episodikë, të cilët ia rrisin rëndësinë duke e bërë një vepër që i ngjet një mini-sage interesante. Në një galeri personazhesh, pozitivë dhe negativë, shkrimtari e krijon botën njerëzore në tërësinë e saj në të gjitha spektrat e dimensionet universale, jetën dhe vdekjen, të mirën dhe të keqen, të vërtetën dhe gënjeshtërën, realen dhe ëndrrat etj. Vargu i personazheve epizodikë siç janë Leksi, Ferhati, Kiu, Tonxhi, Trifoni, Gjyshja Sofë, Llazi, Myftar Aga, Suat Beu, Pip Kedhi, Papu Athanasi, Xha Limoni, Lip Gjanica, Peç Mblaci, Lako Zhulapi etj., të cilët shkrimtari i individualizon, duke ua profilizuar botët e tyre të brendshme me vetitë dhe veset e tyre të ndryshme personale, që d.m.th. se ai i individualizon në kontekstin e tyre shoqëror dhe individual. Duke qenë romani më i mirë i autorit dhe një ndër veprat më të lexuara nga lexuesit shqiptarë, ajo është ndër veprat më të realizuara artistikisht jo vetëm të autorit, por në përgjithësi në tërë romanin shqiptar.

Romani Lulja e Kripës e trajton një subjekt të vitit 1940 – vitit të parë të pushtimit të vendit nga italianët. Ky roman për nga koha mëton të jetë vazhdim i romanit Lumi i vdekur, edhe pse - si për nga përbërësit kryesorë, personazhet, idetë dhe ngjarjet – është krejt tjetër nga ai. Fillimisht në

kohën e pushtimit klasik, në Naforë të Myzeqesë, në vend të atmosferës së Luftës së Dytë Botërore që merr ta trajtojë, shkrimtari na kthen në vitet e pushtimit të vendit në kohën kur s’ka rezistencë, kur krerët politikë të kohës përgatiten t’ia mbathin nga atdheu. Në epiqendër janë dy familje kundërshtare – ajo e Grigor Dosarit dhe e Milto Sopit, e para familje më e madhja e arhondeve të Naforës, ndërsa e dyta është e prijesve të Kripores që është vendi ku punojnë dhe mbijetojnë të gjithë. I pari i arhondeve, Grigori, është brezi i tetë i arhondëve, të cilët e kanë mbajtur me dhunë pushtetin, dekada me radhë. Me vdekjen e të vëllait, Grigori ua mohon trashëgiminë bijve të vëllaut, kështu që në rrethanën e re të luftës, ata hidhen në mal. Familja tjetër, ajo e Milto Sopit, e ka origjinën e përkundërt nga ajo e Grigor Dosarit, ai dikur kishte qenë i varfër, kurse dy djemtë e tij, Maji dhe Paci, marrin tjetër rrugë jetësore. Gjersa Miltoja, pas shumë abuzimeve burgoset, njeri prej djemve, Maji, arratiset, ndërkaq tjetri, Paci, zhduket.

Të dy familjet, në kushtet e luftës, dëshirojnë t’i ndryshojnë pozitat e tyre shoqërore: Dosarët, që janë në rrënim e sipër, përpiqen ta ruajnë pozitën tyre që e kishin pasur dikur, si sundimtarë, Sopajt për shkak të varfërisë sociale vrapojnë që me çdo kusht ta ndryshojnë pozitën e tyre dhe të pasurohen, kështu në nyjat kyçe të rrëfimit, siç janë demonstratat dhe rezistenca kundër bllokimit të gjolit etj., rruga e familjes shkon duke e ndryshuar, duke e përkrahur pushtuesin italian. Ndryshojnë pozitat e dy familjeve, ndodh diçka si parabolë, që në mënyrë artistike del në dritë të së vërtetës diçka groteske. Grigor Dosari është shtypës dhe egoist i pamëshirshëm, kurse Milto Sopi personazh dinak dhe hipokrit i paskrupullt. Në karakterin e tij, Grigori s’ndryshon asnjëherë, ai arrin të krijojë lidhje me pushtetin e ri, në rastin konkret me pushtuesit fashistë, përkundër nipërve të tij, të cilët përpigën ta zmbrapsin atë nga rruga e gabuar. Asaj rruge hidhet edhe Miltoja, po asaj rruge ku shkon Grigori. Duke e drejtuar Kriporen, ai e braktis Mellanien, të gruan e tij të sëmurë, dhe vrapon pas femrave tjera, ndërkaq të bijtë e tij, Maji dhe Paci, largohen nga ai, kështu që i tërë romani përfundon me një fund rrotullimesh të papritura të fateve dhe të botëve të ndryshme të personazheve.

Personazhet e romanit Lulja e kripës, ngjashëm si te Lumi i vdekur, janë të shumtë, por ndryshe nga i pari që përbën tri familje, këtu janë dy që bartin ngjarjet. Shkrimtari, në mënyrë të detajuar, ndërton linja rrëfimi të dorës së parë e të dytë, kurse në skalitjen e karaktereve e derdh tërë talentin e tij duke e bërë tipologjizimin në mënyrë të përkryer me anë të pasqyrimin grotesk të personazheve. Ndër personazhet më të realizuar është

shkatërrojë çdo gjë (kjo i ngjet forcës fiktive të romanit), diçka që lëndës romaneske i jep një ngjyrë të veçantë artistike. Për rrjedhojë, lëvizja e personazheve që kundërshtohen detyrimisht, në ambientin e shoqërisë me luftën antagoniste të klasave që konfrontohen, e krijojnë mozaikun e dramës së fshatit shqiptar, tronditëse dhe rrëqethëse, me tërësinë e vet të ligjshmërive, kauzalitetin real dhe metafizik dhe, njëkohësisht, sociologjik që nënkuptojnë vargjet e ngjarjeve të shumta që pasqyron autori në roman.

Në roman, shkrimtari me mjeshtri të rrallë e gdhend fatin e hidhur të tri familjeve shqiptare, asaj të Pilo Shpiragut, një familje myzeqare, të cilin e ka dëbuar Beu nga prona e tij, Sulejman Tafilit me familje, të cilin fati e ka shtrënguar ta braktisë Kosovën, për shkak se i vëllai i tij e ka vrarë një ushtar serb dhe prandaj është detyruar ta marrë arratinë, si dhe të Koz Dynjasë, myzeqarit tjetër që gjithashtu me familjen e tij fati e ka sjellë të jenë bashkë në një ambient. Linjën kryesore të romanit, fatin e dashurisë së Adilit dhe Vitës, shkrimtari e përcjell prej fillimit deri në fund, kurse linjat e tjera të personazheve të tjerë i përcjell duke mos e harruar boshtin qendror – fatin e fshatit shqiptar në luftën e klasave, duke bërë një ndërlidhje botësh të ndryshme, duke gërshetuar një konglomerat mozaikësh të ndryshëm të rrëfimit, që janë shumë tërheqës dhe atraktivë. Subjekti i romanit ngjizet me takimin e tri familjeve fshatare në Trokth, me ç’rast fillon të qepet drama me ngjarjet e shumta që do të pasojnë. Këto janë një mori të bërmash të ndryshme që zhvillohen paralelisht dhe pavarësisht nga njëra-tjetra, ndërsa ajo që i lidh të gjitha ngjarjet është fati i dy të rinjve, Adilit dhe Vitës, si dhe dashuria e tyre e virgjër që ka një ngjyrë romantike. Linja erotike e dy të rinjve fillimisht nis me konfrontim të familjeve të tyre, por që pastaj të afrohen derisa në fund të romanit madje edhe të bashkohen. Linjë qendrore e romanit është dashuria e dy të rinjve, kah fundi i romanit, impresive është sidomos arratisja e Vitës dhe Adilit drejt një fundi me shumë të panjohura, me një fund ekzotik. Po ku shkojnë dy të rinjtë pas arratisjes? Shkrimtari s’tregon, por lexuesi e ka të qartë se është pragu i LDB-së, ndaj vazhdimi i rrëfimit presupozon një roman më vete të nënkuptueshëm.

Nëpër faqet e romanit ka drama të gjera e të mëdha, skena ngjarjesh të ndryshme, kurse në përpjekjet për t’i lidhur ato autorit i janë dashur vjegëza të forta rrëfimi që ta mbajnë kureshtjen e lexuesit. Dhe, autori këto i realizon në mënyrë të mrekullueshme. Kulminacioni i romanit mund të jetë intrigimi i shkrimtarit, duke na mbajtur në “ethet” e përpjekjes së Beut për ta dhunuar Vitën, që është drama qendrore e romanit ku autori si skalitës i luftërave të klasave, në imtësi pasqyron realitetin objektiv pa shumë elemente socrealiste që i karakterizon shkrimtarët tjerë shqiptarë. Kjo është dora mjeshtërore e shkrimtarit për të na futur në skenën e dramës së vërtetë të demaskimit moral të Beut si prototip i personazhit negativ, por edhe të së keqes së përgjithshme shoqërore, si protagonist i së cilës është ai. Adili e vret Suat Bej Vërdhomën, por jo edhe gjithë atë klasë shoqërore bejlerësh, të cilët koha i kishte shkelur moralisht bashkë me atë klasë shoqërore që sundonte ekonomikisht dhe politikisht me shoqërinë shqiptare.

Më i realizuari ndër më të realizuarit është Pilo Shpiragu, figura qendrore e romanit nga rrethi i myzeqarëve. Ai është një fshatar i munduar, i pajtuar me shfrytëzimin që i bën Beu atij dhe familjes së tij. Për të dalë nga gjendja e mjeruar e shfrytëzimit, ai - me marrjen me qira të një ferme –me mish e me shpirt përpigjet ta shporrë skamjen dhe urinë dhe në këtë aspekt s’e ka për turp nëse i mashtron të tjerët, që d.m.th. s’e ka për turp nëse shkon udhës së shfrytëzimit, mu ashtu siç bën Beu me të dhe me të tjerët. Më e keqja është se sado që për ambicie e ka të kujdeset për rrethin e ngushtë të familjes, por kur Beu ia kërkon të bijën, gjoja për punë shtëpie në pronën e tij, ndonëse në fakt për ta bërë pronë, për ta dhunuar, ai bëhet gjoja sikur s’e kishte kuptuar pse po ia kërkonte të bijën dhe pa fije turpi shkon dhe ia shpie të bijën duke ia baltosur moralin asaj, vetes dhe, në fund, tërë familjes. Humbjen e nderit të shqiptarit për shkak të gjendjes së rëndë ekonomike autori jo vetëm që e koncipon

Patra, gruaja e mallkimit, e cila është një “kërcim” i vërtetë artistik i autorit, me çka ai krijon një roman të tipit të realizmit magjik. Kur i lexon faqet e këtij romani, që kanë të bëjnë me këtë grua, lexuesit sikur i del përpara një nga personazhet e romanit latino-amerikan (p.sh. nga Markezi), sepse autori në mënyrë të shkëlqyer e ngjesh një element mistik me një botë të brendshme të pashqiptuar deri në fund, sikur ke të bësh me një figurë fantazmë, të realizuar për mrekulli. E mbushur me mllef, tërë kohës, ajo e mallkon Grigor Dorsarin. I kësaj natyre është edhe Peri i Këputur. Këtu linjat e ngjarjes dhe të përshkrimit sikur dalin nga klisheja e realizmit socialist dhe e mira dhe e keqja sikur janë të ndërvarura njëra me tjetrën, duke u plotësuar mes vete.

Romani tjetër, Juga e Bardhë, i shkruar i dyti me radhë pas Lumit të Vdekur, ngjarjet i vendos në një kohë të re, të viteve të para pas LDB-së. Ky roman, ngjashëm si edhe dy romanet e tjera, është voluminoz dhe ka një mori elementesh të theksuara socrealiste, siç është kolektivizimi i tokës dhe sidomos pasqyrimi i kontradiktave shoqërore në kohën e ndërtimit socialist të vendit etj., tipike për kohën e socializmit. Si edhe disa nga veprat tjera të realizmit socialist, të cilat qenë porositur nga shkolla zyrtare e pushtetit popullor, edhe te Juga e Bardhë shkrimtari temë qendrore ka gjithçka që lidhet me punën në kolektivitet. Tema e punës, ngjashëm siç edhe emërtohet vetë titullari Partia e Punës, shkrimtari këtu lokalizohet në trajtimin e fatit të njerëzve brenda një kooperative të një fshati në Myzeqe, ku ndodhin ngjarjet e jetës së përditshme të cilat autori i përshkruan në detaje, nganjëherë madje edhe “të lodhshme” për lexuesit. Krahas skalitjes së personazheve siç është traktoristi Adnan, në kontekst të realizmit socialist trajtohen edhe tema të tjera, siç është zhvillimi i revolucionit socialist, emancipimi i fshatit, skalitja e socialistit të ri etj., disa nga “ekstraktet” tipike të ideologjisë komuniste.

Ngjashëm si edhe te romani Lumi i Vdekur, aty në epiqendër janë familjet myzeqare të Shpiragajve, Kito Çuçit dhe ajo e Xha Likos, kurse dinamika e zhvillimit të ngjarjeve karakterizohet me atë se ato në këtë vepër lëvizin pak më të ngadalësuara, paksa më ndryshe nga dy romanët e tjerë të mëparmë. Edhe pse kontradikat këtu duken më të dukshme se te romanët e tjerë, vetë natyra e veprimit të ngadalësuar bën që dramaticiteti të mos vërehet gjithaq si te romanët e tjerë. Për ta kuptuar këtë gjë, lexuesi do të vërejë kontrastin e madh të dy personazheve të përshkruar hollësisht, madje deri në detaje të imta, atë të Adnanit, si protagonist kryesor i romanit, dhe të Kiu Korroziut, kryetarit të kooperativës i cili si oportunist s’do ta bëjë transformimin e kooperativës së fshatit, që është një nga diogramet ku shkrimtari merret me ideologjizimin e personazheve. Të parin, personazh pozitiv, dhe të dytin, personazh negativ, shkrimtari i përshkruan si dy pole të kundërta në të gjitha aspektet. Gjatë përshkrimit të ngjarjeve dhe të gjuhës së folur të personazheve, autori gjithnjë mjeshhtër i rrëfimit, bën që interesi i lexuesit të mos humb asnjëherë kureshtjen. Ai shquhet edhe si skalitës i detajit, bie fjala, motivi i “luftës” së Adnanit me traktorin, i cili në fund edhe do të kallet, është shembulli i modelimit të të ashtuquajturit hero i punës, i njohur në kohë të komunizmit. Andaj kur i lexon faqet e këtilla, lexuesi sikur don t’i besojë kësaj utopie.

Në qendër të rrëfimit shkrimtari skalit motivin e dashurisë së dy të rinjve, Adnanit me Shpresën. Gdhendës i gjithanshëm i psikologjisë së personazheve të tij, J. Xoxa krijon personazhe të skalitura mirë dhe të motivuar thellësisht në planin psikologjik, kurse ndonjë prej tyre, siç është p.sh. Shpresa Shpiragaj, megjithatë mbetet e pasqaruar deri në fund. Shpresa duke qenë protagonist, e gjetur mes dashurisë për Yllin, të cilin e merr zjarri i traktorit, ajo mbetet e pasqaruar, e mjegullt në roman. Romani, ndërkaq, si edhe çdo vepër tjetër e J. Xoxës, lexuesit i kënaq storiet e rrëfyer nga shkrimtari, temën e trajtuar artistikisht dhe me mjeshtri, sidomos me skalitjen psikologjike të botës së brendshme të personazheve, një dhunti e talentit të shkrimtarit tonë. Jakov Xoxa vdiq në vitin 1979.

Franc Kafka

“METAMORFOZA” OSE HAKMARRJA NDAJ BABAIT

“Metamorfoza” është një sulm personal i Kafkës ndaj vrazhdësisë së babait të tij. Është gjithashtu një sulm, ndoshta i pavetëdijshëm, mbi dashurinë familjare; është një goditje e egër ndaj tempullit të familjes dhe marrëdhënieve bir-baba, bir-nënë, vëlla-motër



Rezart PALLUQI

Unë e admiroj Franc Kafkën për novelën e tij të famshme, “Procesi”. Veçse ky admirim m’u zbeh menjëherë sapo lexova novelën e tij “Metamorfoza”. Kjo novelë i ka shërbyer më së miri misionit të “Princërve të Errësirës” në agjendën e të cilëve gjendet me shkronja të arta qëllimi për të shkatërruar familjen, besimin fetar, dashurinë e njeriut për token ku u lind e deri tek zhveshja e njeriut prej çdo prone private. Franc Kafka vjen prej një familje të shkatërruar. Këtë na e pohon edhe vetë Kafka, kryesisht prej letrave, adresuar babait të tij. Unë ndjej keqardhje për Kafkën dhe çdo shkrimtar apo njeri mbi këtë Tokë që lind dhe rritet në gjirin familjar pa dashuri. E kuptoj gjithashtu edhe faktin që artistët, e në këtë rast, shkrimtarët e llojit të Kafkës, nuk mund ta shmangin zymtësinë/errësirën e dëndur në veprat e tyre letrare. Nëse kraharorin e ke të zbrazur prej dashurisë, edhe veprën, të paktën në aspektin humanitar, do ta kesh boshe. Njohim mijëra shkrimtarë që arrijnë të ndërtojnë romane me strukturë të mahnitshme, mirëpo me shpirt të shtrydhur, me personazhe pa karakter, pa vizion, puthadorës, të paaftë për të përqafuar dritën dhe gëzuar lirinë. Të tillë i hasim kudo, madje edhe në novelat e romanet e I. Kadaresë. Personalisht mendoj, se shkrimtarë të tillë janë të dështuar jo vetëm në rrafshin njerëzor, por edhe në krijimin e letërsisë së kompletuar. Veprat e tyre nuk mund të përfaqësojnë kursesi sjelljen, karakterin e masës dërrmuese të njerëzve mbi tokë. Jo e jo, që nuk mund të shpallen kryevepra. Kryevepra nuk qëndron në këmbë pa dashuri, ashtu siç edhe një kështjellë me arkitekturë fenomenale nuk mund të jetë

e plotësuar nëse në të jetojnë njerëz të liq. Sipas gjykimit tim, “Metamorfoza” është një sulm personal i Kafkës ndaj vrazhdësisë së babait të tij. Është gjithashtu një sulm, ndoshta i pavetëdijshëm, mbi dashurinë familjare; është një goditje e egër ndaj tempullit të familjes dhe marrëdhënieve bir-baba, bir-nënë, vëlla-motër. Fati i Gregorit përbën fatin e ndoshta 0,1% të bijve në familjen njerëzore. Cili baba do të reagoonte aq egër dhe aq pa shpirt ndaj birit të tij, sepse ky i fundit mbeti i papunë, e papritur u shndërrua në një insekt trupmadh? Cila nënë dhe motër do t’i kthente kurizin të birit të saj, ta linte atë të ngordhte si qen, për arsytet e lartpërmendura? Aq më tepër po të marrim parasysh sjelljen e plogët, pasive, tepër paqësore të Gregorit. Praktika e vërtetë e jetës na ka dëshmuar tërësisht të kundërtën; në raste të tilla njeriu i vjen në ndihmë bashkë-njeriut edhe më shumë. Kafka dhe çdo Kafkë i shquar, mund ta shmangte/ shmangë, fare lehtë këtë kurth fatal, përndryshe kemi të bëjmë me një novelë dështake, si vetë autori. Dikush mund të thotë se shkrimtari mund të shkojë shumë larg me fantazinë e tij? Jo, e kanë shumë gabim. Shkrimtari nuk mund të rrënojë dritën më të bukur që ekziston në botë, dritën familjare me pretekstin e lirisë artistike. Drita shkëlqen në miliona ngjyra vezulluese vetëm në mjedisin familjar, teksa nëna ushqen foshnjën me qumështin e bekuar, teksa nëna apo babai mëson fëmijën të hedhë hapat e parë, e kështu mund t’ju jap mijëra shembuj të tjerë magjikë. Në jetën e vërtetë, “Ligësia” në gjirin familjar gjithnjë e humbet betejën ndaj dritës, duke përjashtuar një përqindje fare të vogël njerëzish, si në rastin e Kafkës, i cili dështoi si në jetë si në letërsi të mbrojtë dashurinë njerëzore.

Çdo të mendojë një student nëse lexon “Metamorfozën”? E aq më keq se përpara se ta lexojë do të ketë parasysh se ka të bëjë me një kryevepër? Në nënvetëdijen e tij do të ruajë dritën më të zezë njerëzore që u gjend në trurin/zemrën e babait, nënës , motrës së Gregorit. E kjo dritë e zezë do të ndikojë më vonë negativisht në marrëdhëniet e tij ndërnjerëzore. Mbrapa Gregorit, sipas mendimit tim, fshihet vetë Franc Kafka. Njëpërmjet tij ai hakmerret kryesisht ndaj babait duke e ekspozuar atë në ekranin e skëterrës. Është e drejta e tij ta bëjë këtë. Veçse do të kish bërë mirë që novelën ta kish titulluar “Metamorfoza shpirtërore e Franc Kafkës”. Personazhin kryesor do të duhej ta kish emëruar “Franc” dhe jo Gregor. Kjo do të na kish ndihmuar që tempullin më të shenjtë, “Familjen” të mos e identifikonim në nënvetëdijen tonë me familjen kafshërore të Franc Kafkës. E rrjedhimisht, kjo dramë do të përfaqësonte jetën personale të tij. Ose në rastin më fatlum, Kafka duhej të na kish shpjeguar arsytet psikologjike të egërsisë që tregon e tërë familja ndaj fatkeqësisë së Gregorit. Po ta kish bërë këtë, ajo familje do të rezulonte plotësisht e sëmurë shpirtërisht dhe mendërisht, ndaj edhe një herë do ta gjykonim këtë histori barbare, si një ngjarje të izoluar, e jo siç ka ndodhur mbasi ky libër u botua, ku kritika, kryesisht ajo në Perëndim, tenton të na bindë se njeriu është aq i lig saqë në situata të caktuara kryen krime brenda-familjare, për shkaqe tejet banale, siç i ndeshim në novelë. Për fat të keq Franc Kafka dështoi ta mundte errësirën me dritë. Ai iu hakmor errësirës personale me errësirë, e këtë e vërejmë edhe në ditët e sotme në djepin e popullit të Izraelit, të cilët, sot ndjehen edhe më të palumtur se ç’ishin në vitet 1940 në kampet hitlerike, paçka se SOT ata zotërojnë atdhe, flamur, liri dhe begati

të pamatë. Pa dyshim që “princërit e errësirës” e kanë përkrahur mbrapa perdeve pafundësisht këtë novelë e shumë novela të tjera të ngjashme me të, siç është edhe “I huaji” i Kamysë, ku personazhi, edhe pse siç na e skicon Kamyja, njeri normal, çuditërisht, nuk shpreh asnjë grimë keqardhje për vdekjen e nënës së tij. Ai ishte ky personazh ndoshta modeli i parë i “Njeriut të ri” të shekullit të njëzet e një? Siç e thashë në fillim të kësaj analize, “Princërit e errësirës” kanë të paktën dyqind vjet që punojnë për të mbytur dritën e shpirtit njerëzor me errësirën e tyre. Është ai pesë përqindëshi që zotëron nëntëdhjetë e pesë për qind të pasurisë materiale botërore. Ky pesë përqindësh ama, e di fort mirë, se njeriu shtyhet drejt errësirës vetëm nëse i shkatërron së pari familjen, e më pas i heq llokmën e bukës. “Metamorfoza” e Franc Kafkës është një dramë personale, ndaj dhe duhet e parë si e tillë. Mirëpo, edhe nëse e pranojmë si të tillë, ligësia që ai shfaq ndaj babait të tij i kalon çdo kufi. E them këtë, nëse do të bazoheshim në të dhënat që Kafka na jep për babain nëpërmjet letrave për të. Familja e Kafkës, sado e ligë të ketë qenë ndaj tij, ajo nuk e ka merituar këtë hakmarrje gati-gati të paprecedentë. Po, e përsëris, këtë e bazoj në letrat e Kafkës, e nëse ai na ka fshehur një pjesë të dramës së tij familjare, atëherë çështja mund të ndryshonte disi, gjithsesi, novela në fjalë, nuk do ta justifikonte kursesi fundin e saj përbindshëror, përveçse ajo do të luhej në hapësirën e ndonjë psikiatrie të madhe, ose do të kishim të bënim me konflikte serioze trashëgimie pasurish apo shuma marramendëse të hollash ndërmjet: babë-bir, nënë-bir, -motër- vëlla, e një gjë të tillë nuk e hasim në novelë.

Në proces

PËSHPËRIMË TRISHTIMI NJERËZOR

Poezia e Mirela Papuçiu nuk është esklamative, s'ka britma, përbetime dhe figura e trope të papritura, por vjen me një natyrshmëri të habitshme

Vaid HYZOTI

Gjendja është trishtuese sot për poezinë. Ka më shumë “poetë” se lexues. Libraritë, ose nuk pranojnë, ose hezitojnë gjatë të marrin nga autorët apo nga botuesit libra me poezi. Mbase, atë që duhet ta bëjnë shumë botues, tashme rreken ta kryejnë librarët, që jetojnë me libërshitjen. Dhe, duket se kjo gjendje do vazhdojë gjatë, edhe pse ligjet favorizojnë botues të shumtë, që nxisin sasinë dhe jo cilësinë. Kritika letrare thuhet se është shuar. Dhe kur dikush mund të marrë “guximin” të shkruajë dhe të vlerësojë një vepër, duke u munduar ta peshojë artistikisht nivelin, has në një mur. Krijues që botojnë shumë e shumë vepra, ndërkohë që ende s’po mbërrijnë qoftë dhe në një poezi të vetme cilësore, bëjnë promovime madhështore dhe falin libra, të cilët më të shumtat harrohen në karriget e koktejeve të rastit... Dhe harrohen “si padashje” krijuesit cilësor, që do t’i bënin nder dhe një lexuesi e pasionanti të poezisë, por dhe vetë botuesve dhe vetë librarive...

Një ndër këto të fundit, mendoj se është dhe Mirela Papuçiu, që për çudinë time vjen me përmbledhjen e parë poetike. Them për çudi, sepse ka vite që lexoj poezi të saj dhe di që para dy-tri vitesh i thashë në një mesazh të me niste ndonjë libër të fundit. Më tha: ende nuk kam shkruar të parin!

Nëse duhej të jepja shkurtazi një biografi artistike të plotë të Mirelës do e kisha fare të vështirë. Ndonëse mike në rrjetet sociale, e pranuar me ndërhyrjen e një shkrimtari të respektuar nga Tirana, që është dhe miku im, di të them që është mësuese dhe drejtuese e një shkolle artistike jopublike në Fier dhe nuk e di a ka mbaruar për violinë apo frëngjisht, ndonëse ajo flet dy-tre gjuhë të huaja (s’jam i sigurtë), por në botimet e Shtëpisë botuese emërmirë “Buzuku” në Prishtinë është botuar përmbledhja poetike



“Voltaiket”, përkthyer nga ajo...

Para një kohe më nisi një email dhe më tha se donte ta botonte një libër. Më në fundi ia kishte mbushur mendjen vetes të shfaqej më e plotë! Siç thotë dhe në njërën nga poezitë “...veten e njohim shumë vonë”. Tani e kam librin e plotë të përgatitur për botim, por ajo më thotë: “... dua të më japësh një mendim të singertë”. Në të vërtetë mendimin për të dua t’ia servir lexuesve (atyre të vërtetëve), botuesve, librarëve dhe studiuesve të letërsisë e kryesisht poezisë. Mbase, se kam bindje që për krijime të tilla duhet “të grinden” botuesit, duhet të ngulmojnë kush e kush ta botojë i pari dhe në librari ta presin siç e meriton. Cilat janë, sipas meje, disa nga vlerat

kryesore të poezisë së Papuçiut, që unë ka disa vite që e komentoj dhe e ndjek. Do ishte fjala më e përgjithshme ta cilësosh “e veçantë”, ndonëse ajo është e tillë, falë mençurisë dhe ndjenjës, gërshetimit të tyre. Ndjenja, çasti, vështrimi metaforik, përjetimi janë poezia e të gjithë kohëve. Poezia e saj nuk është esklamative, s’ka britma, përbetime dhe figura e trope të papritura, por vjen me një natyrshmëri të habitshme. Emëruesi i të gjithë poezive është meditimi. Mirela flet me vete, thotë ato që përjeton çdo ditë, mat me pëllëmbët e mendjes dhe «ia tregon” vetes me një pëshpërimë trishtimi të ndritshëm, nganjëherë me melankoli, ngaherë si një fjalë aksiome, që s’mund të jetë ndryshe në filozofinë poetike.

Tematika është përditshmëria. Nisur nga familja, plagët sociale, kujtimet dhe ringjallja e tyre, një mall, një plagë dhe atë trishtim e dhimbje di ta përcjellë të metaforizuar. “Unë nënën e kam qarë të gjallë”, dy poezi si elegji “të fshehura” për vëllain që iku në parajsë në një 6 shtator, ku dhimbje nuk jepet me ofshamë, por me vargjet që 6 shtatori t’i lind dhe ne vdesim! Mund të vazhdonim me plot poezi të citonim, por cikli prej shumë poezive i temave sociale, i ftohjes së dashurisë në familje, ku bashkëjetohet pas të njëjtit mur, i metaforizuar si “muri i lotëve” ngritur nga ftohtësia dhe harruar për një derë të dalësh në kopsht, poezia “Litarë shiu” e të tjera janë aq të befta e të bukura në gjetje. Dhe është tepër e trishtë dhe ngjethëse gjetja se “...dhe luleve të vyshkura kërkojnë ujin/ si njeriu iluzionin”..., apo vargu fantastik drejtuar te dashuritë: Gjej pak kohë të më veshësh nuse...

Lidhja me familjen, nënën e babain, gjyshen dhe fëmijët, gjejnë vend në krijimet e saj si tek të gjithë lirikët e botës. Te poezia “Më bëjnë veshët” kemi një enumeracion metaforash antitezike për gjendjen e trishtë kur fëmijët rriten e dalin vetë në jetë dhe shtëpia ngjan e zbrazët.... Shembuj të tillë dhe më të bukur do kenin shumë në librin që autorja bën gati për botim.

Gjithnjë duhet kuptuar se poezia nuk është autobiografi, por është vëzhgim dhe përjetim në të përditshmen njerëzore. Se poeti i vërtetë është një gjethe në pemën e jetës që ndjen çdo fladë e stuhi dhe i jep zërin e tij. Te gjitha poezitë janë shkruar me varg të lirë. Madje, dhe rima kurrë s’është qëllim në vetvete. Këtu po rikthehem në “biografinë” që përmenda më lart, se autorja është dhe violiniste dhe e ndjen mirë ritmin dhe kadencat ritmike. Është e vështirë që në të gjitha krijimet të mos ruhet ritmi dhe kjo e bën poezinë e MIRELA PAPUÇIUT dhe më të vler të!

Vështrim

RRETH MOTIVEVE DHE TEMATIKAVE NË POEZINË E AGIM DEVËS

Poezia e tij përfaqëson një vokacion të veçantë lirizmi, ku gërshetohen ndjeshmëria personale me dhimbjet dhe aspiratat drejt lirisë të populli të Kosovës

Khahid BUSHATI

Agim Deva (06. 04. 1948 - 01. 02. 2009) është një ndër poetët më të rëndësishëm të letërsisë shqipe për fëmijë e të rinj. Mendoj, që është i pari poet që në gjininë e poezisë për fëmijë futi me guxim dhe sukses elementet e modernes (në kuptimin e mirë të fjalës). Poezia e tij përfaqëson një vokacion të veçantë lirizmi, ku gërshetohen ndjeshmëria personale me dhimbjet dhe aspiratat drejt lirisë të populli të Kosovës. Mbeti, pothuajse, besnik i poezisë. E dashuroi me zemër, dhe i fali zemrën. ATDHEU DHE DASHURIA PËR TOKËN AMTARE: Është një nga motivet më të fuqishme që përshkon poezinë e Agimit, dhe kjo është: Dashuria për Kosovën. Poezitë, në të shumtën e rasteve, janë

himne për vendlindjen, për tokën që i ka dhënë gjithçka, por edhe për tokën e vuajtjeve dhe të plagëve historike. Poezitë e Agimit, shpesh, kthehen në elegji për trojet shqiptare të pushtuara nën thundrën e padrejtësive historike.

NJERIU DHE VUAJTJA KOLEKTIVE: Në poezinë e Devës, individ i nuk jeton i shkëputur nga shoqëria. Ai është pjesë e dhimbjes kolektive, e fatit të kombit, e dramës së përbashkët që përjetohet nga populli i tij. Figura e nënës, fëmijës, luftëtarit e mësuesit shfaqen si simbole të një populli që përpigjet të mbijetojë. LIRIZMI PERSONAL DHE NDJESHMËRIA INTIME: Krahas motiveve atdhetare, një tjetër tipar i veçantë i poezisë së Agim Devës është lirizmi i ndjerë personal. Ai shkruan për dashurinë, për humbjet personale, por nostalgjinë dhe për ndjenjat njerëzore në mënyrë të natyrshme dhe të

singertë.

HISTORIA DHE QËNDRESA: Deva, shpesh, i rikthehet historisë së popullit shqiptar, duke e përzier atë me aktualitetin politik dhe shoqëror të kohës së tij. Qëndresa heroike e brezave, sakrificat për liri dhe dinjitet kombëtar janë themele të rëndësishme të poezisë së tij.

GPUHA E PASUR FIGURATIVE: Poezia e Devës është e mbushur me metafora, simbole dhe imazhe poetike. Ai di të krijojë tablo të gjalla, duke përdorur gjuhë të pastër shqipe dhe një stil të përpunuar lirike-epik.

NDËRTIM KLASIK DHE MODERN NJËKOHËSISHT: Në vargjet e tij vërehet një ndërthurje mes traditës klasike poetike shqiptare dhe prirjeve moderne. Respekton strukturën klasike të vargut, por nuk nguron të eksperimentojë me formën dhe ritmin.

POEZI ME TON SOLEMN DHE SHPESH ELEGJIAK: Shumica e poezive të tij kanë një ton solemn, meditativ dhe shpeshherë elegjiak. Përdor me mjeshtëri kontrastin ndërmjet bukurisë së vendlindjes dhe dhimbjes për të, duke e kthyer poezinë në një akt dëshmie dhe përkujtimi. FIGURA E NËNËS DHE E GRUAS SI MOTIVE QENDRORE: Në shumë poezi, figura e nënës shfaqet si simbol i qëndresës, dashurisë dhe dhembshurisë për atdheun. Po ashtu, figura e gruas është e pranishme si bashkudhëtare në rrugën e mundimeve dhe aspiratave kombëtare. Në përfundim themi se, krijimtaria poetike e Agim Devës është një ndërthurje mes lirizmit personal, atdhedashurisë, kujtesës historike dhe qëndresës morale. Mbetet Poet i NDJESHMËRISË NJERËZORE.

Poezi: Musine KOKALARI

TI

Shpesh herë mendoresh,
pyet vehten t'ënde dhe e do,
jo, më vonë e urren deri në vdekje.

Vjen prandvera, çelin lulet, këndojnë zogjtë,
çdo gjë në lëvizje,
gjallni, hijeshi; zemra jote vajton
kohën e kaluar dhe kot harxhuar.

Shpejt kalojnë ditët në gëzim,
rinia e stolisur bukur,
me gas në zëmër,
plot shpresë bredhin fushat,
kërkojnë ëmbëlsirën e natyrës,
ti ri e vetëm,
qan vehten t'ënde e do dhe s'e do;
nuk di se ç'të zgjedhësh.

Vjen vera,
dielli i nxehtë djeg lulet e njoma.
Njerëzia mërztet,
largohej, ikën në male,
katunde dhe buzëdete,
që të thithin ajër të pastër
dhe ja vetja t'ënde e shtypur dhe e brengosur.

Kalon koha ngadalë,
natyra zhvishet prej asaj bukurie të pa treguar,
lehtas gjethet bien në tokë,
era freskuese kthehet në të ftofët
dhe qielli errësohet.
Pikat e shiut bien prej së nalti.
Fillon koha e punës,
hapen shkollat,
nisin mësimet dhe mërztitja.
Nënqeshja fillon
në buzët e tua të ndriçojë,
knaqsia në zëmër ndihet
dhe sytë ëmbëlsisht i drejtohen qiellit.

Shtrëngatat buçasin
në qiellin e vrërët,
shiu bie me tufan,
malet gjëmojnë,
deti oshtin egërsisht,
ja ti ndjen një lehtësim në zemër.
I afrohesh xhamit
dhe shikon jashtë... qesh.
Oh jo, nuk do dhe nuk beson,
syt e tua vështrojnë më larg, më thellë,
ata që vuajnë dhe janë pa strehë...

Ja ti përsëri,
në çastin kur qeshe,
një dëshpërim ngjati në zëmrën tënde
dhe e para fiket dhe e dyta sundon.
Ajo është për ty, ajo të përqafton dhe s'të lë rehat,
ajo të skllavëron... shpesh herë mendoresh;
pyet vehten t'ënde dhe e do,
jo, më vonë e urren deri në vdekje...

T'ISHA NJË LULE...

T'isha një lule-lule arë, e vogël dhe me erë.
Të çelnja në prandverë
dhe në vjeshtë të vishkesha në vetminë t'ime.

T'isha një lule vjollce në mes të ferrave.
Të qëndroja e fshehur, e pa dukur
dhe një ditë të zbulohesha prej duarve të dy të rinjve.

Prej frike,
të larguar prej njerzisë do t'më këputnin,
do të dhurohesha te njëri-tjetri
për shënjë kujtimi.

Do të ndëgjonia se ç'flitnin, fjalët e bukura dhe plot shpresë.

Do të më thurnin dhe mua
disa vargje të lehta
pë hir të dashurisë.

Një trëndafil i egër të mbinja
për mbi varrin e ndonjë të riut.
Të mirrnja pjesë në lotët
që do të derdhnin mbi atë tokë të ftohët.

Karafil i kuq të lulzoja
dhe me kujdes të vaditesha...
një ditë të vendossha në jakën e palltos.

Do të shëtitnja dhe unë rrugët e qytetit,
do të kuptonja jetën djaloshare
dhe të gjithë do të vështronin atë dhe mua;
që të dy qenkan të bukur, do të thoshin.

Më së fundi le t'isha
së paku një lule e egër,
midis rrugës dhe gurëve,
pa kujdesin e të tjerëve.

Një ditë do të shtypesha prej ndonjë këmbë njeriu,
burrë ose grua... e di, por s'ka gjë,
një lule isha dhe jo njeri...

NJË MELODI

Një melodi... së largu ndëgjohet;
ngadalë afrohet
dhe përsëri largohet... sh

Thellë kumbon n'errësirën e natës,
kthjellët përshkon rrugët e qytetit
dhe lirisht përhapet kudo,
asgjë s'e pengon dhe ajo ëmbël ndëgjohet...

Zëra te përbashkëta këndojnë dhe këmbë të çrregullta ecin,
të gjithë drejtohen atje ku nuk dinë as vetë,
duan kënaqësi. Yjtë e shkëlqyer kërcejnë në qiellin pafundshëm,
hëna e plotë krenarisht lëviz,
Oku tregon rrugën atyre dhe ata vazhdojnë, ata këndojnë

Erë e lehtë fryn,
freskon fytyrat e kuqura prej gazit
dhe ata vazhdojnë të këndojnë
dhe kjo melodi ndëgjohet kudo.

Goditjet e orës lajmërojnë çastet e kaluara
në dëfrim të shkuara,
por ata prapë vazhdojnë.
Asgjë s'i pengon, asnjëri s'iu thotë pse,
dhe ata shijojnë lirinë e natës,
shfrehin dufin e zemrës
dhe kënaqen që të gjithë...
ata që këndojnë, ata që ndëgjojnë...

Janë të rinj dhe duan të shikojnë kohën e tyre dhe prandaj këndojnë.

Orët e shumta, të shkurtra për ata, kaluan,
është vonë, thërresin
duhet të shkojnë dhe për herën e fundit le t këndojmë.
Plot jetë e gjallëri,
plot dhembje e shpresë dhe siguri...

Për disa orë harrojnë jetën e ditës,
punën e lodhshme,
dyqanet e errët,
tryezat plot pluhur,
dhomat pa diell, bango të mërztishme, zëra t'egra...
dhe ata këndojnë dhe një melodi ndëgjohet.

Vazhdon rrugën,
japin dorën njëri-tjetrit,
të gjithë shpërndahen nëpër rrugë të ndryshme
dhe në çastin e fundit, të gjithë thonë përsëri
dhe të gjithë qeshin me kënaqsi...

Rrugët e qeta mbetin të shkreta.
Yjtë vazhdojnë të kërcejnë,
hëna krenarisht ndriçon ata pa dobi,
asnjë zë nuk pipëtin...
kudo heshtja mbretëron...

Një melodi... së largu ndëgjohet,
ngadalë afrohej
dhe përsëri langohej...



Tregim/ Dori CAMAJ

KTHIMI



Ishte ora diku tre e pasdites. Zheg, gjinkallat zukatnin secila më fort se shoqja. I zhytur në pellgun e djersës nga gjumi i drekës, në ëndërr, këmbëzbathur, çapitej shkëmbinjve teh thike.

Një ventilator i vjetër dihaste si një plak i motshëm duhanpirës, që kolla ja nxjerr frymën me fërshëllimë.

Telefoni cingëroi vetëm një herë, aq sa për t'ia ndalur atë dhimbje të kobshme maj thikave të shkëmbit....

Sy zgurdulluar, sheh menjëherë ekranin...-Oh,nana jeme!

Thërret në telefon mbrapsht, dhe pas receptorit, një zë gjysmë i fikur... Ishte i ati, -nana jote duhet me u shtruar në spital, mjeku ka than se veç operacioni munet me e pshtue prej dhimës tri dekadash...

E mbylli telefonin pa thënë asnjë fjalë, u ngrit nga shtrati, e ashtu zvarrë, u tërhoq deri në tryezën e ngrënies pranë dritares. Mbështeti bërrylat mbi dërrasë, e vuri fytyrën mbi shputa....

Iu desh diku te njëzet minuta të kthjellohej, e më pas vetëm një dush me ujë të ftohtë, mund ta sillte me këmbë në tokë.

Me ujin që i rridhte qafës e majave të flokëve, nxori nga rafti një valixhe të vogël. Futi brenda saj ç'i zunë duart, ndërresa e çorape. Nga komodina mori pasaportën e pluhurosuar, e fshiu me gishtërinj dhe u ndal duke e

shikuar për një moment....Kish vite pa e përdorur...-Ahh, shqiptar!

E vendosi në xhepin e pasmë të pantallonave, zbriti furishëm shkallëve dhe u nis...

As vetë nuk e dinte a do mund të fluturonte, a kish fluturim, e megjithatë u nis drejt aeroportit.

Rruga iu duk një jetë, edhe pse banonte vetëm një orë larg prej tij. Zbriti nga treni dhe fillon të këqyrte tabelën, ekranin e nisjeve...

Avioni i fundit për në Tiranë sapo qe nisur.

-E marrtë djalli, iku....dhe duart filluan ti nxeheshin e t'i djersiteshin si dy lëmshe zjarri.

Fluturimi tjetër ish pas tetë orëve.

-Do pres, edhe sikur tetë javë të jetë...

U afrua pranë sportelit të agjensisë dhe pyeti për një biletë...

-Katërqind e shtatëdhjetë euro zotëri! Nuk besoj se ju leverdis...

Ngriti kokën me sytë gjysmë të ulur dhe dhimbshëm buzëqeshi, - edhe sikur katërmijë të kushtojë, do e blej...

E vendosi biletën mes dokumenteve dhe zuri një vend te bari jashtë aeroportit, te zona e duhanpirësve.

Kish gjithë kohën e botës për t'u menduar, e assesi s'mund t'i shpëtonte kujtimeve të fëmijërisë...

I erdhi ndërmend, kur darkave të vona, babai e mbyllte derën me çelës, si dënim që ish vonuar jashtë

me shokët, e nëna, ashtu e butë si mëndafshi, i hapte derën e pasme, për të mos e lënë jashtë.

-Lum nana për ty, ardhsh i bardhë e Zoti t'ruejt, shkamb i ki kryet djali i nans....

Rrufiste kafën e cigarja i avullonte ndër gishta....

Iu kujtua kur në shtëpi vinin mysafir, fëmijë shumë...Nëna i vinte në gjumë edhe pa ngrënë, duhej sajdisur mysafiri me ç'të kishin, e për fëmijët s'mbetej gjë. Diku nga mesnata, nëna i shkonte te shtrati me një rub të mbështjellë në xhepin e përparës.

Dy kafshata mish, e një copë djathë.

-Ha diçka i vogli nans, se s'merr gjumi prej unie....

Brenda kafes u rrokullis një pik loti.

Nëna as vetë s'hante kurrë, pa ua ndarë sa të mundej....

Një vit pasi qe larguar prej mëmëdheut, i kish ardhur një mik i vjetër ta takonte. -Takova prindët e tu parë se me u nis, e duarsh i zgjati një pako të ngjitur dhjetëra herë për të mos u hapur.

Nëna i kish punuar me shtiza, një pulovër të trashë, me në mes shqiponjën dykrenare...Në mes, një copë letër...-Mbasi kraht e nanës s'munen me t'rrok kur ban dimën, kjo bluze ka me t'nxeh diqysh....

Edhe një pikë loti u zhyt zillëkut të kafes, e cigarja zverdhni gishtërinjtë....

Psherëtiu thershtëm,- oh e mira ime.... Kështu mes kujtimesh ora fluturoi.

Katër vite pa shkelur atdheun...katër. Në aeroport nuk e priste askush, nuk e dinin që do vinte, ndaj mori një taksi e u nis për në shtëpi.

Porta e madhe e oborrit iu duk aq e vogël....Nuk pa asgjë, vetëm ngjiti shkallët rrëmbimthi.

Hapi derën e brendshme dhe ngriu... Ishin aty, pjesa e mbetur e familjarëve në mëmëdhe, ama vetëm sytë e nënës nuk i gjente kërkund...

Pa i folur askujt, briti sa munda...-Lokeeee..

Shtëpia jehoi. Në dhomën ngjitur, nëna i pëshpëriti t'bijës...-erdh vakti me shkue, se m'klithi n'shpirt zani i djalit...

U përplas dyersh e iu hodh n'puthje e përqaftime...-Jam k'tu e shtrenjta jeme, nana jeme, fryma jeme....

Nëna u ngrit vrik n'këmbë, e shtrëngoi shpatullash dhe i nguli sytë tashmë pellg kulluar..

-Era jeme, sugari jem, a je burr?! -Pa ty jam askushi nan...

-E ti mua m'vune botën nan kamb shpirti jem...Jam djeg për ty, jam tret, jam e dekun e pa kallun, e tash qi t'pash edhe nji her, dhe n'deksha, bota asht e jernja....

Një film për autorin

ÇERÇIZ TOPULLI, PUSHKA QË NUK HESHTI PËR ATDHEUN

Kinostudio “Shqipëria e Re” realizoi në vitin 1979 filmin “Liri a vdekje” – një epike kinematografike që nuk shfaq vetëm historinë e një heroi, por ngre një monument për një brez të tërë luftëtarësh

Leonard Veizi

Një pasdite korriku, kur dielli qëndronte pingul mbi tokë ndërsa tymi i barutit ende errësonte qiellin, një trup luftëtari ra. Nuk kishte më pushkën në dorë, dhe duart i kishte nën pranga, por padyshim emrin e Shqipërisë e mbante në buzë. Nuk ishte vështirë të kuptohej se ishte një intrige dhe pabesi e madhe. Ishte 15 korrik 1915. Çerçiz Topulli, kapedani që nuk e njihte frikën, priti në gjoks plumbat e skuadrës së pushkatimit. Bashkë me të ishte dhe atdhetari tjetër, gazetari Muço Qulli. Aso kohe, Çerçizi ishte 35 vjeç dhe u ekzekutua në fushën e Shtoit në Shkodër nga forcat pushtuese malazeze, që kishin hyrë në territorin shqiptar. Historianët hedhin akuzat nga shovinistët grekë, që me armët e shovinistëve malazezë eliminuan kapedanin, çeta e të cilit vrau dheshpot Fotin e Korçës, si shenjë hakmarrje pasi qarqet greke vranë Papa Kristo Negovanin. Por zhurma e pushkës së tij nuk u fashit. U përhap nëpër histori si krismë që nuk resht së trokituri në ndërgjegjen kombëtare. Ai nuk ra thjesht nga një plumb, por u ngjit në lartësi, atje ku qëndrojnë vetëm ata që jetojnë për të gjithë. Ishte një prej atyre burrave që zgjodhi lirinë përpara jetës. Nga malet e Gjirokastrës, ku nisi betejën kundër osmanëve më 1907, e deri në përplasjet me trupat greke në Jug në vitet 1913-1914, Çerçiz Topulli ishte jo vetëm armë, por edhe vizion e zjarr që ndizte shpresën e një kombi të përçudnuar nga luftra që nuk mbaronin. Ishte më shumë se një luftëtar: ishte një ide që marshonte mbi male, një flamur i gjallë që nuk u përkul asnjëherë. Për të përjetësuar këtë jetë, këtë frymë dhe këtë simbol, Kinostudio “Shqipëria e Re” realizoi në vitin 1979 filmin “Liri a vdekje” – një epike kinematografike që nuk shfaq vetëm historinë e një heroi, por ngre një monument për një brez të tërë luftëtarësh. Rolin e Çerçiz Topullit e interpreton aktori Timo Flloko, i cili nuk e portretizon vetëm kapedanin, por bëhet njësh me të. Në çdo shikim të ngulët, në çdo rrudhë mendimi, në çdo britmë për liri, Flloko nuk aktron – ai jeton Çerçizin. Në ekran, zëri i tij jehoi: – “Erdhi ora jonë, o trima. Me besa-besën. Ua njoh të gjithëve trimërinë. E di që secilit i vlon gjaku për hakmarrje dhe dora nuk i dridhet. Por ne kemi vendosur që për binbashin të shkojë Hito Lekdushi me Bajram Prongjinë...” Janë fjalët e një njeriu që nuk njeh frikë, që udhëheq jo nga prapavija, por nga maja e frontit. Në një tjetër skenë, mes një rrethimi, komandanti armik, me flamur të bardhë, i ofron dorëzimin:



– “Kapedan Çerçiz Topulli! Hidhi armët ti dhe djemtë e tu. Nuk dua që të vriteni. Në emër të Allahut zotohem t’u fal jetën. Dhe Padishahu do të japë pozita për ty dhe për njerëzit e tu!” Por përgjigjja është aq e qartë sa heshtja e një mali: – “Largo taborët, Latif Aga, dhe lëri djemtë e mi të shkojnë. Ne nuk jepemi, se jemi bijtë e Skënderbeut që luftojmë gjer në orën e fundit. Shqiptari di të vdesë sipas zakonit – me nder për mëmëdhenë!” Pas kësaj, kapedani u kthye nga djemtë e çetës së tij dhe tha: – “Këtu bëhet luftë. E kjo luftë u takon burrave. Mbushni armët, o trima!” Filmi, me regji të Ibrahim Muçajt dhe Kristaq Mitros dhe me skenar të Vath Koreshit, është një poemë e gdhendur në celuloid, për një jetë të shndërruar në legjendë. Ai nuk tregon thjesht një radhitje ngjarjesh, por është një përjetim emocional – një kalvar burrërie, sakrifice dhe vendosmërie. Sepse Çerçiz Topulli nuk lindi për t’u

përkulur. Dhe kënga që u ngrit atë çast, kaloi gojë më gojë: Te Rapi në Mashkullorë, Foli Çerçizi me gojë, Turku këtej të mos shkojë, Se i kuq, i bëj me bojë, Mylazim largo taborë, Leri djemtë e mi të shkojnë. Çerçiz Topulli më thonë I lindur në Gjirokastrë më 1880, ai u rrit me jehonën e legjendave dhe u bë vetë një legjendë. Bashkë me të vëllanë, Bajo Topullin, organizoi çetat kryengritëse në Jug, vrau komandantin turk të Gjirokastrës më 1908 dhe i tregoi Perandorisë se shqiptarët nuk ishin më nënshtetas të saj, por zotër të tokës së vet. Pas shpalljes së Pavarësisë, kur shumë pushkë u ulën, ai nuk e hoqi dorën nga brezi me vezme e pisqollë. Luftoi kundër copëtimit të vendit nga fqinjët, mbrojti kufijtë e Jugut nga grekët, dhe pastaj vrapoi drejt Veriut,

ku shqiptarët po binin nën çizmen malazeze. Dhe atje, pranë fushës së Shtoit, përballë taborëve të armikut, ai u bë pjesë e dheut që e deshi me gjithë zemër. Por legjendat nuk mbyllen me plumb. Ato mbeten të hapura në rrëfime, në këngë, në filma, në flamuj që valëviten dhe në rrugë që mbajnë emrin e tyre. E tillë është edhe historia e Çerçiz Topullit. Pushka e tij heshti më 15 korrik 1915. Por fjala, ideali dhe guximi i tij nuk pushuan kurrë. Më 1937, eshtrat e tij u kthyen në Gjirokastrë – në qytetin ku nisi rruga dhe ku prehet sot, si një flamur i palosur në zemrën e Shqipërisë. Dhe kurdoherë që një brez i ri kërkon kuptimin e fjalës atdhe, le të dëgjojë zërin e Çerçizit, që nuk pranoi pozitë, nuk pranoi falje, por zgjodhi të jetojë në përjetësi me një fjalë të vetme: LIRI A VDEKJE!

Galeria e të veçantëve

ELYAR, POETI I DASHURISË DHE I LIRISË

Mali i Gramozit ngrihej hijerëndë e madhështor në sytë e poetit francez, mal që disa muaj më vonë, në gusht të 1949, do të përgjakej dhe me gjakun e ushtarëve shqiptarë. Në kthim të udhëtimit të tij edhe në Shqipëri, në qershor, mes të tjerave, ai do të shkruante dhe poezinë me titull Mali i Gramozit

Luan RAMA

Sapo kisha filluar studimet në vitin e parë të universitetit për gazetari, kur në bibliotekën kombëtare, duke kërkuar disa libra poetikë, të cilët më pëlqenin në veçanti, më ra në duar dhe një botim i “Pleiade” në frëngjisht me gjithë veprën e Paul Eluard (Pol Elyarit). Për herë të parë pas disa poezive të botuara në shqip, të gjitha të karakterit revolucionar e luftarak, po zbuloja tek ky poet i madh i Francës poezi të periudhës surrealistë, tepër sensuale, të thella dhe universale. Shumë prej tyre ishin ilustruar me disa skica të shkëlqyera të fotografit dhe artistit amerikan dhe mikut të tij, Man Ray, i cili jetonte atë kohë në Paris. Që atëherë, në sytë e mi Elyari kishte fituar dimensione të tjera dhe më shfaqej si figura më e madhe e poezisë franceze pas Rembosë, Bodlerit apo Apolinerit. Me Elyarin më afroi akoma më shumë botimi i vëllimit poetik “Duart e lira”, të përkthyer nga poetin ynë i shquar Dritëro Agolli dhe me një vështrim kritik në vend të parathënies. Dukej se Agolli e kishte ndër poetët e tij të preferuar, ashtu siç dhe ishte për poetët e asaj gjenerate. Ai e cilësonte atë një nga poetët më të mëdhenj, aq sa për epokën e tij surrealistë, ai shikonte anën më pozitive të shkollës së surrealizmit. „Pol Elyari i donte njerëzit me një dashuri të pakufishme, me një dashuri të shqetësuar, - shkruante Agolli, duke shoqëruar vargjet e Elyarit:

„O vëllezërit e mi të humbur!
Unë shkoj drejt jetës, unë kam pamje njeriu,
Që të vërtetoj se bota
Është bërë pas shtatit tim
Dhe unë s’jam vetëm,
Se mijra fytyra të mia shumojnë
Dritën time...”

Një pikëtakim tjetër me Elyarin, ishte ai i një viti më vonë, në marsin e vitin 1983, kur bashkë me miqtë e mi, regjisoren Khanfize Keko dhe skenaristin Kiço Blushi, shkonim për të prezantuar kinematografinë shqiptare në Paris. Në bisedat me shoqërueset tona të ministrisë së Kulturës, të cilat çuditërisht, që të dyja quheshin Marie-Claire, ne iu folëm aq shumë për Pol Elyar, sa që ato na çuan ta vizitonim shtëpinë e tij, diku në Saint Denis e që tashmë ishte kthyer në një shtëpi-muze. Ishte një muze modest, por mjaft simpatik, gjithnjë plot njerëz, ku spikasin fotografitë, dorëshkrimet e tij dhe ilustrimet e Picasso-s me pëllumbat e Pages. Edhe varri i tij në “Père Lachaise” ishte i paqte, gdhendur me vargje dhe i vendosur pranë monumenteve të ngritur për luftëtarët e Rezistencës franceze, të vrarë në kampet naziste të përqendrimit. Vizioni poetik i Elyarit ishte DASHURIA dhe LIRIA; liria që ai e shkruante me garmë të madhe në poezinë Liberté. Ishin humanizmi dhe paqja. Vargjet e tij J’ecris ton nom Liberté, (Shkruaj emrin tënd Liri), ishin vendosur dhe në hollin e madh të pallatit të Këshillit të Evropës, në Strasburg:



„Në fletoret e shkollës Mbi banka dhe pemët Mbi rërë dhe dëborë Shkruaj emrin tënd Liri!”...

Kur Elyari vdiq, Picasso, një ndër miqtë më të afërt, ishte tek koka e tij. Ishte viti 1952. Elyari ishte ndër figurat më të mëdha të intelektualëve përparimtarë francezë dhe evropianë. Eugène Grindel ishte emri i vërtetë i Paul Eluard. Ai u lind në vitin 1895, në Saint Denis, kryeqytetin mesjetar të Francës, i cili pas shekullit XII u zhvendos disa kilometra më tutje, në Paris, apo Lutece-in e vjetër. Ai u lind në një kohë kur ndërtohej kulla Eiffel. Që adoleshent u sëmur nga tuberkulozi, sëmundje kjo që do ta ndiqte gjithë jetën e tij. Shkrimet e para janë ato të viteve 1914 kur ishte në front dhe kur nga sanatoriumet pranë Davos në Zvicër, ai kishte njohur një ruse të bukur të quajtur Gala, apo Helena Diakonova. Ndoshta ishte dashuria dhe magjepsja pas kësaj vajze sensuale ajo që dhe e shtyu të bëhej poet dhe të hidhej në krahët e poezisë:

„Një genie e vetme bëri të shkrihet dëbora e pastër
Bëri të çelin lulet mbi lëndinë
Dhe dielli të shpërthejë.”

Në vitin 1917, në kulmin e luftës, ai u kthye vetëm për tre ditë pranë familjes që të mund të martohej dhe pastaj të

kthehej me urgjencë drejt frontit. Kështu filloi dhe një nga aventurat më të mëdha të dashurive të Pol Elyar: një himn i vërtetë poetik kushtuar dashurisë. Bashkë të dy, ata lexonin poezitë e Nerval, Baudelaire, Lautrémont apo Apollinaire. Pikërisht pas lufte, në vitet 1918-1919, ai u njoh me një brez të ri poetësh e artistësh të tjerë, mes të cilëve me André Breton, Louis Aragon, Philippe Soupault apo Tristan Tzara, të cilët do të lançojnë shkollat e para moderniste dhe avangardiste të fillimit të shekullit: Tzara që lançoi dadaizmin, (1916, ku Elyari ishte një nga pjesëtarët më aktivë) dhe Breton e Elyar që lançuan më pas surrealizmin, etj. Elyari e donte shumë pikturën edhe pse vetë nuk pikturonte. Ishte kjo ndjesi që e lidhi ngushtë me piktorin Max Ernst dhe gruan e tij. Gala ishte një grua intelektuale, me shumë kulturë e moderne. Ajo nuk e kishte për gjë të pozonte dhe nudo para Max-it, me të cilin shpejt do të binte në dashuri. Por, sidoqoftë Gala ishte një nga frymëzimet e mëdha të Elyarit, edhe pse ai e dinte se ajo e donte mikun e tij. Por dhe Elyari e çmonte shumë Max Ernst-in.

„Ajo është në këmbë mbi qepallat e mia
Dhe flokët e saj tek të miat janë
Ajo ka formën e duarve të mia
Ka ngjyrën e syve të mi
Ajo humbet në hijen time
Si një gur nëpër qiell”

Letrat e dashurisë që Elyari i dërgon Galas janë letra të bukura dhe një himn i vërtetë poetik, një kurnt i bukur, edhe pse do të ishte një udhëtim që do të ndërpritej. Ato fillojnë që në ditët e para të njohjes së tyre në malet alpine të Zvicrës, dhe vazhdojnë gjer në pragun e luftës. Më 16 janar, 1930, ai i shkruante: „Po çmendem nga dëshira. Po vdes nga ideja se do të takoj, se do të shoh dhe përqafoj. Dua që dora jote, goja jote, seksi yt, të mos e lënë seksin tim...Të shoh kudo. Të dua për vdekje. Gjithçka është e bukur te ty: sytë, goja, flokët e tua, seksi yt, duart e tua që nuk e lëshojnë më atë çka dridhet, atë hapësirë midis kofshëve të tua, supet e tua. Dehem kur mendoj çdo pjesë të trupit tënd...”

Më 15 prill, 1932, ai i shkruante sërish: „Së shpejti do të jemi bashkë dhe meqë s’kemi humbur shijen e njëri-tjetrit, ne do t’i gëzojmë qeniet tona. Ëndëroj gjinjtë e tua, sytë e tua, seksin tënd të mrekullueshëm...” Ajo ishte për të një copë qiell i shndritshëm, një diell përvëlues, ëndërr e nderur, erë apo shi i nxehtë... Letrat e tij të kujtojnë letrat sensuale të Apolinerit që u shkruante të dashurave të tij. Gala ishte gjithçka për të. Por dhe Elyari kishte dashuritë e tij kalimtare, siç ishte Alice, vajza e dramaturgut Carl Streheim, e cila meqë ishte shumë e bukur, ai e thërriste „Pomme” (Mollë). Por shpejt, ai filloi ta ndjejë veten të braktisur nga Gala, edhe pse ajo ishte gjëja më e çmuar e tij. Në vitin 1924, papritur ai u zhduk misteriozisht. Gala dhe miqtë e tij e kujtuan të vdekur diku, të humbur ashtu si gjysmë shekulli më parë, kur miqtë e Rembosë kishin kujtuar se ai kishte vdekur diku jashtë France, ndërkohë që Rembo ishte zhdukur mbi dhjetë vjet në brigjet e Arabisë, në Detin e Vdekur. Por Elyari ishte gjallë, edhe pse në Paris flitej se poeti kishte vrarë veten. Shtatë muaj ai udhëtoi rreth botës. Kjo ishte ikja e tij, udhëtimi i poetit për të parë botë të tjera dhe për të mpiksur plagët e tij. Në fund, ai u bë i gjallë. Gala dhe Max Ernst shkuan ta marrin larg në Singapor për ta sjellë në Francë. Elyari rikthehej...

Pak vite më vonë, në shoqërinë e tyre hyri piktori i ri Salvador Dali, miku i Federico Lorca-s. Ishte Gala ajo që do t’i thoshte Elyarit se tashmë ajo donte Dalinë e „çmendur”, edhe pse ishte dhjetë vjet më i vogël. I tha qetësisht se “martesa e tyre nuk kishte më vlerë”. Dali u vendos në shtëpinë e tyre dhe Elyar u detyrua të largohej miqësisht dhe pa zhurmë në apartamentin tjetër në Rue Fontaine, pranë sheshit Place Blanche. I sëmurë, i lodhur, dhe i vrarë nga kjo ndarje, Elyari shkruan poezitë e tij të dhimbjes dhe të melankolisë. Megjithatë, fotografinë nudo të Galas e mbante gjithnjë në kuletën e tij. Jo rrallë ai ua tregonte miqve të tij të afërt: Gala, me trupin e saj të bukur, lakuriq...

Revolucioni surrealist

Revolucioni rus, filozofia marksiste dhe lëvizja trockiste në atë kohë do të linin gjurmë në ndërgjegjen e intelektualëve dhe artistëve të rinj evropianë. Në



një atelie të Rue de Grenelle, një grup intelektualësh francezë do të shkruanin Manifestin e surrealizmit, i cili do të hapte një epokë më vete për artet e Europës së pas Luftës së Parë Botërore. Elyar, Breton dhe të tjerë fillojnë të botojnë revistën e njohur Revolucioni surrealist, ku ata shpalosin idetë e tyre novatore për artin, një art që shkëputej në mënyrë të zhurmshme nga tradita e mëparshme artistike. Bashkë me Bretonin dhe artistët e tjerë, ai donte të zbulonte subkoshiençën. Në këtë revistë do të botojnë veprat e tyre artistë që më pas do të hynin në historinë e artit botëror. Kur Elyari botoi numrin e parë të revistës Surrealizmi në shërbim të Revolucionit, bashkë me Bretonin, pikërisht atëherë ai gjeti dashurinë e tij të dytë, vajzën ezmere dhe simpatike Maria Benz, apo Nusch, siç do ta quante ai, për të cilën që në fillim ai do t’i shkruante Galas: “Meqë jam vetëm dhe i braktisur, nuk do të ishte keq që ajo të ishte gruaja ime”.

Megjithatë imazhi i Galas ishte gjithnjë e fuqishme në botën dhe imagjinatën poetike të tij: „Gruaja me të cilën kam jetuar/ Gruaja me të cilën jetoj/ gruaja me të cilën do jetoj/ Gjithnjë e njëjta/ Të duhet një pallto e kuqe/ Doreza të kuqe, një maskë e kuqe/ Dhe të mbathura të zeza/ Ja pse dua të të shoh lakuriq“ Aq shumë e donte ai Galan, saqë atë ditë, kur Gala dhe Salvador Dali ishin në Spanjë në shtëpinë e Dalisë, Elyari kishte shkuar në krevatin e saj dhe ishte hedhur me dënesa. Kishte qarë aq shumë sa menjëherë e kishte zënë një krizë astrme. Por megjithatë, shumë shpejt dhe Nusch do të hynte në zemrën e tij. Kjo vajzë nga Alsace, kishte qenë më parë akrobate e më pas

modele e Picasso-s apo Man Ray-it, por dalëngadalë ai do të ngrinte obeliskun e saj poetik: “Besim kristali/ Mes pasqyrash/ Natën sytë e tu humbën/ Për të pikëtakuar zgjimin e dëshirës...”

„Ajo vajzë që zbulova në përgjumje, - do të shkruante Elyar në librin e tij La Vie immediat, (Jeta menjëherë), - ishte si një yll i zi në harresën e ditës...i jepem, i dorëzohem realitetit të një pasqyre që nuk reflekton dukjen time. I dhënë pas dëshirave të saj. Më duket se jam prehë. Pa të djeshme, pa të nesërme. Kjo fytyrë e pastër, rifillon te unë. Gjithnjë, dita më e madhe e jetës time“. Ai fillon ta dashurojë, ta dashurojë shumë, duke i kërkuar dhe vajzës së tij, Cecile, që ta donte dhe ajo, siç i shkruante dhe në një letër: „Ti mund t’i shkruash një fjalë Nusch-it. Nëse më do, duaje dhe atë, pasi ajo ka qenë dhe është për mua një mbështetje e madhe. Pa të, jeta ime do të ishte e pamundur“. Gjatë epokës surrealiste, Elyari do të bëjë të tijën moton e poetit Lautremont, i cili thoshte se “poezia shkruhet në ekip”, pra me të tjerë. Kështu, bashkë me Benjamin Peret, ai shkroi 152 poezi dashurie; me Bretonin shkroi vëllimet poetike Au default du silence dhe L’immaculé conception; me René Char dhe Breton botoi vëllimin poetik Relentir travaux. Tani Elyari banonte në 54, Rue Legendre, pranë Place de Clichy. Ishte koha kur Hitleri kishte hipur në fuqi dhe kur qeveria franceze përzuri Trockin nga territori i saj. Më 1934, Elyari u martua me Nusch-in, edhe pse një ditë më parë ai i shkruante Galas: “Sidoqoftë, çdo natë mendoj për ty”.

Elyari nuk shkoi në Luftën e Spanjës, meqë ishte mjaft i sëmurë. Në fakt, kur zhvillohej Lufta Civile, Elyari priste të

shkonte në Brigadat Internacionale, siç e dëshmonte dhe një miku i tij i afërt, Louis Parrot, të cilit, Eyar i kishte shkruar: “Ëndërroj të nisem për tçu vënë në shërbim të spanjollëve republikanë. Kur do ta formojmë një „Legjion të huaj?...“ Edhe pse nuk arriti të shkonte, Elyari pohonte se „Lufta e tij më e mirë ishte në fushën e poezisë“...„Në Spanjë luhet fati i botës“, - shkruante ai. Dhe poeti kishte të drejtë, sepse pas Spanjës, fashizmi dhe nazizmi do ta kthenin botën në rrënojë, duke mbjellë vdekjen ngado.

Poeti i rezistencës

Pas vëllimeve të njohura poetike Capital de la Douleur, (Kryeqyteti i dhimbjes) dhe Mourir pour ne pas mourir, (Të vdesësh që të mos vdesësh), në vitet 30’ Elyari botoi dhe disa vëllime të tjera poetike, si Jeta menjëherë (1932), Trëndafili publik (1934), Sytë pjellorë dhe më 1938, vëllimin Kursi natyror, ku është dhe një nga poezitë e famshme të tij Fitorja e Guernica-s, (e frymëzuar nga tabloja me të njëjtën titull të Picasso-s). Kur Gjermania naziste sulmoi Francën, Elyar sapo ishte mobilizuar si leitnant dhe me kompaninë e tij u tërhoq drejt jugut, në Carcassone. Më pas, bashkë me Nusch ai erdhi në Paris. U vendosën në shtëpinë e nënës së tij në 35, Rue de la Chapelle dhe menjëherë u angazhua me “Frontin Kombëtar të Shkrimtarëve”. Shumë shpejt kërkoi të rifutej në Partinë Komuniste dhe drejtoi një revistë klandestine të titulluar L’Eternelle revue, (Revista e përgjetshme). Gjatë kësaj periudhe lufte, ai do të bëhej një nga poetët më të mëdhenj të Rezistencës franceze. Në mënyrë klandestine ai

arriti të botojë dhe vëllimin Poezia dhe e vërteta, e cila përfshinte dhe poemën e famshme Liria, të cilën avionët anglezë e shpërndanin nga qielli mbi fushat dhe malet e Francës: „Mbi imazhet e praruara/ Mbi armët e luftëtarëve/ Mbi kurorën e mbretërve/ Shkruaj emrin tënd Liri!“...“Mbi gjithë faqet e lexuara/ Mbi gjithë faqet e bardha/ Mbi gur, mbi gjak, mbi letër apo hi/ Shkruaj emrin tënd Liri!“

Dhe poezia Kurajo, (1942), ishte një nga më të njohurat e asaj kohe: “Parisi ka ftohtë, Parisi ka uri/ Parisi nuk ha më gështenja në rrugë... - shkruante ai dhe më pas vazhdonte: “Një rreze ndizet në venat tona/ Drita jonë rivjen/ Më të mirët mes nesh janë vrarë për ne/ Dhe ja ku gjaku i tyre rigjen zemrën tonë/ Dhe përsëri mëngjesi është një mëngjes parizian/ Është çasti i çlirimit/ Hapësira e pranverës që po lind“...

Çlirimi i Francës e gjeti Elyarin si një nga poetët më të dashur dhe më popullor të francezëve bashkë me Louis Aragon, mikun e ngushtë të tij. Të dy ishin të afërt me aventurën komuniste dhe internacionalizmin. Poema Liria ishte kthyer në një lloj himni ndërkombëtar dhe kishte pushtuar shpirtat e botës së etur për liri. Ai kishte qenë kronisti i dhimbjes dhe i kurajos. Kur Parisi u çlirua, Elyari shkroi:

„Në mes të muajit gusht ne harrojmë dimrin,
Siç harrojmë mirësjelljen e fitimtarëve,
Përshëndetjet e tyre të mjerimit dhe vdekjes,
Ne harrojmë dimrin siç harrojmë turpin,
Në mes të muajit gusht ne hamë municionet tona,
Me arsye, dhe arsyeja është urrejtja jonë...

Poeti i rezistencës ftohej ngado nëpër konferencat e botës. Më 28 nëntor të vitit 1946, gjatë një qëndrimi në Zvicër, një telefonatë e njoftoi për vdekjen e papritur të Nusch-it, gruas së tij, nga një „kongjestion pulmonar“. Ato ditë ajo kishte shkuar për të ndihmuar nënën e tij të sëmurë, pa e imagjinuar se po shkonte kaq papritur nga kjo botë. Plot dhimbje, ato ditë ai shkruante:

„Viti njëmijënëntëqindedyzetegjashtë
Ne nuk do të plakemi bashkë
Ja dhe një ditë më shumë: koha kaloi cakun e vet
Dashuria ime e lehtë ka marrë peshën e një lutjeje“...

Kjo vdekje e trishtoi aq shumë sa një moment ai mendoi të vriste dhe veten. Dukej sikur i kishte ndërprerë marrëdhëniet me botën e të gjallëve. Madje ai i kishte deklaruar Aragonit se “dëshpërimi mund t’i shkaktojë mohimin e poezisë”, pra të hiqte dorë nga poezia, ndërsa Man Ray-it i kishte shkruar: „Do të të shkruaj përsëri kur të filloj të ndjej dëshirën e jetës“. “Në trupin tim janë rrënojat e dashurisë dhe vdekja ime me petkun dhe jakën e përgjakur është“...Por, bota e thërriste poetin e lirisë, poetin e dashurisë dhe të Paqes. Një botë e re që rilindte nga gërmadhat e luftës. Edhe pse luftërat ende nuk kishin mbaruar, imazhi i Nusch-it ndërkohë nuk i shqitej nga sytë: “Ka partizanë me ngjyrën e gjakut të Spanjës/ Ka partizanë me ngjyrën e qiellit të Greqisë/ Buka, gjaku, qielli dhe e drejta për të shpresuar / Ti që të dua gjithnjë, ti që më krijove/ Këndoje duke ëndërruar lumturinë mbi tokë/ Ëndërroje të ishe e lirë dhe unë po të ndjek pas...”

Në qershor të po atij viti, ai botoi Poema politike dhe në një konferencë internacionale në Meksiko, ai do të takonte dashurinë e tij të tretë, Dominique-n. Ishte ajo që do ta risillte atë përsëri në jetën e gëzuar, në lëmin e poezisë, siç do ta lexojmë dhe në poezinë e tij E dashuruara: “Ajo i ka gjithnjë sytë e hapura/ Sy që s’më lënë të fle/ Ëndrrat

e saj në mes të ditës/ Bëjnë të avullojnë diejt/ Ato më bëjnë të qesh, të qaj e të qesh/ Të flas dhe kur s’kam asgjë për të thënë“.

Nga Tirana në Gramoz

Shumë e shumë vite më parë Elyari kishte dëgjuar për Shqipërinë. Në një letër që i shkruante vajzës së tij Cecile (Sesilja), në pranverën e vitit 1939, ai i fliste për pushtimin e Shqipërisë nga Italia fashiste dhe se ai ishte i pranishëm në Shqipëri, një fakt ky i panjohur më parë nga shqiptarët. Në prill të vitit 1948, ai u ftua në Wroclau të Polonisë, për Kongresin Botëror të Intelektualëve të Paqes, bashkë me Picasso-n, Seghers, I. J. Curie, etj. Picasso foli atje në mbrojtje të Nerudës së persekutuar. Në maj të atij viti Elyari shkoi në Greqi, në Athinë dhe Selanik, ku u prit me entuziazëm, sidomos nga demokratët, studentët e forcat e majta të Athinës. Në letrën që i dërgonte vajzës së tij, ai shkruante: “Bëra një udhëtim të mrekullueshëm në Greqinë e lirë. Po jetoj një epokë të jetës sime. Në Athinë recituan poezitë e mia. Ishte një manifestim për paqen botërore”.

Më 1949, rrugës për në Pragë, atë e shoqëroi një nga figurat e njohura të së majtës franceze, Ives Farge. Kësaj radhe misioni i tij ishte një mision i fshehtë. Pak njerëz e dinin. Në atë kohë në Shqipëri, shumë pak intelektualë e njihnin madhësthinë e figurës së Elyarit. Një nga këta ishte shkrimtari, poeti dhe eseisti ynë i shquar, Dhimitër Shuteriqi, i cili e kishte pritur dhe shoqëruar Elyarin në Tiranë, e që më pas kishin marrë udhën drejt Bilishtit. Që kur ishte student në universitetin e Grenoblës, Shuteriqi kishte njohur Yves Farge, kur ai drejtonte gazetën La depeche dauphinoise. Ky ishte dhe shkaku që ishte pikërisht ai që do t’i priste ata në Tiranë. Në kujtimet e tij, Shuteriqi kujtonte ato ditë kur Elyari i kishte dhuruar disa libra me poezi, të cilat ai i kishte lexuar për gjithë natën. “Natën, - kujtonte Shuteriqi, -Elyari kishte dëshirë të shëtiste vetëm. Duke parë qiellin, një mbrëmje ai i kishte thënë: “Kurrë nuk kam parë një qiell kaq të qartë. E megjithatë fatuna po shkatërron gjithçka rreth vendit tuaj. Qielli i përngjan qiellit...”.

Në librin Paul Eluard, un frère voyant, (Pol Elyar, një vëlla profet), Jean Charles Gateau shkruante: “Më 26 maj 1949, një avion e çoi Elyarin në Pragë. Që andej, një tjetër avion e mori atë dhe Ives Farge, drejt Jugosllavisë, tashmë e armiqësuar me Shqipërinë e kuqe të Enver Hoxhës. Objektivi i tyre ishin partizanët grekë të gjeneralit Markos në frontin greko-shqiptar, në veri të Pindit, krahinë e Gramozit dhe e malit Verno. Nga Tirana, një kamion i vjetër „Fiat“ i çoi vizitorët në qytezën e Bilishtit. Që andej ata e kaluan kufirin me një xhips dhe me nga një çantë shpine, ku brenda ai kishte futur libra me poezi...Partizanët i pritën dhe i përqafulan në shtëpitë mbi liqenin e Prespës. U ofruan raki. Pastaj ca të rinj i shoqëruan të hipur mbi mushka përgjatë përrenjve nëpër pyje, rrëpira, qafa e gërxhe të “Greqisë së lirë”. Po të mos kishte të shtëna topi që dëgjoheshin herë pas here, ky udhëtim do t’i ngjante një ekskursioni kampistësh të gëzuar”. “Po bëj një udhëtim të mrekullueshëm në “Greqinë e lirë”, - do të shkruante Elyari ato ditë. - Luftëtarët dhe luftëtaret janë të mbushura gjithë shpresë e kurajo...Natën e kaluar 4.000 fshatarë e ushtarë me mitraloza përjetonin triumfin e tyre. E lexuan poemën time, Athina. Ishte një miting për paqen botërore. Të gjithë kërcenin, këndonin. Këndonin gjatë gjithë kohës”.

Dhe në vazhdim, dora e Elyarit kishte shkruar një poezi: “Nëse Greqia do të çlirohej / Nga armiqtë e gjithë njerëzimit/ Nëse nakra do ishte e xhveshur/ Nga burgu i guaskës së saj/ Nga qefini i saj opak e gri/ Nëse ngjyra



do të tregonte gjinjtë e saj/ Nëse do të luanim bashkë të njëjtën lojë/ Njeriu do të gjente frymën e vetvetes”...

Mali i Gramozit ngrihej hijerëndë e madhështor në sytë e poetit francez, mal që disa muaj më vonë, në gusht të 1949, do të përgjakej dhe me gjakun e ushtarëve shqiptarë. Në kthim të udhëtimit të tij, në qershor, mes të tjerave, ai do të shkruante dhe poezinë me titull Mali i Gramozit: “Mali i Gramozit është i ashpër / Por njerëzit e zbusin atë/ Barbarët ne i vrasim / Për të shkurtuar errësirën dhe natën tonë/ Më budallenj se vetë baruti i topave / Armiqtë tanë nuk e njohin forcën tonë/ Ata nuk e njohin njeriun / As pushtetin e tij fisnik/ Zëmrat tona zbusin dhe gurin”. Në një fotografi të botuar në atë kohë në shtypin francez, rrëzë një peme duket Elyari, me një kapuç bariu në kokë, duke iu drejtuar me megafon ushtarëve të qeverisë greke që ta linin luftën vëllavrasëse. 200 megafonë shpërndanin njëherësh thirrjet e tij: “Bij të Greqisë, ju drejtohem juve, fshatarë, punëtorë, intelektualë, juve që ju kanë detyruar t’i shërbeni ushtrisë qeveritare...Unë jam një dëshmitar i shtyrë vetëm nga e vërteta dhe pasioni për Paqen. Një luftë vëllavrasëse si kjo e juaja, është nga luftërat më mizore, nga e cila përfitojnë veç ata që e udhëheqin atë”.

Të nesërmen, ai takoi nënat dhe të vejat e partizanëve të vrarë, një moment mjaft prekës që ai do ta përshkruajë më vonë përmes vargjeve të tij të dhimbshme, si në poezitë Lutja e vejushave dhe nënave, etj. “Ne malin Gramoz, - shkruan Dominique Eludes, - ata janë të pranishëm në fitoret e një ushtrie adoleshente. Ata shohin vajza 25 vjeçare që hidhen në sulm”. “Më 1 qershor 1949, - tregonte Ives Farge, - ne ndezëm zjarr me dru pishe në shtëpinë e një fshatari grek. Elyari zbrazti çantën e përgatitur me aq kujdes në Tiranë”. Poezitë që dëshmojnë për këto ditë janë prekëse dhe humane. Në poezinë Qivuri i Dhimos, (Le Cercueil de Dimos), duke parë luftëtarin që po vdiste nga plagët, ndër të tjera ai shkruante: “Dhe zogjtë do të kalojnë/ Edhe bilbilat e pyllit/ Vajzat e bukura do të vijnë gjithashtu / Dhe do të thonë: “Mirëdita Dhimo”.

Në një tjetër ditë ai takohet me kapitenin

Jotis, i cili nga plagët e mëdha është në prag të vdekjes. Por, Jotis do të shijojë trimërisht dhe ditën e fundit të tij: “Po ngrihem, ndihmomëni të ulem/ Dua të pi një verë të ëmbël/ Dua verë që të dehem/ Verë që të këndoј më mirë/ Këngët e mia janë të dhimbshme...”

Pas kthimit nga Shqipëria dhe Greqia e përfshirë në flakët e luftës vëllavrasëse, zëmra e poetit ishte e revoltuar nga tragjedia e këtij populli. Por, poezitë më të bukura ishin ato kushtuar komunistëve dhe luftëtarëve të Rezistencës, Asteris dhe Janopulos, të ekzekutuar nga qeveria greke një vit më parë. Në qershor, ai botoi përmbledhjen kushtuar Greqisë Për të mos qenë vetëm apo Grèce, ma rose de raison, (Greqi, trëndafili im i së drejtës).

Nga udhëtimi i shkurtër në Tiranë, veç kujtimeve të Dhimitër Shuteriqit, kanë mbetur dhe disa vargje e një fotografi e asaj kohe, ku Elyari ka dalë në Tiranë. Shumë më vonë, në vëllimin poetik Duart e lira, Dritëro Agolli do na përcillte në shqip dhe vjershën Të bërtasësh, ku Elyar këndonte: “E di se nën mburojat e armiqësisë/ Valojnë e ziejnë dhe në zemër hyjnë/ Pranvera, vera, vjeshta, dimri./ Dhe njerëzit dhe yjet,/ Nga gëzimi dridhen duke njohur/ Të ngrohtën afërsi”... Një tjetër shqiptar e bëri atë mikun e tij. Ky ishte piktori Ibrahim Kodra, për të cilin Elyari do të shkruante: “Kodra, ky primitiv i një qytetërimi të ri”.

Zhgënjimi

Pol Elyar vdiq i ri, por prodhimtaria e tij poetike ishte e madhe, duke e vendosur atë si një nga poetët më të mëdhenj të shekullit të vet. Vëllimet e tij poetike u përkthyen në shumë gjuhë të botës, siç u përkthyen ato dekada me radhë dhe në letrat shqipe, të botuara në disa vëllime, ashtu siç u përkthye dhe Zhak Prever apo Lui Aragon. Në vitin 1952, prej disa vitesh Elyari banonte në periferi të Parisit, në Charenton. Dhe ai filloi të zhgënjehej nga ajo kohë kur fillonte një tjetër luftë: një “Luftë e Ftohtë"! Dhe populli ishte i përçarë. Ideologjitë kishin zbritur në fushën e betejës. Por, ai e ndjente veten të lodhur. Sëmundja e gjatë e kishte drobitur trupin e tij. Në 25 tetor të atij viti, Elyarit i duhej të

shkonte për të prezantuar disa botime të reja të tij, por ai e ndjeu se e kishte të pamundur. Atëherë ai u kërkoi miqve të tij aktorë, Iv Montan, Zherar Filip dhe Simon Sinjore që ta përfaqësonin atë në këtë veprimtari. Por, ditët për të bëheshin gjithnjë e më të vështira. Poeti dukej se e ndjen fundin e tij. Më 18 nëntor të atij viti, në mëngjes, një krizë e fortë zëmre bëri që zëmra e tij të pushojë së rrahuri. Nga frika e protestave të mëdha, qeveria nuk e shpalli ditë zije kombëtare dhe nuk i lejoi njerëzit të ndiqnin në kortezh trupin e tij, siç kishte ndodhur me pararendësit e mëdhenj të poetit, Viktor Hygo dhe Pol Valeri... Sidoqoftë turma e madhe popullore nuk mungoi të mblidhej në varrezat e Père Lachaise për të përshëndetur për herë të fundit poetin e preferuar të tij, të shtrirë atje, përballë “Murit të Komunarëve”, luftëtarëve të pushkatuar të Komunës së Parisit. “Këtë ditë, gjithë bota ishte në zi”, - do të shkruante poeti tjetër Robert Sabatier.

Edhe pas vdekjes së tij, poezia e Elyarit mbeti një nga poezitë më të fuqishme të shekullit XX, një poezi me një evolucion të veçantë, duke kaluar nga dadaizmi e surrealizmi dhe duke u kthyer në poezinë e angazhuar. Por, edhe e angazhuar ajo tingëllonte tepër njerëzore, humane, e brishtë, pasi Elyari ishte tokësor e jetësor dhe fjalët e tij ishin njeri, qiell, dhé, erë, bukë apo gjak, dashuri dhe ëndërr... Aty ishte metafora e fuqishme e tij, brenda njeriut dhe dhimbjes së tij. Është ngjizja e një bote të ëndërruar. Ja pse poezitë e tij tingëllojnë sot aq të ndjera, të pështjellin dhe të marrin me vete në një udhëtim jo të zakonhtë:

“Çdo hidhërim ka një dritare të hapur
Një dritare të ndezur
Ka një ëndërr që lind
Ka një dëshirë që pret të përmbushet
Ka një uri që pret të shuhet
Ka një zemër fisnike
Ka dhe një dorë të zgjatur
Ka dhe dy sy në pritje
Ka dhe një jetë që hyn në një jetë...
Edhe një buzëqeshje”.

Po, Pol Elyar ishte një jetë që hyri në jetët tona.

NUMRI I ARDHSHËM MË 15 GUSHT

HEJZA

1 Gusht, 2025

Kryeredaktor i Hejzës: **Avni Halimi** (avni65halimi@gmail.com)

Editon Produksioni **TAKAT STUDIOS**

Faqosjen dhe dizajnin:
Drian Shala - Shalë

Rruga e Kaçanikut nr.208, Shkup, 1000